



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010 dhe nenit 2 paragrafi 1 pika 29 dhe nenit 64 paragrafi 3 të Ligjit për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2007, 90/2009 dhe 67/2010), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit (tekst i konsoliduar jozyrtar)¹

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet metodologjia për përcaktimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës dhe të elementeve të saj.
2. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet si marrëdhënie ndërmjet fondeve të veta të bankës e përcaktuar në pajtim me kreun III të këtij vendimi dhe aktivet e ponderuara sipas rrezikut të përcaktuar në pajtim me pikën 28 të këtij vendimi.
3. Banka është e detyruar vazhdimisht të mbajë normën e mjaftueshmërisë së kapitalit e cila nuk mund të jetë më e ulët se 8%.

Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) mund të përshkruajë përqindje më të lartë se 8% nëse është e nevojshme për shkak të natyrës, llojit dhe vëllimit të aktiviteteve

¹ Kjo paraqet tekst jozyrtar të konsoliduar të Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Teksti jozyrtar i konsoliduar i Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit përfshin Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/13), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/14), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 218/16), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 221/18), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19), Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 116/20) dhe Vendimi për plotësimin e Vendimit për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 167/20).

që i kryen banka dhe rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar si rezultat i atyre aktiviteteve.

4. Banka është e detyruar të sigurojë nivel të përshtatshëm të fondeve të veta në varësi të llojit dhe vëllimit të aktiviteteve financiare dhe lartësisë së rreziqeve që rrjedhin nga kryerja e këtyre aktiviteteve.

Pjesa e fondeve të veta e nevojshme për të mbuluar rrezik të caktuar nuk mund të përdoret njëkohësisht për të mbuluar rreziqe të tjera.

5. Në rastet kur banka është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar dhe përgatit raporte financiare të konsoliduara të grupit bankar, është e detyruar të përcaktojë njaftueshmërinë e kapitalit në bazë individuale dhe të konsoliduar.

II. PËRKUFIZIME

6. Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë vendim e kanë kuptimin si vijon:

1) **Mjete jomateriale** janë mjetet që lidhen me themelimin, licencat, patentat, koncesionet dhe shenjat mbrojtëse (përfshirë parakontratat për përvetësimin/përdorimin e tyre) dhe gudvillin. Mbështetja e programit (angl. software) ose mbështetja e programit në zhvillim nuk konsiderohen si mjete jo-materiale. Mjetet jo-materiale paraqiten në shumën neto, të reduktuara me shumën e zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimi;

2) **Portofoli i tregtimit** përfshin pozicionet në instrumentet financiare dhe mallrat që banka mban për shkak tregtimit (në emër të saj dhe për llogari të saj dhe në emër për llogari të klientëve të saj), pozicionet që lajmërohen kur banka ka marrë autorizim të vepron si mbështetës i tregut (ang. market maker) ose pozicione që ruhen për shkak të mbrojtjes së vlerës (ang. hedging) e pozicioneve të tjera në portofoli të tregtimit. Këto pozicione ruhen që të realizohen të ardhura nga shitja e tyre në afat të shkurtër dhe/ose për të realizuar të hyra si rezultat i asaj që ka ndodhur ose pritshmëritë e ndryshme afatshkurtra në çmimet e tregut;

3) **Portofoli i aktiviteteve bankare** përfshin të gjitha pozitat që nuk janë të përfshira në portfolio për tregtim të bankës;

4) **Institucioni i jashtëm për rejtingun e kredisë** (në tekstin e mëtejshëm: IKR) është person juridik që përgatit dhe lëshon rejtingje kreditore në bazë profesionale;

5) **Institucion i jashtëm i njohur i rejtingut të kredisë** (në tekstin e mëtejshëm: IKR e njohur) është IKR që është e njohur nga Banka Popullore në pajtim me kreun XIII të këtij vendimi, si dhe institucionet: "Fitchratings" (FitchRatings), "Mudis" (Moody's Investors Services Ltd) dhe "Standard dhe Pours" (Standard&Poor's Ratings Services);

6) **IKR e zgjedhur** është IKR e njohur vlerësimet e kredisë të së cilës banka ka vendosur t'i përdor gjatë përcaktimit të ponderuar të rrezikut, në pajtim me aktet interne të saj;

7) **Agjencia e njohur për kreditimin e eksportit** (në tekstin e mëtejshëm: AKI e njohur) është:

- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomi (OECD),
- agjencia e cila:
 - a) është me seli në vendin nënshkrues të Marrëveshjes me udhëzime për kreditimin e eksportit me mbështetjen zyrtare (ang. Arrangement on Guidelines for Officially Supported Export Credits) ose
 - b) publikon rejtingjet e saj për kreditimin dhe e pranon metodologjinë e OECD-së sipas së cilës vlerësimet e kredisë vendosen në një nga tetë shkallët e cilësisë së kredisë në bazë minimale të premisë për sigurim të eksportit;

8) **Rejtingu i kredisë** paraqet vlerësim të aftësisë kreditore të personit (personi juridik, shteti, vetëqeverisja lokale etj.), në borxh, instrumenti i borxhit, aksioni prioritar ose instrumenti tjetër financiar ose të botuesit të këtyre instrumenteve, i përgatitur dhe i lëshuar në bazë të sistemit të vendosur dhe të përkufizuar në kategoritë e rangimit. Rejtingu kreditor mund të jetë rejting kreditor i kërkuar ose i pakërkuar. Кредитниот рејтинг може да биде побаран или непобаран кредитен рејтинг. Si **rejting kreditor të kërkuar** konsiderohet rejtingu kreditor që e ka lëshuar IKR e njohur i vetëm me kërkesë të klientit të saj. Çdo rejting tjetër i kredisë që nuk kërkohet, konsiderohet **rejting kreditor i pakërkuar**;

9) Si **segmente të tregut** konsiderohen:

- segmentet bazë të tregut,
- grupi i personave dhe/ose instrumente financiare për të cilët IKR e njohur përdor metodologji dhe procedurë të njëjtë për lëshimin, rinovimin ose tërheqjen e rejtingut kreditor.

Segmentet bazë të tregut janë:

- financat publike – institucionet jofitimprurëse nga sektori publik (qeveria qendrore, institucionet publike jokomerciale, pushteti vendor dhe rajonal) dhe instrumentet financiare që i lëshojnë këta persona (me përjashtim të produkteve të strukturuar financiare),
- shoqëritë tregtare – personat juridik nga sektori privat dhe publik që punojnë në bazë komerciale dhe instrumentet financiare që i lëshojnë këta persona (me përjashtim të produkteve të strukturuar financiare),
- produktet e strukturuar financiare – të gjitha produktet e strukturuar financiare të lëshuara, pa dallim të botuesit të tyre, duke përfshirë edhe produktet e sekjuritizimit.

10) **Qeveria qendrore** përfshin të gjitha **departamentet administrative** të shtetit, si dhe organet tjera qendrore që financohen nga buxheti qendror i shtetit, në pajtim me rregulloret e vendit përkatës. Për nevojat e këtij vendimi, në Republikën e Maqedonisë si qeveri qendrore konsiderohen:

- institucionet e pushtetit legjislativ, gjegjësisht Kuvendi i Republikës së Maqedonisë;
- institucionet e pushtetit ekzekutiv, gjegjësisht Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria dhe ministritë, dhe
- pushteti gjyqësor, Gjykata Kushtetuese dhe organet dhe institucionet e tjera gjyqësore;

11) **Vetëqeverisja lokale dhe pushteti rajonal** përfshin organet e pushtetit lokal dhe rajonal, të përcaktuara me rregulloret e vendit përkatës. Në Republikën e Maqedonisë si vetëqeverisje lokale konsiderohen njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat), duke përfshirë edhe Qytetin e Shkupit dhe organet e tyre.

12) **Institucionet publike** janë institucionet për të cilat organi kompetent I vendit ku ndodhet selia e tyre ka përcaktuar trajtimin e institucioneve publike (ang. public sector entities, PSE) ose në vendin ku ndodhet selia e tyre janë themeluar si:

- organet administrative përgjegjëse ndaj qeverisë qendrore, pushteti rajonal ose vetëqeverisja lokale;
- personat juridik jofitimprurës të krijuara nga pushteti qendror për detyrimet e të cilëve garanton pushteti qendror, duke përfshirë organet e vetëqeverisjes lokale të themeluara në pajtim me ligj të veçantë dhe që i nënshtrohen kontrollit të shtetit.

Për nevojat e këtij vendimi, në Republikën e Maqedonisë si institucione publike konsiderohen: ndërmarrjet publike që janë të themeluara nga pushteti qendror, personat juridikë në të cilën Republika e Maqedonisë është aksionar dominant, shërbimet publike dhe shfrytëzuesit e mjeteve nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale (shkollat, kopshtet, muzetë, kopshtet zoologjike, bibliotekat, qendrat e kulturës, universitetet e punëtorëve dhe të tjera), agjencitë dhe institucionet e tjera të themeluara me ligj, institucionet e financuara nga mjetet publike dhe të gjitha institucionet dhe personat e tjerë që në pajtim me rregulloret janë subjekt i revizionit shtetëror.

Si **institucione publike që kanë trajtimin e pushtetit qendror** konsiderohen:

- institucionet publike nga vendet anëtare të Bashkimit Europian për të cilat organi kompetent i vendit ka përcaktuar trajtimin e pushtetit qendror;
- institucionet publike në Republikën e Maqedonisë që financohen nga buxheti qendror i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht organet dhe institucionet e mëposhtme të administratës shtetërore:
 - a) organet e pavarura të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë: Agjencia për Rini dhe Sport, Agjencia e Emigracionit, Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe grupet religjioze, Agjencia e Zhvillimit dhe Investimeve, Qendra për Menaxhimin e Krizave, Agjencia për Mallrat Rezervë, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe organet tjera të ngjashme;
 - b) organet dhe institucionet në kuadër të ministrive veçanta: Drejtoria e Sigurisë dhe Kundërzbulimit, Inspektorati Shtetëror i Punës,

Drejtoria për çështje hidrometeorologjike, Drejtoria e të Hyrave Publike, Drejtoria e Doganore, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e Inteligjencës Financiare, Byroja për Siguri Publike dhe organet tjera të ngjashme;

- c) organizatat administrative: Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë, Enti Shtetëror i Statistikave dhe Agjencia për kadastër të patundshëmrive dhe
- ç) organet dhe organizatat e tjera të administratës shtetërore që financohen nga buxheti qendror.
- Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut, Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Banka për Zhvillim e Maqedonisë së Veriut;

13) **Banka shumëpalëshe për zhvillim** është institucion i themeluar prej së paku tre vendeve ose në të cilën janë anëtarë së paku tre vendet, veprimtaria themelore e të cilit është financimi i zhvillimit ekonomik të të gjitha vendeve që janë anëtare të institucionit ose vetëm të grupit të caktuar të vendeve. Si banka të zhvillimit shumëpalëshe konsiderohen edhe: Korporata Ndër-Amerikane e Investimeve, Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim dhe Banka Qendrore Amerikane për integrimin ekonomik.

14) **Organizata ndërkombëtare** janë Komuniteti European, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare;

15) **Kompanitë e vogla (në tekstin e mëtejme: KV)** janë persona që kryejnë në mënyrë të pavarur veprimtari, për shkak realizimit të përfitimit, pa dallim të formës së tyre. Si KV konsiderohen tregtarët individualë, personat fizikë të cilët në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare nuk konsiderohen për tregtarë dhe tregtarët të cilët në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare konsiderohen për mikrotregtarë dhe të vegjël.

Banka mund të kryejë klasifikimin e klientëve KV dhe me përdorimin e klasifikimit të brendshëm, vetëm nëse ky klasifikim nuk shkakton aplikimin e ponderit më të ulët të rrezikut nga ponderi që do të aplikohet në rastin e përdorimit të përkufizimit të dhënë në paragrafin 1 të kësaj nënpike.

16) **Kërkesë jofunksionale** është ekspozim i cili në pajtim me Vendimin për administrimin e rrezikut të kredisë konsiderohet si kërkesë jofunksionale.

17) **Kërkesat me rrezik të lartë** janë ekspozimet e bankës tek të cilët ekzistojnë tregues objektiv për ekzistimin e rrezikut të lartë si për shembull kërkesat/investimet nga/në fondet e investimeve private dhe kompanitë me aktivitete me fitim të lartë dhe me rrezik të lartë (ang. private equity investments, venture capital firms) dhe të ngjashme;

18) **Ndërtesë banimi** është shtëpi familjare ose ndërtesë që janë të destinuara për banim, si dhe toka ndërtimore e destinuar për ndërtimin e shtëpive familjare ose banesave për të cilën është siguruar leje përkatëse për ndërtim. Garazhi ose vendi

për parkim, bodrumi, ballkoni, tarraca, lozha ose oborri konsiderohen për ndërtesë banimi nëse mbi ato bazohet hipotekë, së bashku me shtëpinë ose banesën familjare;

19) **Objekti afarist** është ndërtesë afariste (fabrikë, ndërtesë administrative dhe objekte tjera të ngjashme) hapësirë afariste (dyqane, hotele, depo dhe objekte të tjera të ngjashme) garazhë ose vend për parkim ose oborr i destinuar për kryerjen e aktivitetit të caktuar afariste ose komerciale, si dhe tokës bujqësore dhe tokës ndërtimore e destinuar për ndërtimin e objektit afarist për të cilin është siguruar leje përkatëse për ndërtim. Si objekt afarist konsiderohet objekti i cili më së shumti përdoret për kryerjen e aktiviteteve afariste. Garazhi ose vendi për parkim ose oborri konsiderohen objekte afarist ose nëse kryesisht përdoren për aktivitete afariste, ose nëse mbi ato nuk është bazuar hipotekë, së bashku me objektin afarist;

19-a) Hapësirë biznesi është çdo objekt i destinuar për kryerjen e aktivitetit afarist të caktuar ose komercial, me përjashtim të fabrikave dhe kapacitetet e tjera të ngjashme të prodhimit dhe toka bujqësore. Toka ndërtimore konsiderohet për hapësirë afariste, nëse është e destinuar për ndërtimin e hapësirës afariste dhe është siguruar leje përkatëse për ndërtim. Garazhi ose vendi për parkim ose oborri konsiderohen për hapësirë afariste, nëse mbi ato është vendosur garancion, së bashku me hapësirën e biznesit. Pajisja në hapësirën afariste konsiderohet për hapësirë biznesi, nëse mbi të është vendosur garancion, së bashku me hapësirën afariste, me përjashtim të pajisjeve të zyrës, kompjuterëve.

20) **Mjetet monetare në procesin e arkëtimit** janë mjete që janë në proces të transferimit prej një banke në tjetër dhe i përfshijnë mjetet monetare të llogarive kalimtare, paratë e gatshme në rrugë dhe forma të tjera të mjeteve në ngarkesë;

21) **Instrumenti për mbrojtjen e kredisë** është instrument për uljen e rezikut të kredisë që i plotëson kriteret e përkufizuara në kreun VI.2 të këtij vendimi. Instrumenti për mbrojtjen e kredisë mund të jetë instrument financiar ose jofinanciar për mbrojtjen e kredisë;

22) Si kërkesë e siguruar konsiderohet kërkesa që është siguruar me instrumentet për mbrojtjen e kredisë nga kreu VI.2 i këtij vendimi, pa u zvogëluar vlera kontabël e tij për shumën e amortizimit të akumuluar, korrigjimi i vlerës, gjegjësisht rezerva e veçantë, premia ose diskonti dhe efektet e ndryshimeve në vlerën e drejtë. Nëse vetëm pjesë e kërkesës është siguruar me instrumentet e mbrojtjes së kredisë nga kreu VI.2 të këtij vendimi, ajo pjesë përfaqëson **pjesën e siguruar të kërkesës**. Pjesa tjetër e kërkesës paraqet **pjesën e pasiguar të kërkesës**;

23) **Rreziku valutor** është rreziku i humbjes për shkak të ndryshimit të kurseve ndërvallutore, ndryshimi i vlerës së denarit në raport me vlerën e valutave të tjera të huaja dhe ndryshimet në vlerën e arit.

24) Për **rreziqe të tregut** konsiderohen:

- rreziku i investimeve në instrumentet pronësore që janë pjesë e portofolit të tregtimit;
 - rreziku i investimeve në instrumentet e borxhit që janë pjesë nga portofoli i tregtimit; dhe
- rreziku i tejkalimit të kufijve të ekspozimit që rrjedh nga pozicionet në portofolin e tregtimit.

25) **Marrëveshje repo** është marrëveshje për shitje/blerje të menjëhershme të letrave me vlerë ose mallrat, me detyrimin e shitësit/blerësit për të riblerë/shitur letrat me vlerë ose mallrat të njëjta ose të ngjashme në datë të ardhshme me çmim të paracaktuar, ku duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- banka ose pala tjetër kontraktuese është e detyruar ta transferojë të drejtën e pronësisë së letrave me vlerë ose mallrave;
- në pajtim me marrëveshjen, banka nuk guxon në të njëjtën kohë t'i transferojë ose të lërë peng letrat me vlerë ose mallrat tek palët e treta, me detyrimin blerjes ose zëvendësimit të tyre për letra ose mallra të njëjta ose të ngjashme.

26) **Marrëveshja për huadhënien e letrave me vlerë ose mallrave të palës tjetër kontraktuese dhe marrëveshje për huadhënien e letrave me vlerë ose të mallrave nga palë tjetër kontraktuese** janë marrëveshje me të cilat banka ose pala tjetër e saj i transferojnë (i japin hua) letrat me vlerë ose mallrat në këmbim të sigurisë përkatëse, me detyrim pala kontraktuese që ka marrë hua letrat me vlerë ose mallrat t'i kthejë të njëjtat letra me vlerë ose mallra në ndonjë datë të ardhshme ose kur prej saj e kërkon pala kontraktuese që i ka dhënë hua;

27) **Derivatët financiarë** janë instrumente, vlera e të cilave varet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çmimi i letrave me vlerë, mallrave, indekseve e bursës, valutat ose nga normat e interesit që janë objekt financiar derivativ (ang. underlying financial instrument). Këto instrumente shlyhen në ndonjë datë të ardhshme dhe në momentin e lidhjes së tyre nuk ka investim të mjeteve monetare ose shuma e investuar është shumë e vogël;

28) **Instrumentet pronësore** përfshijnë aksionet e zakonshme me të drejtë ose pa të drejtë vote, certifikatën e aksioneve të institucionit depozitues (p.sh. DQLV), letrat me vlerë të konvertueshme (letrat me vlerë që japin mundësinë për konvertimin në aksione), pjesët në fondet investuese, indekset e bursës, si dhe pozicionet në derivatët financiarë të cilat i referohen instrumenteve pronësore;

29) **Instrumentet e borxhit** përfshijnë obligacionet, instrumente me të cilat tregtohet në tregun e parasë dhe derivativë dhe instrumente të tjera financiare që i referohen normave të interesit dhe/ose instrumenteve të tjera të borxhit;

30) **Garantimi dhe/ose vendosja e emetimit të letrave me vlerë** nënkupton marrëveshje me të cilën banka obligohet, për llogari të emetuesit të letrave me vlerë të organizojë dhe zbatojë emetimin e letrave me vlerë dhe t'i regjistrojë dhe t'i paguajë të gjitha letrat me vlerë, ose vetëm ato që do të mbeten të paregjistruara,

për shkak të shitjes së tyre të mëtejshme tek investitorët e mundshëm, si dhe vendosjes së letrave me vlerë tashmë të emetuara në treg të ri. Banka është e detyruar të trajtojë në të njëjtën mënyrë edhe kontratat me të cilat paraqitet si bashkëgarantuese ose anëtare e grupi bankash që garantojnë emetimin e letrave me vlerë;

31) **Rreziku i shlyerjes/dorëzimit** është rrezik që rrjedh nga transaksionet me instrumente të borxhit, instrumente pronësore, valuta dhe mallra, që nuk janë të shlyera në datën e shlyerjes;

32) **Rreziku i palës tjetër kontraktuese** është rreziku që pala tjetër kontraktuese nuk do t'i shlyejë detyrimet e saj monetare ndaj bankës mbibazën e instrumenteve financiare, para ose në datën e shlyerjes;

33) **Dërgesë falas** (ang. Free delivery) është transaksioni që shlyhet kështu, që njëra palë kontraktuese bën ngarkesën/dërgesën para palës tjetër kontraktuese të kryen detyrimin e saj kontraktues. Nëse transaksion i tillë nuk shlyhet në datën e shlyerjes së përcaktuar në kontratën, banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të humbjes së të gjithë shumës së pagesës/dorëzimit të kryer.

34) **Premia nga instrumentet kapitale të shitura** paraqet diferencën ndërmjet vlerës së shitjes dhe vlerës nominale të instrumenteve kapitale. Nëse vlera e shitjes së instrumenteve kapitale është më e ulët se vlera e tyre nominale, fitohet premia negative nga instrumentet kapitale të shitura. Nëse vlera e shitjes së instrumenteve kapitale është më e lartë se vlera e tyre nominale, fitohet premia pozitive nga instrumentet kapitale të shitura.

35) **Person nga sektori financiar** është person juridik me seli në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit që është bankë, institucion financiar jobankë ose shoqëri për shërbime ndihmëse bankare (nëse shoqëria është përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara të bankës), në pajtim me Ligjin për bankat.

36) **Investimi sintetik** përfaqëson investim në instrumentet vlera e të cilave lidhet drejtpërdrejt me vlerën e instrumenteve kapitale të emetuara nga persona të sektorit financiar.

37) **Pjesëmarrja jo kontrolluese (minoritare)** përfshin pozicione nga kapitali i rregullt bazë të filialit që janë në pronësi të palëve të treta që nuk janë anëtarë të grupit bankar të cilit i përket banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar.

38) **Kapitali bazë shtesë i pranueshëm dhe kapitali shtesë i pranueshëm** janë pozicionet e kapitalit bazë shtesë dhe pozicionet e kapitalit shtesë të një filiali që janë në pronësi të palëve të treta të cilët nuk janë anëtarë të grupit bankar të cilit i përket banka që i nënshtrohet mbikëqyrjes së konsoliduar.

39) **Investim i rëndësishëm** në person nga sektori financiar paraqet investim të bankës që i plotëson kriteret e mëposhtme:

- investimi i bankës tejkalon 10% të kapitalit të rregullt bazë të personit nga sektori financiar;
- banka ka lidhje të ngushta me personin nga sektori financiar, pavarësisht shumës së investimit në instrumentet kapitale të kapitalit të rregullt bazë të atij personi; ose
- banka ka investim në kapitalin bazë të rregullt të personit nga sektori financiar, i cili nuk është anëtar i grupit bankar të cilit i përket banka, por personi nga sektori financiar dhe banka janë subjekt i konsolidimit, në pajtim me rregulloret mbi kontabilitetin dhe standardet e kontabilitetit.

Të gjitha investimet që nuk plotësojnë së paku një nga tre kriteret e mëparshme konsiderohen investime në **persona nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm**.

40) **Fitimi rrjedhës ose humbja rrjedhëse** është fitim ose humbje nga bilanci i suksesit të bankës, realizuar gjatë periudhës së caktuar kohore më të shkurtër se një vit kalendarik dhe përpara se të miratohet vendimi për konfirmimin e rezultatit financiar për periudhën nga asambleja e bankës.

41) **Fitimi në fund të vitit ose humbja në fund të vitit** është fitim ose humbje nga bilanci i suksesit të bankës, e realizuar gjatë një viti kalendarik dhe para se të miratohet vendimi për të konfirmuar rezultatin financiar për vitin nga asambleja e bankës.

42) **Norma e pagesës së dividendit** përcaktohet si raport i dividendit të paguar për aksionerët e bankës dhe fitimit pas tatimit. Nëse ky raport është negativ ose më i madh se 100%, norma e pagesës së dividendit është e barabartë me 100%. Nëse fitimi pas tatimit është zero, norma e pagesës së dividendit është e barabartë me: (1) 0%, nëse nuk ka pasur pagim dividend ose (2) 100%, nëse banka ka paguar dividend.

43) **Fitimi i disponueshëm për shpërndarje** përfshin shumën e fitimit pas tatimit, të konfirmuar nga asambleja e përgjithshme e bankës ose shumën e fitimit aktual, të cilat plotësojnë kushtet për shpërndarjen e dividendit ose pagesën avans të dividendit, në pajtim me ligjin.

44) **Aktivet tatimore të shtyra që varen nga e ardhmja e rentabilitetit të bankës** paraqesin kërkesa në bazë të tatimit të paguar më shumë në pajtim me rregulloren tatimore, të cilat mund ta ulin detyrimin tatimor të bankës, vetëm nëse në të ardhmen banka realizon fitim që i nënshtrohet tatimit. **Mjetet tatimore të shtyra që varen nga përfitimi i ardhshëm i bankës dhe që rrjedhin nga diferencat e përkohshme** paraqesin kërkesa në bazë të tatimit të paguar më shumë në pajtim me rregulloren tatimore, bazuar në diferencat e rastit në lidhje me llogaritjen e detyrimeve në bazë të tatimit.

7. Termat që nuk janë të përkufizuara në këtë vendim zbatohet kuptimi i përcaktuar me Ligjin për bankat.

III. MJETET VETANAKE

8. Mjetet vetanake të bankës përfaqësojnë shumë të kapitalit bazë, të përcaktuar në pajtim me kreun III.1 të këtij vendimi dhe kapitalit shtesë, të përcaktuar në pajtim me kreun III.2 të këtij vendimi, duke marrë parasysh dispozitat e kreut III.3. dhe III.4 të këtij vendimi.

9. Pozicionet që nuk plotësojnë kërkesat e këtij kreu nuk mund të përfshihen në llogaritjen e mjeteve të veta të bankës.

Nëse Banka Popullore konstaton se disa pozicione të caktuara që banka i ka përfshirë në përcaktimin e mjeteve të veta nuk i plotësojnë kushtet e këtij kreu, menjëherë do ta urdhërojë bankën që ato pozicione t'i përjashtojë nga shuma e mjeteve të veta. Banka mund t'i përfshijë ato pozicione në përcaktimin e mjeteve të veta, vetëm pasi të ketë përmbushur kushtet e nevojshme dhe pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore.

10. Me rastin e përcaktimit të shumës së mjeteve të veta, banka është e detyruar t'i respektojë следниве стапки:

- kapitali bazë i rregullt nuk guxon të jetë më i ulët se 4,5% nga aktivet e ponderuara sipas rreziqeve (norma e kapitalit të rregullt bazë);
- kapitali bazë nuk guxon të jetë më i ulët se 6% nga aktivet e ponderuara sipas rrezikut (norma e kapitalit bazë).

III.1 Kapitali bazë

11. Kapitali bazë i bankës paraqet shumën e kapitalit të rregullt bazë, i përcaktuar në pajtim me kreun III.1.1 të këtij vendimi dhe kapitali bazë shtesë, i përcaktuar në pajtim me kreun III.1.2 të këtij vendimi.

III.1.1 Kapitali i rregullt bazë

12. Kapitali i rregullt bazë fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 13 të këtij vendimi do të zvogëlohet për shumën e zërat e zbritshëm nga pika 16 e këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi.

13. Në kapitalin e rregullt bazë të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

13.1. Instrumentet kapitale që i plotësojnë kushtet nga pika 14 të këtij vendimi dhe për të cilin është marrë pëlqimi nga paragrafi 2 i kësaj pike;

13.2. Premia nga shitja e instrumenteve kapitale nga nënpika 13.1. të kësaj pike;

13.3. Rezerva e përgjithshme e detyrueshme (fondi rezervë i përgjithshëm);

13.4. Fitimet e pashpërndara të mbajtura që nuk është e ngarkuar me çfarëdo detyrimi në të ardhmen, e cila është treguar në bilancin e gjendjes së bankës dhe është konfirmuar me vendim të asamblesë së aksionarëve të bankës. Vendimi duhet të përmbajë dispozitë që përcakton se fitimi i mbajtur të mos jetë i disponueshëm për pagesën e dividendëve për aksionarët në të ardhmen. Në këtë pozicion përfshihet edhe humbja e akumuluar nga vitet e mëparshme, me shenjë negative;

13.5. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit që i plotësojnë kushtet e pikës 15 të këtij vendimi; dhe

13.6. Shuma e fitimit ose humbjes gjithëpërfshirëse që përfshin fitime dhe humbje të tjera që nuk janë shfaqur në bilancin e suksesit të bankës.

Pozicionet nga nënpika 13.1 e paragrafit 1 të kësaj pike përfshihen në kapitalin e rregullt bazë vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore. Banka është e detyruar të dorëzojë dokumentacionin nga i cili do të mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në pikën 14 të këtij vendimi, së paku 30 ditë përpara synimit për përfshirjen e këtyre instrumenteve në llogaritjen e mjeteve të veta.

Banka Popullore vendos për parashtrimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit nga paragrafi 2 të kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas plotësimit të dokumentacionit me të cilën vërtetohen kushtet nga pika 14 e këtij vendimi.

Pozicionet nga nënpikat 13.3, 13.4, 13.5 dhe 13.6 të paragrafit 1 të kësaj pike duhet të jenë plotësisht dhe menjëherë të disponueshme për të mbuluar rreziqet dhe humbjet gjatë veprimtarisë së bankës.

14. Instrumentet kapitale që i plotësojnë kushtet në vijim mund të jenë pjesë e kapitalit të rregullt bazë:

14.1. Të lëshuara nga banka në bazë të vendimit të asamblesë së aksionarëve;

14.2. Të paguara janë plotësisht, me ç'rast banka nuk guxon ta financojë, blerjen e tyre, direkt ose indirekt;

14.3. Kanë trajtimin e kapitalit aksionar, në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit që vlejnë për bankat dhe janë plotësisht dhe pa kufi të disponueshme për mbulimin e humbjeve;

14.4. Në bilancin e gjendjes së bankës tregohen qartë dhe veçmas;

14.5. Janë të pakthyeshme pa kushte, nuk kanë afat maturimi dhe nuk mund të blehen, paguhen, gjegjësisht vlera e tyre nuk mund të ulet, përveç në rast falimentimit ose likuidimit të bankës ose pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore me përjashtim të rastit të falimentimit ose likuidimit të bankës ose pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-j të këtij vendimi. Pas përjashtimit, konsiderohet se janë të përmbushura kushtet nga kjo nënpikë, nëse ulja e vlerës ka ndodhur si rezultat i masës së ndërrmarë nga Banka Popullore, në bazë të ligjit;

14.6. Nuk përmbajnë klauzola ose lloje të tjera dispozitash që ofrojnë mundësinë e blerjes, pagesës ose uljes së vlerës së tyre, me përjashtim të rastit të falimentimit ose likuidimit të bankës, as banka, gjatë dhënies së tyre, nuk inkurajoi ndonjë pritshmëri për blerjen, pagesën ose reduktimin e tyre vlerës së tyre;

14.7. Janë plotësuar kushtet e mëposhtme në lidhje me kompensimin që mund t'u shpërndahet mbajtësve të instrumenteve kapitale:

- nuk ekziston prioritet në pagesën e kompensimit, përfshirë edhe në lidhje me instrumentet e tjera që janë pjesë e kapitalit të rregullt bazë;
- pagesa e kompensimit mund të kryhet vetëm nga fitimi në dispozicion për shpërndarje;
- nuk janë parashikuar dispozita me të cilat kufizohet shuma maksimale e kompensimit;
- shuma e kompensimit nuk varet nga çmimi me të cilin mbajtësit i kanë blerë këto instrumente gjatë dhënies së tyre;
- nuk ekziston detyrim i detyrueshëm për pagesë të rregullt të kompensimit;
- anulimi i pagesës së kompensimit nuk konsiderohet si pamundësi banka t'i shlyejë detyrimet e saj;
- anulimi i pagesës së kompensimit nuk shkakton kufizime për bankën për pagesë për arsye të tjera.

14.8. Kanë cilësi më të lartë në raport me instrumentet e tjera kapitale të bankës, gjegjësisht përdoren së pari për të mbuluar humbjet gjatë veprimtarisë së bankës dhe çdo instrument kapital që është pjesë e kapitalit të rregullt bazë përdoret në mënyrë proporcionale dhe të barabartë, gjegjësisht pari passu, përdoret për të mbuluar humbjet. Konsiderohet se ky kusht plotësohet në rastet e shlyerjes së përhershme të instrumenteve kapitale që janë pjesë e përbërësve të tjerë të mjeteve të veta;

14.9. Në rast falimentimi ose likuidimi të bankës, këto instrumente paguhen të fundit në lidhje me të gjitha detyrimet e tjera të bankës ndaj kreditorëve të tjerë;

14.10. Në rast falimentimi ose likuidimi të bankës, mbajtësit e këtyre instrumenteve kanë të drejtë të arkëtojnë nga pjesa tjetër e aktiveve të bankës që do të mbetet pas shlyerjes së detyrimeve të tjera, me ç'rast të drejtën e arkëtimit është proporcionale me pjesëmarrjen në shumën e instrumenteve të emetuara dhe shuma maksimale e ngarkesës nuk është fikse ose e kufizuar;

14.11. Nuk janë të siguruara apo të mbuluara me çfarëdo lloj garancie nga banka ose personi i lidhur me të, me çka do të ulej shkalla e subordinimit të këtyre instrumenteve që është përcaktuar në nën pikat 14.8, 14.9 dhe 14.10 të kësaj pike;

14.12. Nuk i nënshtrohen asnjë marrëveshje që e ul shkallën e subordinimit të instrumentit që është përcaktuar në nën pikat 14.8, 14.9 dhe 14.10 të kësaj pike, në rast falimentimi ose likuidimi të bankës.

15. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit mund të përfshihen në llogaritjen e kapitalit të rregullt bazë të bankës vetëm në bazë të pëlqimit të marrë nga Banka Popullore.

Shuma e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit zvogëlohet për shumën e dividendit të paguar avans dhe/ose dividendit për të cilin ka vendim nga këshilli mbikëqyrës i bankës se do t'u shpërndahet aksionerëve të saj. Nëse këshilli mbikëqyrës nuk solli vendim për pagesën e dividendit, fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit zvogëlohet për shumat më të larta në vijim:

- dividenti i përcaktuar në bazë të normës së pagesës së dividendit në pajtim me politikën e dividendit të bankës;
- dividenti i përcaktuar në bazë të normës mesatare të pagesës së dividendit për tre vitet e fundit;
- dividenti i përcaktuar në bazë të normës së pagesës së dividendit nga viti i kaluar.

Banka Popullore do ta lëshojë pëlqimin nga paragrafi 1 i kësaj pike nëse plotësohen kushtet në vijim:

- shuma e fitimit rrjedhës ose e fitimit në fund të vitit është konfirmuar nga kompania e auditimit;
- shuma e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit është zvogëluar për çfarëdoj pagese në bazë të dividendit, tatimore apo detyrime të tjera të ngjashme që paguhen nga fitimi;
- këshilli mbikëqyrës i bankës miratoi vendim me të cilën parasheh se fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit nuk do të mund të përdoret për pagesën e dividendit të aksionarëve.

Për konfirmimin e kushtit nga paragrafi 3, alinea 1 të kësaj pike, banka është e detyruar të dorëzojë:

- për fitimin në fund të vitit - raport për auditim të kryer, të përgatitur në pajtim me rregulloret e auditimit, ose letër nga auditori që auditimi i pasqyrave financiare vjetore është në vazhdim, por auditori nuk ka ardhur në ndonjë njohuri për shkak të të cilave raporti përfundimtar do të përmbajë opinion të kualifikuar;
- për fitimin aktual - raport mbi një auditim të kryer ose raport mbi verifikimin e informacionit financiar ndërperiodik të përgatitur në pajtim me rregulloret e auditimit, ose letër nga auditori që auditimi i pasqyrave financiare është në vazhdim, por auditori nuk ka ardhur në njohuri për të cilën raporti përfundimtar do të përmbajë opinion të kualifikuar.

Për konfirmimin e kushtit nga paragrafi 3 nënparagrafi 2 të kësaj pike, banka është e detyruara të dorëzojë:

- deklaratë e nënshkruar nga personi përkatës me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë dhe shpenzimet dhe të ardhurat të paraqitura në bilancin e suksesit në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit që vlejnë për bankat;

- deklarata e nënshkruar nga anëtarët e këshillit drejtues të bankës në të cilën veçmas tregohen të gjitha pozicionet e fitimit rrjedhës ose të fitimit në fund të vitit, duke përfshirë edhe pagesat në bazë të dividendit, tatimore ose detyrime të tjera të ngjashme që paguhen nga fitimi.

Banka Popullore vendos për kërkesën e parashtruar për dhënien e pëlqimit nga paragrafi 1 i kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas plotësimit të dokumentacionit që vërtetohen kushtet e kësaj pike.

Shuma e fitimit rrjedhës për të cilën është marrë pëlqimi nga paragrafi 1 i kësaj pike, mund të përfshihet në llogaritjen e kapitalit bazë të rregullt edhe në periudhat rrjedhëse të vitit kalendarik rrjedhës, vetëm nëse fitimi i realizuar deri në datën për të cilin përcaktohet kapitali bazë i rregullt është më i madh nga shuma e fitimit rrjedhës për të cilin është marrë pëlqimi nga Banka Popullore.

16. Kapitali i rregullt bazë zvogëlohet për zërat e zbritshëm në vijim:

16.1. Humbje në fund të vitit ose humbje rrjedhëse;

16.2. Mjetet jomateriale. Shuma e zërit të zbritshëm zvogëlohet për detyrimet tatimore të shtyra që do të shuheshin nëse mjetet jo-materiale dëmtohen ose njihen, në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit që vlejnë për bankat. Shuma e zërit të zbritshëm rritet nga vullneti i mirë i investimeve të rëndësishme të bankës;

16.3. Mjetet tatimore të shtyra që varen nga e ardhmja e rentabilitetit të bankës. Shuma e zërit të zbritshëm zvogëlohet për detyrimet tatimore të shtyra vetëm nëse banka, në pajtim me ligjin, ka të drejtë të netojë mjetet tatimore rrjedhëse me detyrimet tatimore rrjedhëse. Gjatë përcaktimit të kapitalit bazë të rregullt në bazë të konsoliduar, detyrimet tatimore të shtyra mund të zvogëlojnë shumën e mjeteve tatimore të shtyra, vetëm nëse mjetet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra i referohen tatimeve që arkëtohen nga institucioni i njëjtë tatimor dhe i referohen të njëjtit subjekt tatimor. Në detyrimet tatimore të shtyra që mund të përfshihen në netimin e mjeteve tatimore të shtyra nuk përfshihen detyrimet tatimore të shtyra nga nën-pika 16.2 të kësaj pike;

16.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet e kapitalit të veta nga kapitali bazë i rregullt, duke përfshirë instrumentet kapitale për të cilat banka ka detyrim kontraktor për t'i blerë. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin e gjatë bruto të bankës në instrumentet e kapitalit vetjak nga kapitali bazë i rregullt dhe mund të reduktohet me shumën e pozicionit të shkurtër në këto instrumente vetëm nëse: (1) pozicionet i gjatë dhe i shkurtër janë në të njëjtin instrument dhe pozicioni i shkurtër nuk e ekspozon bankën ndaj rrezikut të palës kontraktuese dhe (2) të dy pozicionet (e gjatë dhe e shkurtër) janë ose pjesë e portofolit për tregti ose pjesë e portofolit të aktiviteteve bankare. Në rastin e investimeve të indeks burse

индекс në të cilën përfshihen instrumentet kapitale të bankës, shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pjesëmarrjen proporcionale të atyre instrumenteve kapitale në indeks. Nëse banka ka pozicion të gjatë dhe pozicion të shkurtër në indeks burse në të cilën janë përfshirë instrumentet kapitale të bankës, pozicioni i gjatë mund të zvogëlohet me shumën e pozicionit të shkurtër, duke përfshirë pozicionin e shkurtër që e ekspozon banka ndaj rrezikut të palës tjetër kontraktore, vetëm nëse : (1) pozicioni i gjatë dhe i shkurtër janë në të njëjtin indeks dhe (2) dhe të dy pozicionet (i gjatë dhe i shkurtër) janë ose pjesë e portofolit të tregimit ose pjesë e portofolit të aktiviteteve bankare;

16.5. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali i rregullt bazë i personave nga sektori financiar, me ç'rast ato persona kanë investime në bankë që rrisin artificialisht mjetet e veta personale. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin e gjatë bruto të bankës në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i këtyre personave;

16.6. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të konsiderueshëm. Shuma e totalit të zërit të zbritshëm për këto investime është e barabartë me produktin e:

- investimet direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale që janë pjesë e mjeteve të veta të personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm, shuma totale e të cilave kalon 10% të kapitalit të rregullt bazë të bankës. Për nevojat e kësaj alineje, kapitali bazë i rregullt i bankës fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 13 e këtij vendimi korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi dhe do të zvogëlohet për zërat e zbritshëm nga nënpikat 16.1, 16.2, 16.3, 16.4. , 16.5, 16.10 dhe 16.11 të kësaj pike, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rrjedhin nga dallimet e rastit, dhe
- shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm, pjesëtuar me shumën totale të investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale që janë pjesë e mjeteve të veta të personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm.

Në përcaktimin e shumave nga alinetë 1 dhe 2 të kësaj nënpike, nuk përfshihen investimet direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale të personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm të cilat mbahen deri në pesë ditë. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike nga paragrafi 1 të kësaj nënpike, e cila nuk kalon 10% të kapitalit bazë të rregullt të bankës, përfshihet në përcaktimin e aktiveve të ponderuara sipas rreziqeve, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi;

16.7. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumente kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilën banka ka

investim të konsiderueshëm, me përjashtim të atyre të cilat mbahen deri në pesë ditë;

16.8. Shuma e zërave të zbritshëm nga kapitali bazë shtesë nga pika 19-c e këtij vendimi, e cila tejkalon shumën totale të kapitalit bazë shtesë nga pika 19 e këtij vendimi;

16.9. Investimet në institucionet jofinanciare. Shuma e zërit të zbritshëm paraqet shumën e tejkalimit të kufijve të Ligjit për bankat që i referohen pjesës individuale të kapitalit (15%) dhe të agregatit, gjegjësisht shuma totale e pjesëve të kapitalit në institucionet jofinanciare (30%). Nëse banka tejkalon një nga kufijtë e shënuar, si zëri i zbritshëm merret shuma e tejkalimit të kufirit. Nëse banka i tejkalon të dy kufijtë e shënuar, si zëri i zbritshëm merret shuma më e madhe e tejkalimit të të dy kufijve. Në kuadër të këtyre kufijve nuk merren parasysh investimet që mbahen deri në pesë ditë, si dhe letrat me vlerë që votojnë në emër të bankës, dhe për llogari të subjekteve të tjera;

16.10. Kostot tatimore që mund të përcaktohen në momentin e llogaritjes, përveç nëse banka në mënyrë të përshtatshme nuk e ka rregulluar shumën e pozicioneve që hyjnë në kapitalin bazë të rregullt në nivel në të cilin kostot tatimore do të reduktonin shumën e disponueshme për të mbuluar rreziqet ose humbjet;

16.11. Dallimi midis korigjimit dhe vlerës dhe rezerva e veçantë e përcaktuar nga banka dhe shuma e nevojshme e korigjimit të vlerës dhe rezervës së veçantë, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin me rrezikun kreditor.

17. Shuma e zërave të zbritshëm nga pika 16 nën pikat 16.6 dhe 16.7 të këtij vendimi është e barabartë me pozicionin e gjatë bruto të bankës në këto investime dhe mund të zvogëlohet për shumën e pozicionit të shkurtër në këto investime vetëm nëse pozicioni i gjatë dhe i shkurtër, i referohen të njëjtit instrument, ku:

(1) pozicioni gjatë dhe i shkurtër kanë të njëjtin maturim ose maturimi i mbetur i pozicionit të shkurtër është së paku një vit dhe (2) të dy pozicionet (i gjatë dhe i shkurtër) janë ose pjesë e portofolit për tregtim ose pjesë e portofolit të aktiviteteve bankare. Në rastin e investimeve në indeks të bursës në të cilin përfshihen instrumentet kapitale të personave nga sektori financiar, shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pjesëmarrjen proporcionale të këtyre instrumenteve kapitale në indeks.

Banka nuk është e detyruar t'i përfshijë si zëra të zbritshëm pozicionet në vijim nga pika 16 nën pikat 16.3 dhe 16.7 të këtij vendimi, nëse shuma e tyre nuk e tejkalon kufirin nga paragrafi 3 prej kësaj pike:

- mjetet tatimore të shtyra që varen nga e ardhmja e profitabilitetit të bankës dhe lindin nga diferenca të rastit, shuma totale e të cilave nuk tejkalon 10% të shumës nga kapitali bazë i rregullt i bankës i përcaktuar kur shuma e pozicioneve nga pika 13 e këtij vendimi do të korigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi dhe do të zvogëlohet për zërat e zbritshëm nga pika 16 nën pikat 16.1, 16.2, 16.3, 16.4, 16.5, 16.6, 16.10 dhe 16.11 të këtij vendimi, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rrjedhin nga diferencat e rastit; dhe

- investimet direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i rregullt i personave nga sektori financiar në të cilin banka ka investim të konsiderueshëm, shuma totale e të cilave nuk tejkalon 10% nga kapitali bazë i rregullt i bankës i përcaktuar kur shuma e pozicioneve nga pika 13 të këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi dhe do të reduktohet për zërat e zbritshëm nga pika 16 nën-pikat 16.1, 16.2, 16.3, 16.4, 16.5, 16.6, 16.10 dhe 16.11 të këtij vendimi, me përjashtim të shumës së mjeteve tatimore të shtyra që varen nga profitabiliteti i ardhshëm i bankës dhe rrjedhin nga diferencat e rastit.

Për nevojat e paragrafit 2 të kësaj pike, kufiri përcaktohet si product i:

- shuma e kapitalit bazë të rregullt të bankës që fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 13 e këtij vendimi do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi dhe do të zvogëlohet për zërat e zbritshëm nga pika 16 e këtij vendimi; dhe
- 17,65%.

Pozicionet nga paragrafi 2 të kësaj pike që nuk janë zëra të zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt përfshihen në përcaktimin e aktiveve të ponderuara sipas rrezikut të kredisë me ponder të rrezikut prej 250%.

III.1.2 Kapitali bazë shtesë

18. Kapitali bazë shtesë fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 19 e këtij vendimi do të zvogëlohet me shumën e zërave të zbritshëm nga pika 19-c e këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore nga pika 19-ë të këtij vendimi.

19. Në kapitalin bazë shtesë të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

- instrumentet kapitale që i plotësojnë kriteret e pikës 19-a të këtij vendimi; dhe
- premia nga shitja e instrumenteve kapitale nga alinea 1 prej kësaj pike.

19-a. Instrumentet kapitale që i plotësojnë kushtet në vijim mund të jenë pjesë e kapitalit bazë shtesë:

19-a.1. Janë lëshuar dhe paguar plotësisht, me ç'rast banka nuk e financon blerjen e tyre, direkt ose indirekt;

19-a.2. Nuk janë blerë nga banka, filiali i saj ose personi në të cilin banka ka pjesëmarrje;

19-a.3. Në rast falimentimi ose likuidimi të bankës, paguhen për instrumentet që janë pjesë e kapitalit shtesë të bankës;

19-a.4. Nuk janë të siguruara ose të mbuluara me çfarëdolloj garance nga banka ose nga personi i lidhur me të, me çka do të zvogëlohej niveli i subordinimit të këtyre instrumenteve i cili është i përcaktuar në nënpikën 19-a.3 të kësaj pike;

19-a.5. Nuk i nënshtrohet çfarëdolloj marrëveshjeje që e zvogëlon nivelin e subordinimit, i cili është i përcaktuar në nënpikën 19-a.3 të kësaj pike, në rast falimentimi ose të likuidimit të bankës;

19-a.6. Nuk kanë afat maturimi;

19-a.7. Në rastet kur janë parapara një ose më shumë opsione për blerje ose shlyerje të instrumentit, shfrytëzimi i opsionit për blerje ose shlyerje është e drejtë diskrecionale vetëm e emetuesit;

19-a.8. Mund të blehen ose të shlyhen nga banka vetëm pas pëlqimit të fituar nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-j të këtij vendimi.

19-a.9. Nuk ekzistojnë klauzola ose lloj tjetër dispozitash për shkak të cilave do të pritej që instrumentet të mund të blihen ose të shlyhen, përveç rastit të falimentimit dhe të likuidimit të bankës ose pas pëlqimit të fituar nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-j të këtij vendimi;

19-a.10. Banka nuk krijon pritshmëri që Banka Popullore do e lëshojë pëlqimin e nevojshëm për blerje ose shlyerje të instrumenteve;

19-a.11. Janë përmbushur kushtet në vijim në raport me kompensimin që mund t'u shpërndahet mbajtësve të instrumenteve kapitale:

- pagesa e kompensimit kryhet nga fitimi në dispozicion për shpërndarje, ku pagesa e kompensimit mund të kryhet edhe nëse fitimi nuk është rishikuar nga revizor i autorizuar;
- lartësia e kompensimit nuk duhet të ndryshojë varësisht aftësisë kreditore të bankës ose nga aftësia kreditore e personit të tij amë;
- banka ka diskrecionin e plotë, që në çdo kohe ta anulojë pagesën e kompensimit për një periudhë të pakufizuar dhe në bazë jokumulative dhe pa kufizime ta përdorë kompensimin e papaguar për përmbushjen e detyrimeve të veta;
- anulimi i pagesës së kompensimit nuk konsiderohet si pamundësi që banka t'i shlyejë detyrimet e veta;
- anulimi i pagesës së kompensimit nuk e kufizon bankën të kryejë pagesë mbi baza të tjera;

19-a.12. Nuk merren parasysh gjatë përcaktimit nëse janë përmbushur kushtet për hapje të procedurës për falimentim, në pajtim me ligjin;

19-a.13. Përmbajnë dispozita me të cilat është përcaktuar se në rast të ndodhjes së ngjarjes kritike, shlyhet, gjegjësisht zvogëlohet vlera e kryegjësë të këtyre instrumenteve në bazë të përhershme ose të përkohshme ose instrumenti shndërrohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt;

19-a.14. Instrumenti nuk duhet të ketë karakteristika të cilat mund ta vështirësojnë rikapitalizimin e bankës;

19-a.15. Në rastet kur instrumenti nuk është lëshuar direkt nga banka:
(1) ai është lëshuar nga personi i cili është anëtar i grupit bankar të cilës i përket banka dhe (2) mjetet e paguara monetare janë menjëherë në dispozicion dhe të disponueshme të bankës pa kurrfarë kufizimi, me ç'rast janë përmbushur të gjitha kushtet e tjera të paraparë në këtë pikë;

19-a.16. Instrumenti kapital nuk ka trajtim të depozitit (depozitë kursimi) dhe nuk është subjekt i sigurimit nga Fondi i Sigurimit të Depozitave.

19-b. Për përmbushjen e kushteve të pikës 19-a nënpika 19-a.11 alinea 5 dhe nënpika 19-a.14 të këtij vendimi, është e nevojshme që instrumenti të mos përmbajë dispozita me të cilat parashihet: (1) pagesë e detyrueshme e kompensimit në rast të pagesës së kompensimit për instrumente me cilësi të njëjtë ose më të mire, duke përfshirë instrumentet nga kapitali bazë i rregullt, (2) anulimi i detyrueshëm i pagesës së kompensimit për instrumentet e tjera nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë dhe kapitali shtesë, nëse nuk kryhet pagesa e kompensimit për instrumentin; (3) detyrimi për zëvendësimin e pagesës së interesit ose dividendit me çfarëdolloj forme tjetër të kompensimit.

Për përmbushjen e kushtit të pikës 19-a nënpika 19-a.13 të këtij vendimi, është e nevojshme që kontrata për instrumentin t'i përmbajë dispozitat në vijim:

- ngjarja kritike përkufizohet si rënie në normën e kapitalit bazë të rregullt nën 5,125%. Banka mund të përcaktojë edhe nivel më të lartë të ngjarjes kritike ose, krahas ngjarjes kritike të përcaktuar në këtë mënyrë, të përcaktojë edhe ngjarje të tjera kritike;
- me shlyerjen, gjegjësisht me shndërimin krijohen instrumente, gjegjësisht pozicionet që mund të jenë pjesë e kapitalit bazë të rregullt, në pajtim me pjesën III.1.1 të këtij kreu,
- nëse parashikohet shndërimi i instrumentit nga kapitali bazë shtesë në instrument kapitali nga kapitali bazë i rregullt, dispozitat duhet të parashikojnë: (1) raportin e shndërimit dhe shuma maksimale e lejuar që mund të shndërohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt ose (2) shtrirje në kuadër të cilës instrumenti do të shndërrohet në instrument nga kapitali bazë i rregullt, duke pasur parasysh lëvizjen e çmimeve të instrumenteve;
- nëse parashikohet fshirje, gjegjësisht ulje e vlerës së kryegjësë të instrumentit nga kapitali bazë shtesë, ulja i referohet: (1) pretendimeve që do t'i kishte mbajtësi i instrumentit, në rast të falimentimit ose të likuidimit të bankës; (2) shuma që duhet të paguhet në rast të aktivizimit të opsionit për tërheqjen ose pagesën e instrumentit dhe (3) kompensimin nga instrumenti.

Shuma totale e instrumenteve nga kapitali bazë shtesë që fshihet ose shëndrohet në instrumente nga kapitali bazë i rregullt pas ndodhjes së ngjarjes kritike, nuk mund të jetë më e vogël se shuma më e ulët ndërmjet: (1) shumës së nevojshme për arritjen e normës së kapitalit bazë të rregullt prej 5,125% dhe (2) e gjithë shuma e kryegjësë së instrumentit.

Në rast të ndodhjes së ngjarjes kritike, banka duhet:

- 1) të informojë menjëherë Bankën Popullore;
- 2) të informojë mbajtësit e instrumenteve; dhe
- 3) të shlyejë kryegjën e instrumenteve, ose t'i shëndrojë në pozicione nga kapitali bazë i rregullt, jo më shumë se 30 ditë nga ngjarja kritike.

Banka është e detyruar:

- vazhdimisht të posedon aksione të zakonshme në shumë që është e mjaftueshme për shëndrimin e instrumentet nga kapitali bazë shtesë në instrumente kapitale nga kapitali bazë i rregullt;
- në datën e lëshimit të instrumenteve nga kapitali bazë shtesë, t'i sigurojë të gjitha miratimet e nevojshme nga organi kompetent përkatës, në pajtim me ligjin;
- në çdo kohë të disponojë miratimet e nevojshme nga organi përkatës kompetent për lëshimin e instrumenteve nga kapitali bazë i rregullt duke i shëndruar instrumentet nga kapitali bazë shtesë, në pajtim me ligjin.

Në rastin e fshirjes, gjegjësisht uljes së vlerës së kryegjësë, fshirja kryhet proporcionalisht me të gjitha instrumentet nga pika 19-a e këtij vendimi.

Fshirja e instrumenteve nga pika 19-a e këtij vendimi mund të kryhet në bazë të përkohshme vetëm nëse plotësohen kushtet në vijim:

- shuma e kompensimit që paguhet pas fshirjes së zbatuar llogaritet në shumën e reduktuar të kryegjësë së instrumentit;
- mund të kryhet rritje e kryegjësë së instrumenteve vetëm nga fitimi pas tatimit, i konfirmuar nga asambleja e Bankës;
- banka ka diskrecion të plotë gjatë vendosjes për rritjen e kryegjësë së instrumenteve ose për pagesën e kompensimit të shumës së reduktuar të kryegjësë;
- rritja e kryegjësë së instrumenteve kryhet në mënyrë proporcionale me të gjitha instrumentet nga pika 19-a të këtij vendimi të cilat ishin subjekt i fshirjes bazë së përkohshme;
- shuma maksimale e rritjes së kryegjësë të instrumenteve së bashku me shumën e kompensimit e cila paguhet në shumën e reduktuar të kryegjësë përcaktohet në datën e rritjes së kryegjësë të këtyre instrumenteve dhe është e barabartë me produktin e fitimit pas tatimit dhe pjesëmarrjes së shumës nominale (para se të kryhet fshirja) të instrumenteve të pikes 19-a të këtij vendimi të cilat ishin subjekt i fshirjes së përkohshme bazë dhe shumës totale të kapitalit bazë të bankës;

- shuma e rritur e kryegjësë së instrumenteve dhe shuma e kompensimit i cili paguhet në shumën e reduktuar të kryegjësë e reduktojnë shumën e kapitalit të rregullt bazë dhe e reduktojnë shumën maksimale për shpërndarjen e rezultatit nga veprimtaritë e bankave.

19-c. Kapitali bazë shtesë reduktohet për pozicionet në vijim:

19-c.1. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet e veta kapitale nga kapitali bazë shtesë, duke përfshirë instrumentet kapitale për të cilat banka ka detyrim kontraktor për t'i blerë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse zbaton dispozitat e pikës 16, nënpika 16.4 të këtij vendimi;

19-c.2. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë shtesë i personave nga sektori financiar, me ç'rast ato persona kanë investime në bankë me të cilat rriten artificialisht mjetet e veta. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin e gjatë bruto të bankës në instrumentet kapitale nga kapitali bazë shtesë të këtyre personave;

19-c.3. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë shtesë i personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat e pikës 16, nënpika 16.6 dhe pika 17, paragrafit 1 të këtij vendimi;

19-c.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet kapitale nga kapitali bazë shtesë i personave nga sektori financiar në të cilin banka ka investim të rëndësishëm, me përjashtim të atyre që mbahen deri në pesë ditë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat e pikës 17 paragrafi 1 të këtij vendimi;

19-c.5. Shuma e zërave të zbritshëm nga kapitali shtesë nga pika 19-e të këtij vendimi, e cila tejkalon shumën totale të kapitalit shtesë nga pika 19-d të këtij vendimi.

19-c.6. Shpenzimet tatimore që mund të përcaktohen në momentin e llogaritjes, përveç nëse banka në mënyrë përkatëse nuk e ka përshtatur shumën e pozicioneve që hyjnë në kapitalin bazë shtesë deri në nivelin në të cilin shpenzimet tatimore do të reduktonin shumën e disponueshme për mbulimin e rreziqeve ose humbjeve.

III.2 Kapitali shtesë

19-ç. Kapitali shtesë i bankës fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 19-d të këtij vendimi do të zvogëlohet me zërat e zbritshëm të pikës 19-e të këtij vendimi dhe do të korrigjohet për harmonizimet rregullatore të pikës 19-ë të këtij vendimi.

19-d. Në kapitalin shtesë të bankës përfshihen pozicionet në vijim:

- instrumentet kapitale dhe kreditë subordinuese, të cilat i plotësojnë kriteret e pikës 19-dh të këtij vendimi; dhe
- premia nga shitja e instrumenteve kapitale nga alinea 1 të kësaj pike.

19-dh. Instrumentet kapitale dhe kreditë subordinuese të cilat i plotësojnë kushtet mund të jenë pjesë e kapitalit shtesë:

19-dh.1. Janë të lëshuara prej, gjegjësisht i janë miratuar, bankës dhe janë të paguara në tërësi;

19-dh.2. Nuk janë blerë, gjegjësisht nuk janë miratuar nga banka, filiali i saj ose personi në të cilin banka ka pjesëmarrje;

19-dh.3. Blerja ose miratimi i këtyre instrumenteve nuk është financuar direkt ose indirekt nga banka;

19-dh.4. Detyrimet në bazë të këtyre instrumenteve i nënshtrohen plotësisht detyrimeve ndaj depozituesve dhe kreditorëve të tjerë të bankës;

19-dh.5. Nuk janë të siguruara ose të mbuluara me çfarëdoj garance nga banka ose nga personi i lidhur me të, me çka do të ulej norma e subordinimit të këtyre instrumenteve, të përcaktuar në nënpikën 19-dh.4 të kësaj pike;

19-dh.6. Nuk i nënshtrohen çfarëdoj marrëveshjeje që e ul normën e subordinimit, të përcaktuar në nënpikën 19-dh.4 të kësaj pike;

19-dh.7. Kanë afat maturimi së paku pesë vjet;

19-dh.8. Në rast kur janë të parapara një ose më shumë opsione për blerje ose shlyerje e parakohshme, shfrytëzimi i opsionit për blerje/shlyerje të parakohshme është e drejtë diskrecionale vetëm e emetuesit;

19-dh.9. Mund të blihen ose të shlyhen para kohe vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 19-j të këtij vendimi;

19-dh.10. Nuk përmbajnë klauzola ose lloj tjetër dispozitash, as banka nuk inkurajon pritshmëritë se instrumentet mund të blihen ose shlyhen para kohe, përveç në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës;

19-dh.11. Nuk përmbajnë klauzola ose lloj tjetër dispozitash që i japin të drejtën mbajtësit të këtyre instrumenteve të kërkojë shlyerje të përshpejtuar të kërkesave të ardhshme në bazë të interesit ose kryegjësë, përveç në rast të falimentimit ose likuidimit;

19-dh.12. Lartësia e interesit ose dividendit nuk duhet të ndryshojë, varësisht aftësisë kreditore të bankës ose nga aftësia kreditore e personit të tij amë;

19-dh.13. Në rastet kur nuk janë të emetuara drejtpërdrejt nga banka, gjegjësisht nuk janë miratuar drejtpërdrejt në bankë: (1) është lëshuar nga, gjegjësisht i është miratuar personit që është anëtar i grupit bankar të cilit i përket banka dhe (2) mjetet monetare të paguara janë menjëherë në dispozicion dhe të disponueshme të bankës pa kurrfarë kufizime, me ç'rast janë plotësuar të gjitha kushtet e tjera të parashikuara në këtë pikë;

19-dh.14. Nuk kanë trajtimin e depozitit (depozitë kursimi) dhe nuk janë subjekt i sigurimit nga Fondi i Sigurimit të Depozitave.

Shuma e instrumentit nga paragrafi 1 të kësaj pike, e cila përfshihet në llogaritjen e kapitalit shtesë të bankës gjatë pesë viteve të fundit deri në afatin e tij të maturimit, paraqet produkt të:

- shuma nominale e pozicionit në ditën e parë nga pesë vitet e fundit deri në afatin kontraktor të maturimit;
- numri i ditëve kalendarike të mbetura nga afati kontraktor i maturimit të pozicionit, pjesëtuar me numrin total të ditëve kalendarike në periudhën e pesë viteve të fundit.

19-e. Kapitali shtesë zvogëlohet për pozicionet në vijim:

19-e.1. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në instrumentet e veta nga kapitali shtesë, duke përfshirë instrumentet për të cilat banka ka detyrim kontraktor për t'i blerë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat e pikës 16, nën pikës 16.4 të këtij vendimi;

19-e.2. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali shtesë i personave nga sektori financiar, ku ato persona kanë investime në bankën me të cilat rriten artificialisht mjetet e saj të veta. Shuma e zërit të zbritshëm është e barabartë me pozicionin e gjatë bruto të bankës në pozicionet nga kapitali shtesë i këtyre personave;

19-e.3. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali shtesë të personave nga sektori financiar në të cilin banka nuk ka investim të rëndësishëm. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat e pikës 16 të nën pikës 16.6 dhe pika 17 paragrafit 1 të këtij vendimi;

19-e.4. Shuma e investimeve direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet nga kapitali shtesë të personave nga sektori financiar në të cilin banka ka investim të konsiderueshëm, me përjashtim të atyre që mbahen deri në pesë ditë. Gjatë përcaktimit të kësaj shume, banka në mënyrë përkatëse i zbaton dispozitat nga pika 17 paragrafi 1 të këtij vendimi.

III.3 Harmonizimet rregullatore

19-ë. Banka nuk i përfshin pozicionet në vijim në llogaritjen e përbërësve të veçantë të mjeteve të veta:

- çdo rritje e komponentëve të veçantë të mjeteve të veta që del nga pozicionet e sekjuritizimit;

- fitimet ose humbjet nga mbrojtja e rrezikut nga rrjedhat monetare;
- fitimet ose humbjet nga detyrimet e bankës që maten me vlerë objektive, të cilat janë rezultat i ndryshimeve në aftësinë kreditore të bankës;
- fitimet ose humbjet në lidhje me detyrimet në bazë të derivateve të cilat maten me vlerën objektive, dhe që janë rezultat i ndryshimeve në aftësinë kreditore të bankës, me ç'rast nuk mund të kryhet netimi i këtyre fitimeve dhe humbjeve me ato që rrjedhin nga rreziku i palës tjetër kontraktuese.

Me përjashtim të paragrafit 1 alinea 3 të kësaj pike, banka mund t'i përfshijë fitimet dhe humbjet nga detyrimet që maten me vlerën objektive nëse bëhet fjalë për obligacione që i ka lëshuar banka dhe të cilat janë të mbuluara gjatë gjithë kohës me kërkesat e bankës (obligacione të mbuluara), me ç'rast ekziston lidhje e fortë midis ndryshimeve të vlerës së obligacioneve dhe ndryshimeve në vlerën e kërkesave të mbuluara të bankës, gjegjësisht ndryshimet në vlerën e obligacioneve rrjedhin nga ndryshimet në aftësinë kreditore të bankës.

III.4 Dispozita të tjera

19-f. Para se të përfshihen pozicionet nga pikat 19-a dhe 19-dh të këtij vendimi në llogaritjen e mjeteve të veta, banka është e detyruar të njoftojë Bankën Popullore për kushtet në të cilat kanë ndodhur, dhe të dorëzojë dokumentacionin nga i cili do të mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë vendim për pozitën përkatëse, së paku 30 ditë para synimit për përfshirjen e këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve të veta. Përveç kësaj, banka dorëzon edhe:

- llogaritja e nivelit të mjeteve të veta dhe norma e përshtatshmërisë së kapitalit para dhe pas përfshirjes së këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve të veta me gjendjen e datës për të cilën raportohet;
- projeksioni i totalit të kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, duke përfshirë shtresat mbrojtëse të kapitalit për tre vitet e ardhshme;
- projeksioni i të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës në të cilën është marrë parasysh efekti i përdorimit të pozicioneve, së paku për tre vitet e ardhshme.

Banka mund të mos përfshijë pozicione të caktuara në llogaritjen e mjeteve të veta, të cilat, në pajtim me pikat 16, 19-c dhe 19-e të këtij vendimi, konsiderohen si zëra të zbritshëm, nëse bëhet fjalë për pozicione me karakter të përkohshëm dhe nëse për atë ka marrë pëlqimin e Bankës Popullore. Në pëlqimin nga Banka Popullore është shënuar perioda në të cilën banka mundet të mos i përfshijë ato pozicione si zëra të zbritshëm në llogaritjen e mjeteve të veta.

19-f. Kompensimi që u paguhet instrumenteve nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë dhe kapitali shtesë mund të jetë në formë monetare ose në formë të instrumentit që mund të jetë pjesë e mjeteve të veta të bankës.

19-g. Në zërat e zbritshëm nga pika 16 nënpikat 16.5, 16.6, 16.7, pika 19-c nënpikat 19-c.2, 19-c.3, 19-c.4 dhe pika 19-e nënpikat 19-e.2, 19-e.3 dhe 19-3.4 të këtij vendimi, banka i përfshin vetëm investimet direkte, indirekte dhe sintetike në pozicionet e personave nga sektori financiar të cilët, në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet veprimtaria e këtyre personave, kanë trajtimin e kapitalit rregullator.

Të gjitha instrumentet e tjera që nuk e plotësojnë kushtin nga paragrafi 1 të kësaj pike përfshihen në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar me rrezikun, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi.

Pozicionet nga paragrafi 1 të kësaj pike, Banka i shpërndan në zëra të zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt, nga kapitali bazë shtesë ose nga kapitali shtesë, duke marrë parasysh cilësinë e tyre, të përcaktuar në rregulloren përkatëse me të cilën rregullohet veprimtaria e këtyre personave.

Nëse në bazë të rregullores me të cilat rregullohet veprimtaria e personave nga sektori financiar nuk mund të kryhet shpërndarja nga paragrafi 3 të kësaj pike, pozitat nga paragrafi 1 të kësaj pike zbriten nga kapitali bazë i rregullt i bankës.

19-gj. Pa marrjen e pëlqimit nga Banka Popullore, banka nuk mund ta zvogëlojë shumën e mjeteve të veta përmes:

- 1) Blerje ose zvogëlim të vlerës së instrumenteve që janë pjesë e kapitalit bazë të rregullt;
- 2) Blerje ose shlyerje të instrumenteve që janë pjesë e kapitalit bazë shtesë;
- 3) Blerje ose shlyerje të instrumenteve që janë pjesë e kapitalit shtesë, para afatit të dakorduar të maturimit.

Me përjashtim të pikës 1 të kësaj pike, banka mund të shlyejë instrumentet që janë pjesë e kapitalit të rregullt bazë pa marrjen e pëlqimit nga Banka Popullore, nëse shuma e totalit të instrumenteve të blera nuk tejkalon 1% të shumës totale të atij lloji instrumenti të cilat janë të lëshuara nga banka.

Banka nuk guxon ta publikojë zvogëlimin e vlerës, blerjen ose shlyerjen e parakohshme të pozicioneve nga paragrafi 1 të kësaj pike, para se të marrë pëlqimin e nevojshëm nga Banka Popullore.

Banka Popullore do ta lëshon pëlqimin nga paragrafi 1 të kësaj pike nëse kanë kaluar së paku pesë vjet nga data e lëshimit/miratimit të instrumentit dhe nëse:

- banka ka zëvendësuar këtë instrument me instrument të ri me cilësi më të mirë ose të njëjtë, me ç'rast kostoja e zëvendësimit nuk e rrezikon kapacitetin e bankës për veprimtarinë fitimprurëse, dhe/ose
- banka mund të dëshmojë se mjetet e veta, pas zvogëlimit të tyre për shkak të aktiviteteve nga paragrafi 1 të kësaj pike, do të jenë mbi nivelin e nevojshëm, duke pasur parasysh dispozitat nga pika 10 të këtij vendimi, totali i kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve dhe shtresat mbrojtëse të kapitalit.

Për nevojat e paragrafit 4 alinea 1 të kësaj pike, kostoja e zëvendësimit nuk e rrezikon kapacitetin e bankës për veprimtarinë profitabile nëse kostoja për instrumentin e ri nuk është dukshëm më e lartë se kostoja që banka ka pasur për instrumentin që zëvendësohet, me çka banka do të mund ta mabjë ose rritë profitabilitetin e tij.

Me përjashtim të paragrafit 4 të kësaj pike, Banka Popullore mund të lëshojë pëlqim për blerjen ose shlyerjen e parakohshme të instrumenteve që janë pjesë e kapitalit bazë shtesë dhe kapitalit shtesë dhe para skadimit të pesë viteve nga data e lëshimit/miratimit të tyre, vetëm nëse plotësohen kushtet nga paragrafi 4 alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike dhe nëse:

- për shkak të ndryshimeve rregullatore këto instrumente do të përjashtoheshin nga mjetet e veta ose do të radhiteshin në pozicionet me cilësi më të ulët;
- janë bërë ndryshime në trajtimin tatimor të këtyre instrumenteve, dhe banka mund të dëshmojë se bëhet fjalë për ndryshime të rëndësishme të cilat nuk mund të parashikoheshin në momentin e lëshimit/miratimit të instrumenteve.

Për shkak të marrjes së pëlqimit nga paragrafët 4 dhe 6 të kësaj pike, banka është e detyruar së paku tre muaj para zbatimit të aktiviteteve nga paragrafi 1 të kësaj pike, të dorëzojë në Bankën Popullore së paku:

- arsyetim i detajuar i arsyeve për zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi 1 të kësaj pike;
- projeksioni i nivelit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve për periudhën së paku tre vite, duke marrë parasysh politikën afariste të bankës;
- struktura e mjeteve të veta para dhe pas zbatimit të aktiviteteve nga paragrafi 1 të kësaj pike;
- projeksioni i profitabilitetit për tre vitet e ardhshme, duke pasur parasysh koston për zëvendësimin e instrumentit;
- vlerësimi i rreziqeve ndaj të cilave është ose mund të ekspozohet banka dhe vlerësimi nëse mjetet e veta janë në nivel që mundëson mbulimin e atyre rreziqeve, duke përfshirë edhe rezultatet e testeve të stresit të kryera nga banka.

IV. PORTOFOLI PËR TREGTIM DHE PORTOFOLI I AKTIVITETEVE BANKARE

20. Për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve, banka është e detyruar t'i radhit pozicionet në portofolin për tregtim dhe në portofolin e aktiviteteve bankare.

21. Për shpërndarjen e duhur të pozicioneve në instrumentet financiare dhe mallrat në portofolin për tregtim, qëllimi për përvetësimin e tyre, gjegjësisht për lidhjen e marrëveshjes lidhur me instrumentin financiar ose mallin, duhet të jetë e njohur para përvetësimit, gjegjësisht para lidhjes së marrëveshjes.

Që të mund të përfshihen në portofolin për tregtim, pozicionet në instrumentet financiare dhe mallrat duhet të lirohen nga çfarëdolloj dispozitash kufizuese me të cilat kufizohet mundësia për t'i tregtuar ato lirshëm ose të mbrohet vlera e tyre.

22. Në portofolin e tregtimit mund të shpërndahen pozicionet që i plotësojnë kriteret e këtij kreu dhe të pikës 6 nën pikës 2) të këtij vendimi, dhe atë:

a) instrumentet financiare:

- instrumente pronësore;
- instrumente borxhi;
- derivatet financiare (kontratat fjuqërs dhe forvard, опции, opsinet, svop-kontratat etj.).

b) kontratat repo dhe kontratat për huadhënien e letrave me vlerë ose të mallrave në palën tjetër kontraktuese;

c) kontratat për të huazuar letrat me vlerë ose mallra nga pala tjetër kontraktuese;

ç) provizionet, tarifat, interesat, dividendët dhe marzhet në bazë të derivativeve financiare me të cilat tregtohet në bursë që janë të lidhura direkt me pozicionet e përfshira në portofolin për tregtim;

d) ekspozimi në bazë të kontratës për garancë dhe/ose vendosjen e emetimit të letrave me vlerë.

23. Banka mund ta përfshijë ekspozimin që rezulton nga kontratat-repo me të cilat ajo blen letra me vlerë ose mallra (ang. reverse repo) dhe kontratat për huazimin e letrave me vlerë ose mallrave nga pala tjetër kontraktuese, në portofolin për tregtim nëse plotësohen kushtet në vijim:

- ekspozimi vlerësohet në bazë ditore, në pajtim me vlerën e tregut;
- vlera e sigurimit harmonizohet për çdo ndryshim në vlerën e letrës me vlerë ose të mallit që është objekt i kontratës;
- në pajtim me kontratën, kërkesat e bankës mund të arkëtohen automatikisht dhe menjëherë me kërkesat e palës kontraktuese, nëse pala kontraktuese nuk i përmbush detyrimet e veta;
- pala tjetër është bankë vendase, bankë e huaj me normë të cilësisë së kredisë së paku 2, bursë ose shtëpi kleringu;
- dispozitat e kontratës shprehin qartë synimin e të dyja palëve kontraktuese për lidhjen e këtij lloji të kontratave.

Banka është e detyruar të njoftojë menjëherë Bankën Popullore për secilën mospërmbushje të detyrimeve të palës tjetër kontraktuese në bazë të marrëveshjeve nga paragrafi 1 të kësaj pike.

24. Me përjashtim të pikës 22 të këtij vendimi, derivativet financiare të instaluar të cilët në pajtim me Metodologjinë për regjistrim dhe vlerësim të zërave kontabël dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, konsiderohen si instrumente financiare i veçantë dhe që nuk i plotësojnë kushtet e këtij kreu, nuk përfshihen në portofolin për tregtim.

Banka është e detyruar të menaxhojë me rrezikun që rrjedh nga instrumentet nga paragrafi 1 të kësaj pike dhe, nëse është e nevojshme, në mënyrë përkatëse t'i përfshijë në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tjera.

25. Banka është e detyruar të vendosë dhe të zbatojë politikat përkatëse të shkruara për shpërndarjen e pozicionit të caktuar në portofolin për tregtim ose në portofolin e aktiviteteve bankare. Supozimet për shpërndarjen e pozicionit të caktuar në portofolin e tregtimit ose në portofolin e aktiviteteve bankare dhe aplikimi i tyre duhet të dokumentohen në mënyrë përkatëse, të zbatohen në bazë konsistente dhe të jenë objekt i auditimit të brendshëm të rregullt.

26. Nëse Banka Popullore konstaton se instrumenti i caktuar financiar që është pjesë e portofolit për tregtim nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë kapitull dhe nuk përdoret për tregtim, do të udhëzojë bankën që ta përjashtojë atë instrument nga portofoli për tregtim, pa dallim trajtimit të tij kontabël.

Nëse Banka Popullore konstaton se instrument financiar i caktuar që nuk është pjesë e portofolit për tregtim i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë kapitull dhe përdoret për tregtim, ajo do ta udhëzojë bankën që ta përfshijë atë instrument në portofolin për tregtim, pa dallim trajtimit të tij kontabël.

V. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIQEVE

27. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve paraqet shumën e:

- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë të përcaktuar në pajtim me kreun VI të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të valutës së përcaktuar në pajtim me kreun VII të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dërgesës, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-a të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të palës tjetër kontraktuese, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-b të këtij vendimi;
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave, të përcaktuar në pajtim me kreun IX të këtij vendimi; dhe
- kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operacional, të përcaktuar në pajtim me kreun X të këtij vendimi.

Krahas rreziqeve nga paragrafi 1 të kësaj pike, në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve përfshihen edhe rreziqe të tjera, nëse banka ose Banka Popullore vlerësojnë se ajo është e nevojshme për shkak të natyrës, lloji dhe vllimi i aktiviteteve që i kryen banka (p.sh. rreziku i likuiditetit, rreziku i normave të interesit që rrjedh nga portofoli i aktiviteteve bankare, rreziku i përqendrimit, etj.).

28. Aktivi i ponderuar sipas rrezikut fitohet kur kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve, i përcaktuar në pajtim me pikën 27 të këtij vendimi, do të shumëzohet me 12,5.

29. Me përjashtim të pikës 27 të këtij vendimi, banka nuk është e detyruar të përcaktojë dhe të disponojë me kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor, nëse shuma e pozicionit neto në ar dhe të pozicionit agregat valutor, të përcaktuar në pajtim me kreun VII të këtij vendimi, nuk është më i madh se 2% e mjeteve të veta të bankës.

30. Me përjashtim të pikës 27 të këtij vendimi, banka nuk është e detyruar të përcaktojë dhe të disponojë me kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, nëse:

- shuma e pozicioneve në portofolin e tregtimit zakonisht nuk është më i madh se 5% nga totali i aktiviteteve të bankës dhe njëkohësisht nuk tejkalon 915 milionë denarë; dhe
- shuma e pozicioneve në portofolin e tregtimit asnjëherë nuk tejkalon 6% të totalit të aktiviteteve të bankës dhe njëkohësisht nuk tejkalon 1.220 milionë denarë.

Aktivitetet totale të bankës llogariten si shumë e zërave aktivë të bilancit dhe jashtë bilancit. Banka e përcakton vlerën e zërave aktivë të bilancit dhe jashtë bilancit në pajtim me Metodologjinë për regjistrimin dhe vlerësimin e zërave kontabël dhe për përgatitjen e raporteve financiare.

31. Banka që e ka tejkaluar kufirin nga pika 30 paragrafi 1 alinea 1 së paku tri herë për periudhën prej 30 ditësh, por nuk e ka tejkaluar kufirin nga pika 30 paragrafi 1 alinea 2, është e detyruar të dorëzojë deri te Banka Popullore pasqyrë të vlerës ditore dhe mesatare mujore të portofolit për tregtim në shumën absolute, si dhe pjesëmarrjen në totalin e aktiviteteve, së bashku me arsyetim për tejkalimin e ndodhur të kufirit. Banka duhet të dorëzojë pasqyrën në afat prej tre ditëve nga dita kur është realizuar tejkalimi tretë i kufirit. Në bazë të pasqyrës së dorëzuar dhe arsyesimit, Banka Popullore në afat prej dhjetë ditëve të punës, do të vendos se a duhet banka të fillojë me llogaritjen e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut.

32. Banka që e ka tejkaluar kufirin nga pika 30, paragrafi 1, alinea 2, është e detyruar menjëherë (jo më vonë se një ditë pune) ta njoftojë Bankën Popullore për tejkalimin e ndodhur të kufirit dhe për arsyet për shkak të cilës ka ndodhur tejkalimi. Banka Popullore, në afat prej dhjetë ditëve të punës, e përcakton datën prej së cilës banka është e detyruar të fillojë me llogaritjen e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, përveç nëse në bazë të arsyesimit të fituar konstatohet se tejkalimi i ndodhur i kufirit nga pika 30 paragrafi 1 alinea 2 është i natyrës së jashtëzakonshme.

33. Banka e cila në pajtim me pikat 30, 31 dhe 32, nuk është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, është e detyruar të përcaktojë kapitalin për mbulimin e rrezikut të kredisë për pozicionet e portofolit për tregtim.

34. Për shkak të përcaktimit të duhur të kufijve të parashikuar në këtë kapitull, banka është e detyruar në bazë ditore të monitorojë shumën e pozicioneve nga portofoli për tregtim dhe të pozicioneve që përfshihen në përcaktimin e pozicionit neto në ar dhe pozicionin agregat valutor dhe të sigurojë dokumentacionin e duhur nga i cili do të mund të perceptohet lëvizja e këtyre shumave.

VI. AKTIVI I PONDRUAR SIPAS RREZIKUT TË KREDISË

35. Banka është e detyruar t'i shpërndajë kërkesat e bilancit dhe jashtë bilancit në kategoritë përkatëse të ekspozimit, në pajtim me pikën 37 të këtij vendimi dhe t'u caktojë atyre ponder të përshtatshëm të rrezikshmërisë në varësi të normës së cilësisë së kredisë së debitorit ose kërkesës, të përcaktuar në kreun VI të këtij vendimi.

Kërkesat e bilancit dhe jashtë bilancit shprehen në shumën neto, si diferencë ndërmjet vlerës së tyre kontabël dhe shuma përkatëse e korrigjimit të vlerës, gjegjësisht rezervës së veçantë, premisë ose diskontit dhe efektet nga ndryshimi i vlerës objektive (pa marrë parasysh shumën e amortizimit të akumuluar).

Në rastet kur një kërkesë e caktuar ka pjesë të siguruar dhe të pasiguar, korrigjimi i ndarë i vlerës, gjegjësisht rezerva e veçantë së pari i shpërndahet pjesës së pasiguar të kërkesës.

36. Norma e cilësisë së kredisë, që shërben si bazë për përdorimin e ponderit përkatës të rrezikshmërisë, përcaktohet në bazë të rejtingut kreditor të debitorit ose kërkesës së përcaktuar nga IKR e njohur, në pajtim me rregullat e kapitujve VI dhe XII të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, për kategori të caktuara ekspozimi të përcaktuara në këtë vendim, banka mund të përdorë vlerësimin e kredisë të përcaktuar nga AKI e njohur.

Në rrethana të përcaktuara specifike (luftë, fatkeqësi natyrore dhe situata të tjera emergjente në vend), guvernatori i Bankës Popullore mund të përcaktojë edhe ponder më të lartë të rrezikshmërisë për kërkesat e caktuara të bankës.

37. Për nevojat e këtij vendimi, banka është e detyruar të shpërndajë çdo pozicion të bilancit dhe jashtëbilancit që nuk është pjesë e portofolit për tregtim në një nga kategoritë në vijim të ekspozimeve/pozicioneve:

- 1) Kërkesat nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore;
- 2) Kërkesat nga vetëqeverisja lokale dhe pushteti rajonal;
- 3) Kërkesat nga institucionet publike;
- 4) Kërkesat nga bankat multilaterale të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare;

- 5) Kërkesat nga bankat;
- 6) Kërkesat nga shoqëritë tjera tregtare;
- 7) Portofoli i kredive të vogla;
- 8) Kërkesat e mbuluara me objektet e banimit;
- 9) Kërkesat e mbuluara me objektet afariste;
- 10) Kërkesat me kredi me probleme;
- 11) Kërkesat me rrezikshmëri të lartë;
- 12) Pjesët në fondet e investimeve;
- 13) Pozicione të tjera.

38. Para se të kryhet shpërndarja e kërkesave jashtëbilancit në kategoritë nga pika 37 të këtij vendimi, banka është e detyruar t'i shëndrojë kërkesat e ndara jashtë bilancit në bilancet, me përdorimin e faktorëve të konvertimit nga paragrafi 2 të kësaj pike.

Lartësia e faktorit të konvertimit varet nga shkalla e rrezikut të pranishëm në çdo kërkesë jashtë bilancit, dhe atë:

- 1) 0% për kërkesat jashtë bilancit me rrezik të ulët;
- 2) 20% për kërkesat jashtë bilancit me rrezik të mesëm të ulët;
- 3) 50% për kërkesat jashtë bilancit me rrezik të mesëm;
- 4) 100% për kërkesat jashtë bilancit me rrezik të lartë.

Kërkesa jashtë bilancit me rrezik të ulët janë:

- detyrimet e ndërmarra jashtëbilancit për kreditimin që banka mund t'i revokojë pa kushte në çdo kohë, pa njoftim paraprak të debitorit, në të cilin ekziston mundësia për anulim automatik të detyrimit të bankës në rast të përkeqësimit të aftësisë kreditore të debitorit ose që mbulohen plotësisht, gjegjësisht nuk mbartin rrezik kredie (kredi kornizë të papërdorura të revokueshme pa kushte që banka mund t'i revokojë në në çdo kohë pa njoftim paraprak; garancitë, akreditivet ose pozicionet e tjera jashtë bilancit të mbuluara me mjetet monetare në denarë ose në valutë dhe të ngjashme). Detyrimet e bankës në bazë të marrëveshjes kornizë për kredi miratuar personit fizik mund të konsiderohen si kërkesë jashtë bilancit me rrezik të ulët, vetëm nëse marrëveshja ose rregulloret për mbrojtjen e konsumatorëve (duke përfshirë rregulloret për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë miratimit të kredisë konsumatore) lejojnë revokimin e këtyre detyrimeve nga banka;

Kërkesa jashtë bilancit me rrezik të mesëm të ulët janë:

- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të akreditivave të hapura dokumentare që janë konfirmuar dhe tek të cilët malli që paguhet me akreditivin shërben si instrument për sigurim dhe detyrime të tjera të ndërmarra jashtë bilancit nga marrëveshjet tjera që janë të siguruara në mënyrë të ngjashme,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit për kreditim (p.sh. kreditë kornizë të papërdorura të parevokueshme në bazë të mbitërheqjeve të lejuara në llogaritë rrjedhëse, kartelat kreditore, dhe lloj tjetër i ngjashëm i ekspozimit potencial të rrezikut të kredisë) me afat maturimi/vlefshmërie më së shumti deri në një vit, që banka nuk mund t'i revokojë pa kushte

pa njoftim paraprak të debitorit ose që nuk ofrojnë mundësi për anulimin automatik të detyrimit në rast të përkeqësimit të aftësisë kreditore të debitorit,

- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të garancive të performancës dhe garancive për pjesëmarrje në tender (përfshirë edhe garancitë lidhur me këto garanci, siç janë garancitë për kthimin e avansit) dhe të gjitha garancitë e tjera me të cilat garantohet kryerje e caktuar, gjegjësisht me të cilat nuk garantohet përmbushje detyrim kreditore të caktuar nga debitori.

Kërkesa jashtë bilancit me rrezik të mesëm janë:

- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të akreditiveve të hapura dokumentare që janë konfirmuar, përveç akreditiveve të dokumentuara që përfshihen në pozicionet jashtë bilancit me rrezik të mesëm të ulët,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të garancive doganore, garancitë e pagesës së taksave dhe garancitë e transportit/transitit;
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit (garancitë e pambuluara dhe akreditivat) për pagesë në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të debitorit për pagesë ndaj palës të tretë që rrjedhin nga një marrëdhënie afariste e caktuar, me përjashtim të garancive me të cilat garantohet marrëdhënie kredie;
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit për kreditim (p.sh. kreditë kornizë të papërdorura të parevokueshme në bazë të mbitërheqjeve të lejuara në llogaritë rrjedhëse, kartelat kreditore dhe lloj tjetër i ngjashëm i ekspozimit të mundshëm ndaj rrezikut të kredisë) me afat të dakorduar maturimi/vlefshmërie më shumë se një vit, që banka nuk mund t'i revokojë pa kushte pa njoftim paraprak të debitorit ose që nuk ofrojnë mundësi të anulimit automatik të detyrimit në rast të përkeqësimit të aftësisë kreditore të debitorit.

Kërkesa jashtë bilancit me rrezik të lartë janë:

- garancitë e pambuluara (të cilat nuk janë përfshirë në shkallët e mëparshme të rrezikut) me të cilat garantohet përmbushje e detyrimit kreditor të caktuar nga ana e debitorit,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të marrëveshjeve për derivativët e kredisë,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të në pranimin dhe avalimin e kambialit,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të aktiviteteve që japin të drejtën e regresit,
- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të marrëveshjeve për shitje dhe përsëri blerjen e aktiveve,
- aktive të tjera jashtë bilancit të lidhura me detyrimet e mundshme për kreditim.

39. Me përjashtim të kreut VI.1 të këtij vendimi, banka mund të aplikojë ponder të rrezikshmërisë prej 0% të kërkesave ndaj debitorit me seli në Republikën e Maqedonisë, që është personi amë ose filial i bankës, filial i personit amë të bankës ose personi i cili në pajtim me Ligjin për bankat konsiderohet për person i lidhur me bankën nëse plotësohen kushtet në vijim:

- debitori është bankë ose është kompani financiare holding, institucion financiar ose kompani për shërbime ndihmëse të bankës që është subjekt i rregullores përkatëse të mjaftueshmërisë së kapitalit, që është së paku e barabartë me metodologjinë e parashikuar me këtë vendim;
- debitori dhe banka i përkasin të njëjtit grup bankar dhe janë subjekt i konsolidimit me përdorimin e metodës së konsolidimit të plotë;
- debitori zbaton politika dhe procedura për menaxhimin me rreziqet, të cilat nuk dallohen nga politikat përkatëse dhe procedurat e bankave; dhe
- nuk ekzistojnë materiale rrjedhëse ose të pritshme ose kufizime ligjore në transferimin në kohë të mjeteve monetare në formë të kapitalit ose për pagesën e detyrimeve të debitorit ndaj bankës.

Me përjashtim të kreut VI.1 të këtij vendimi, banka mund të aplikojë ponder të rrezikshmërisë prej 0% të kërkesave nga fondet që janë të themeluara (në tërësi) nga një ose më shumë qeveri qendrore, banka zhvillimi shumëpalëshe ose institucione publike me trajtim të qeverisë qendrore në të cilën, në pajtim me këtë vendim, aplikohet ponder rrezikshmërie prej 0%, me ç'rast burim të vetëm të financimit të këtyre fondeve janë mjetet e paguara të këtyre institucioneve në formën e pjesëve (non leveraged).

40. Me përjashtim të kreut VI.1 të këtij vendimi, të zërave të zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë dhe kapitali shtesë i bankës që paraqesin kërkesa për bilanc, zbatohet ponder i rrezikshmërisë prej 0%.

41. Në rastet kur kërkesë e caktuar është mbuluar me instrument për mbrojtje të kredisë, ponderi i rrezikshmërisë, gjegjësisht shuma e kërkesës përcaktohet duke marrë parasysh dispozitat e kreut VI.2 të këtij vendimi.

42. Nëse për kërkesa të bilancit ose jashtë bilancit nuk është përshkruar mënyra e përcaktimit të ponderit të rrezikshmërisë, banka është e detyruar në ekspozim të tillë të zbatojë ponder të rrezikshmërisë prej 100%.

Kërkesave për të cilat Banka Popullore ka përcaktuar se banka i shpërndau në mënyrë të papërshtatshme në ponder të rrezikshmërisë më të ulët, gjegjësisht me faktor konvertimi më të ulët, banka është e detyruar në dy vitet e ardhshme të aplikojë ponderin e rrezikshmërisë, gjegjësisht faktorin e konvertimit që duhet ta zbatojë në pajtim me dispozitat e këtij vendimi, pavarësisht nëse gjatë këtyre dy viteve janë plotësuar kushtet për aplikimin e ponderit më të ulët të rrezikshmërisë, përkatësisht faktorit të konvertimit, përveç nëse Banka Popullore gjatë këtyre dy viteve ka përcaktuar se janë plotësuar kushtet për aplikimin e ponderit më të ulët të rrezikshmërisë, gjegjësisht faktorit të konvertimit.

43. Produkti ndërmjet shumës së kërkesës i shpërndarë në kategorinë përkatëse të ekspozimit dhe ponderit përkatës të rrezikshmërisë e jep vlerën e ponderuar të kërkesës, e cila përfshihet në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë.

Aktivi i ponderuar sipas rrezikut të kredisë paraqet shumën e vlerës së ponderuar të të gjitha kërkesave të bilancit dhe jashtë bilancit të përcaktuara në pajtim me këtë vendim.

Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë fitohet kur aktivi i ponderuar sipas rrezikut të kredisë do të shumëzohet me 8%.

44. Banka e cila nuk është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut të tregut, në shumën e aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë përfshin edhe rrezikun e kredisë që rrjedh nga pozicionet në portofolin për tregtim me aplikimin e ponderëve përkatëse të rrezikshmërisë dhe faktorët e konvertimit.

VI.1 Përcaktimi i ponderëve të rrezikshmërisë për kategoritë e veçanta të ekspozimit

VI.1.1 Kërkesat nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore

45. Banka është e detyruar kërkesave nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore t'i zbatojë ponderët e rrezikshmërisë të theksuara në tabelën 1 ose në tabelën 2, në varësi të faktit nëse përdoret rejtingu afatgjatë i kredisë të IKR-së së njohur ose përdoret vlerësim i kredisë nga AKI e njohur:

Tabela nr. 1

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponderi i rrezikshmërisë	0%	20%	50%	100%	100%	150%

Tabela nr. 2

Shkalla e cilësisë së kredisë - AKI	0	1	2	3	4	5	6	7
Ponderi i rrezikshmërisë	0%	0%	20%	50%	100%	100%	100%	150%

46. Banka është e detyruar të përdorë ponder të rrezikut prej 100% të kërkesave nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore për të cilat nuk është përcaktuar rejtingu afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur, gjegjësisht vlerësim kredie nga AKI e njohur.

47. Me përjashtim të pikave 45 dhe 46 të këtij vendimi, të kërkesave nga pushteti qendror i Republikës së Maqedonisë dhe të kërkesave nga Banka Popullore zbatohet ponder i rrezikut prej 0%.

48. Me përjashtim të pikave 45 dhe 46 të këtij vendimi, të kërkesave nga Banka Qendrore Europiane zbatohet ponder i rrezikut prej 0%.

VI.1.2 Kërkesat nga vetëqeverisja lokale dhe pushteti rajonal

49. Kërkesave nga vetëqeverisja lokale dhe pushteti rajonal për të cilat ekziston vlerësim afatgjatë i kredisë i përcaktuar nga IKR e njohur Banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët në vijim të rrezikut (Tabela nr. 3):

Tabela nr. 3

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponderi i rrezikshmërisë	20%	50%	50%	100%	100%	150%

Kërkesave nga vetëqeverisja lokale ose pushteti rajonal për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur; Banka është e detyruar t'i përdorë ponderët në vijim të rrezikut:

- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 0%, 20%, 50% ose 100%; ose
- 150% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 150%.

VI.1.3 Kërkesat nga institucionet publike

50. Kërkesave nga institucionet publike për të cilat ekziston vlerësim afatgjatë i kredisë i përcaktuar nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikshmërisë nga tabela në vijim (Tabela nr. 4):

Tabela nr. 4

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponderi i rrezikshmërisë	20%	50%	50%	100%	100%	150%

Kërkesave nga institucionet publike për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i përdorë ponderët në vijim të rrezikshmërisë:

- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 0%, 20%, 50% ose 100%; ose
- 150% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 150%.

51. Me përjashtim të pikës 50 të këtij vendimi, të kërkesave nga institucionet publike që kanë trajtim të qeverisë qendrore, banka i zbaton ponderët e rrezikut nga kreu VI.1.1 i këtij vendimi që i zbatohen kërkesave nga qeveritë qendrore të vendeve në të cilat ndodhet selia e institucionit publik.

Banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikut nga pika 50 e këtij vendimi të kërkesave nga të gjitha institucionet tjera publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

52. Kërkesave nga institucionet publike nga vendet anëtare të Bashkimit European, për të cilin organi kompetent i vendit nuk ka përcaktuar trajtimin e pushtetit qendror, zbatohen ponderët e rrezikut të përcaktuara në pajtim me pikën 50 të këtij vendimi.

53. Institucionet publike nga vendet e treta nuk mund të kenë trajtim të qeverisë qendrore. Kërkesave nga këto institucione publike mund të zbatohet trajtimi i parashikuar në pikën 50 të këtij vendimi vetëm nëse:

- trajtim të tillë ka përcaktuar organi kompetent i vendit të tretë, dhe
- metodologjia për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave është e barabartë në metodologjinë e përcaktuar nga vendet anëtare të Bashkimit European.

54. Kërkesave nga të gjitha institucionet e tjera publike, që nuk përfshihen me pikat 50, 51, 52 dhe 53 të këtij vendimi, përfshihen në kategorinë e kërkesave nga shoqëritë e tjera tregtare, gjegjësisht zbatohen dispozitat e kreut VI.1.6 të këtij vendimi.

VI.1.4 Kërkesat nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe kërkesat nga organizatat ndërkombëtare

55. Për kërkesat nga bankat e zhvillimit shumëpalëshe për të cilat ekziston vlerësim afatgjatë i kredisë i përcaktuar nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikut nga tabela në vijim (Tabela nr. 5):

Tabela nr. 5

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponder i rrezikshmë	20%	50%	50%	100%	100%	150%

Kërkesave nga bankat zhvillimore shumëpalëshe për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim i kredisë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i përdorë ponderët në vijim të rrezikshmërisë:

- 50% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesat nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 0%, 20% ose 50%;
- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 100%; ose
- 150% доколку, nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 150%.

56. Me përjashtim të pikës 55 të këtij vendimi, banka përdor ponder të rrezikshmërisë prej 0% për kërkesat nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit në vijim:

- 1) Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD),
- 2) Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC),
- 3) Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim,
- 4) Banka Aziatike për Zhvillim,
- 5) Banka Afrikane për Zhvillim,
- 6) Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës,
- 7) Banka e Investimeve Nordike,
- 8) Banka e Karaibeve për Zhvillim,
- 9) Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH),
- 10) Banka Europiane e Investimeve (EIB),
- 11) Fondi European i Investimeve,
- 12) Agjencia Shumëpalëshe e Garancisë së Investimeve (MIGA),
- 13) Institucioni Ndërkombëtar Financiar për Imunizimin,
- 14) Banka Islamike për Zhvillim.

Me përjashtim të pikës 1 të kësaj pike, banka është e detyruar të aplikojë ponder të rrezikut prej 20% për pjesën e kapitalit të Fondit European të Investimeve, i cili është rregjistruar, dhe i papaguar.

57. Banka përcakton ponder të rrezikut prej 0% të kërkesave nga organizatat ndërkombëtare.

VI.1.5 Kërkesat nga bankat

58. Kërkesave nga bankat për të cilat është përcaktuar vlerësim afatgjatë të kredisë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët në vijim të rrezikut (Tabela nr. 6):

Tabela nr. 6

Shkalla e	1	2	3	4	5	6
----------------------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

cilësisë së kredisë						
Ponder i rrezikshmërisë	20%	50%	50%	100%	100%	150%

Kërkesave nga bankat për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim i kredisë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i përdorë ponderët në vijim të rrezikshmërisë:

- 50% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesat nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 0%, 20% ose 50%;
- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 100%; ose
- 150% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 150%.

59. Me përjashtim të pikës 58 të këtij vendimi, kërkesave me afat të mbetur maturimi deri në 3 muaj nga bankat për të cilat është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur, banka i zbaton ponderët e rrezikut në vijim (Tabela nr. 7):

Tabela nr. 7

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponder i rrezikshmërisë	20%	20%	20%	50%	50%	150%

Kërkesave me afat maturimi të mbetur deri në 3 muaj nga bankat për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur (nuk është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë për bankën ose për instrumente të tjera financiare të lëshuara prej saj), banka zbaton ponderët në vijim të rrezikshmërisë:

- 20% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesat nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 0% ose 20%;
- 50% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesat nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 50%;
- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet

- ponder i rrezikshmërisë prej 100%; ose
- 150% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponder i rrezikshmërisë prej 150%.

60. Me përjashtim të pikave 58 dhe 59 të këtij vendimi, banka është e detyruar kërkesave të përcaktuara në pikën 183 të këtij vendimi t'i zbaton ponderët e rrezikshmërisë të përcaktuara në pajtim me atë pikë.

61. Banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikshmërisë prej 100% të investimeve të bankës në kapitalin ose mjetet e veta të bankave të tjera, me përjashtim të investimeve që janë zë i zbritshëm nga mjetet e veta të bankës.

62. Për nevojat e këtij kreu, si bankë konsiderohen: bankat dhe shtëpitë kursimore të themeluara në Republikën e Maqedonisë (me përjashtim të Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut), bankat nga vendet anëtare të Bashkimit European dhe bankat e huaja, në mënyrën e përkufizuar në Ligjin për bankat.

VI.1.6 Kërkesat nga shoqëritë e tjera tregtare

63. Në këtë kategori banka përfshin kërkesat nga shoqëri të tjera tregtare, përfshirë kërkesat në bazë të aksioneve në fondet e mbyllura të investimeve, të cilat nuk përfshihen në pjesët e tjera të kreut VI.1 të këtij vendimi.

64. Kërkesave nga shoqëritë e tjera tregtare për të cilat ekziston rejtingu i kredisë afatgjatë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikut nga tabela në vijim (Tabela nr. 8):

Tabela nr. 8

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponder i rrezikshmërisë	20%	50%	100%	100%	150%	150%

Kërkesave nga shoqëritë e tjera tregtare për të cilat nuk është përcaktuar vlerësim afatgjatë i kredisë nga IKR e njohur, banka zbaton ponderët në viim të rrezikut:

- 100% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponderë i rrezikshmërisë prej 0%, 20%, 50% ose 100%;
- 150% nëse në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi të kërkesave nga qeveria qendrore e vendit në të cilin ndodhet selia e debitorit u ndahet ponderë i rrezikshmërisë prej 150%.

65. Me përjashtim të pikës 64 të këtij vendimi, banka është e detyruar të kërkesave të përcaktuara në pikën 183 të këtij vendimi t'i zbatojë ponderët e rrezikshmërisë të përcaktuara në pajtim me atë pikë.

VI.1.7 Portofoli i kredive të vogla

66. Banka aplikon ponderët e rrezikshmërisë prej 75% të kërkesave që i plotësojnë kriteret e këtij kreu për përfshirje në portofolin e kredive të vogla.

Banka është e detyruar të aplikojë ponder të rrezikshmërisë prej 100% të kërkesave nga personat fizik që nuk i plotësojnë kriteret e këtij kreu për përfshirje në portofolin e kredive të vogla.

Banka është e detyruar të kërkesave nga MD që nuk i plotësojnë kriteret e këtij kreu për përfshirje në portofolin e kredive të vogla, të zbatojë ponderët e rrezikshmërisë në pajtim me kreun VI.1.6 të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj pike, banka është e detyruar të zbatojë ponderët e rrezikshmërisë prej 150% të kërkesave në bazë të kredive konsumatore me afat maturimi të rënë dakord që është e barabartë me ose më e gjatë se tetë vjet.

Banka është e detyruar t'i zbatojë dispozitat e paragrafit 4 të kësaj pike të kredive konsumatore me afat maturimi të rënë dakord të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet të miratuara pas 1 janarit të vitit 2016, duke përfshirë kreditë konsumatore tek të cilat banka ka vazhduar afatin e maturimit pas 1 janarit të vitit 2016, me ç'rast afati total i maturimit i kredisë, i përcaktuar si shumë e afatit të maturimit kontraktual më 1 janar të vitit 2016 dhe të gjitha vazhdimeve të afatit të maturimit të kredisë është e barabartë ose më të gjatë se tetë vjet.

Gjatë përcaktimit në afatin total të maturimit nga paragrafi 5 i kësaj pike nuk merret parasysh vazhdimi i afatit të maturimit të kredive konsumatore të kryer në periudhën prej 25 mars deri më 30 shtator të vitit 2020, në pajtim me pikën 58-b të Vendimit për metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 149/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 76/20 dhe 116/20).

66-a. Banka është e detyruar të zbatojë ponder të rrezikshmërisë prej 75% të diferencës pozitive midis:

- ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara në llogaritë e transaksionit (balancat negative në llogaritë rrjedhëse) dhe në kartelat e kreditit të lëshuara në datën për të cilën raportohet, dhe
- ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara në llogaritë e transaksionit (balancat negative në llogaritë rrjedhëse) dhe në kartelat e kreditit të lëshuara më 31 dhjetor të vitit 2015.

Për nevojat e paragrafit 1 të kësaj pike, ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të llogarive të transaksionit dhe kartelave të lëshuara të

kreditit përcaktohet si shumë e kërkesave të bilancit dhe jashtë bilancit në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të llogarive të transaksionit dhe të kartelave të lëshuara të kreditit, pa marrë parasysh faktorët e konvertimit dhe instrumentet për mbrojtjen e kredisë.

67. Kërkesë e caktuar mund të përfshihet në kategorinë e portofolit të kredive të vogla, nëse plotësohen kriteret në vijim:

- debitori është person fizik ose MD;
- ekspozimi total i bankës, personit amë dhe filialet e tij ndaj debitorit dhe personat e lidhur me të, nuk tejkalon 6.000.000 denarë, me ç'rast merret parasysh vetëm pjesa e bilancit të ekspozimit. Në përcaktimin e ekspozimit të totalit nuk përfshihet ekspozimi i mbuluar me objekt banimi dhe afarist që i plotëson kriteret nga kapitujt VI.1.8 dhe VI.1.9 të këtij vendimi;
- ekspozimi nuk është investim në letra me vlerë; dhe
- ekspozimi është pjesë e grupit ekspozimesh me karakteristika të ngjashme (nënportofolet e kredive të vogla), për shkak se portofoli është mjaft i diversifikuar, në pajtim me pikën 68 të këtij vendimi.

Nëse ekspozimi i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1, alinea 2 të kësaj pike nuk e tejkalon shumën prej 6.000.000 denarë, banka mund në portofolin e kredive të vogla të përfshijë ekspozimin jashtëbilancit ndaj debitorit dhe personat lidhur me të.

Banka është e detyruar të ndërmarrë aktivitetet përkatëse për marrjen e informacioneve dhe të dhëna të nevojshme për përcaktimin e ekspozimit total ndaj debitorit.

68. Portofoli i kredive të vogla konsiderohet mjaft i diversifikuar nëse:

- banka në politikat dhe procedurat e saj të brendshme i ka përcaktuar nënportofolet e kredive të vogla që përbëhen nga të njëjtat produkte kreditore
- ekspozimi i bankës (i bilancit dhe jashtë bilancit) ndaj debitorit dhe personat të lidhur me të, e cila i plotëson kushtet nga pika 67 paragrafi 1 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, është i barabartë ose më pak se 0,2% të shumës totale të portofolit të kredive të vogla.

Si produkte të njëjta krediti konsiderohen produktet me nivel të ngjashëm të rrezikut të kredisë, duke marrë parasysh karakteristikat e debitorit, qëllimin e produktit ose disa karakteristika të tjera të ngjashme (shembuj të të njëjtave produkte krediti: kartela kreditore, kredi konsumatore, kredi për makina, kredi studentore dhe të ngjashme).

69. Për nevojat e kësaj pike dhe pikave 67 dhe 68 të këtij vendimi, ekspozimi total përcaktohet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe shumës përkatëse të premisë ose diskontit dhe efekteve të ndryshimeve në vlerën objektive, por nuk merret parasysh shuma e korrigjimit të vlerës, gjegjësisht rezervës së veçantë dhe shumës së amortizimit të akumuluar.

Gjatë përcaktimit të ekspozimit total ndaj debitorit dhe personave të lidhur me të dhe shumës totale të portofolit të kredive të vogla, nuk merren parasysh instrumentet për uljen e rrezikut të kredisë nga kreu VI.2 të këtij vendimi dhe faktorët e konvertimit nga pika 38 e këtij vendimi.

VI.1.8 Kërkesat e mbuluara me objektet e banimit

70. Banka aplikon ponder të rrezikshmërisë prej 35% të kërkesave ose pjesë të kërkesave që janë të mbuluara me hipotekë të ndërtesës së banimit dhe që i plotësojnë kriteret e pikës 71 të këtij vendimi.

Banka shpërndan të gjitha kërkesat e tjera të mbuluara me hipotekë të ndërtesës së banimit, të cilat nuk plotësojnë kriteret e pikës 71 të këtij vendimi, në kategorinë përkatëse të ekspozimit ose i përfshin në portofolin e kredive të vogla nëse kushtet e kreut VI.1.7. janë plotësuar nga ky vendim.

71. Ponderi i rrezikshmërisë prej 35% zbatohet në kërkesat që i plotësojnë kriteret në vijim:

- hipoteka i referohet një objekti banimi në të cilin jeton ose do debitori ose ndonjë debitor jeton, si pronar i objektit, e lëshon me qira për banim, në bazë të marrëveshjes për qira;
- vlera e objektit të banimit nuk varet shumë nga kredia e aftësisë së debitorit, duke mos marrë parasysh ndikimin që mund ta kenë faktorët makroekonomikë në vlerën e objektit të banimit dhe në aftësinë kreditore të debitorit (p.sh. debitori është njëkohësisht person që është investitor ose i kryen punimet e ndërtimit lidhur me ndërtimin e objektit të ndërtesës së banimit, ku debitori ka pjesëmarrje të konsiderueshme në tregun përkatës);
- mundësia e pagesës së kërkesës (rreziku i kredisë nga debitori) nuk varet në mënyrë të konsiderueshme nga hyrjet monetare të cilat ndodhin si rezultat i përdorimit të ndërtesës së banimit, por nga aftësia e debitorit për t'i paguar detyrimet e tij nga burime të tjera të rregullta të mjeteve;
- banka e vlerëson vlerën e tregut të objektit të banimit së paku një herë në vit. Banka është e detyruar të ofrojë vlerësim mbi vlerën e tregut të objektit dhe në periudhë më të shkurtër, nëse ndodh rënie e ndjeshme e çmimeve të tregut të objekteve të ngjashme të banimit ose nëse kërkesa e mbuluar me objektin e banimit tejkalon 5% të mjeteve të veta të bankës. Vlerësimi i vlerës së tregut të objektit të banimit kryhet në pajtim me ligjin;
- banka posedon dokumentacion të rregullt për objektin e banimit që ka marrë peng i cili përbëhet nga: akt noterial me bashkëngjitje për hipotekë të vendosur mbi objektin, duke përfshirë klauzolë për përmbarim, listë pronësie ose dëshmi tjetër nga institucioni kompetent për hipotekë të vendosur mbi objektin e banimit, polisë sigurimi të

objektit të banimit të vinkuluar në dobi të bankës dhe dokumentacion tjetër përkatës; dhe

- shumën totale të kërkesës, pa e ulur për shumën e korigjimit të veçantë të vlerës, gjegjësisht rezervës së veçantë dhe pa u korigjuar për faktorët e konvertimit dhe instrumentet e mbrojtjes së kredisë, nuk është më e madhe se 75% e vlerës së tregut të objektit të banimit, e përcaktuar në pajtim me pikën 4 të kësaj pike.

VI.1.9 Kërkesat e mbuluara me objektet afariste

72. Banka është e detyruar të zbatojë ponderë të rrezikshmërisë prej 100% të kërkesave të mbuluara me hipotekë të objektit afarist.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka mund të aplikojë ponderë të rrezikshmërisë prej 75% të kërkesës të mbuluar me hapësirë afariste nëse:

- hapësira afariste përdoret për kryerjen e veprimtarisë së debitorit;
- hapësira afariste është në pronësi të debitorit/bashkë kërkuar i kredisë;
- vlera e hapësirës afariste nuk varet ndjeshëm nga aftësia kreditore e debitorit, duke mos marrë parasysh ndikimin që mund të kenë faktorët makroekonomikë në vlerën e hapësirës afariste dhe në aftësinë kreditore të debitorit;
- shumën totale të kërkesës, pa e ulur shumën e korigjimit të veçantë të vlerës, gjegjësisht rezervës së veçantë dhe pa e korigjuar për faktorët e konvertimit dhe instrumentet e mbrojtjes së kredisë, nuk është më e madhe se 50% e vlerës së tregut të hapësirës afarist;
- në mënyrë përkatëse janë plotësuar kriteret nga pika 71 alinetë 4 dhe 5 të këtij vendimi.

VI.1.10 Kërkesat me probleme

73. Për pjesën e pasiguruar të kërkesave me probleme, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët në vijim të rrezikshmërisë:

- 150%, nëse korigjimi i vlerës është më i vogël se 20% nga pjesa e pasiguruar e kërkesës ose
- 100%, nëse korigjimi i vlerës është së paku 20% e pjesës së pasiguruar të kërkesës.

74. Me përjashtim të pikave 70 dhe 73 të këtij vendimi, banka zbaton ponderë të rrezikshmërisë prej 100% të kërkesave me probleme që i plotësojnë kriteret e pikës 71 të këtij vendimi.

75. Banka mund ta përjashtojë kërkesën nga kategoria e kërkesave me probleme në atë moment kur, në pajtim me Vendimin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë, kërkesa më nuk do të ketë statusin e kërkesës me probleme.

VI.1.11 Kërkesat me rrezik të lartë

76. Banka është e detyruar në kërkesat me rrezik të lartë të zbatojë ponderë të rrezikshmërisë prej 150%, pavarësisht nëse bëhet fjalë për kërkesë me probleme ose lloj tjetër kërkesë për të cilin, në pajtim me pjesët e tjera të kreut VI.1 të këtij vendimi, lejohet zbatimi i ponderit më të ulët të rrezikshmërisë.

77. Banka është e detyruar në aktet e saj të brendshme t'i identifikojë kërkesat që kanë trajtimin e kërkesave me rrezikshmëri të lartë, duke pasur parasysh dispozitat e këtij vendimi.

VI.1.12 Ekspozimet në formën e pjesëve në fondet e investimeve

78. Për ekspozimet në formën e pjesëve në fondet e investimeve që kanë vlerësim kredie të ndarë nga IKR e njohur, banka është e detyruar t'i zbatojë ponderët e rrezikshmërisë të shënuara në tabelën në vijim (Tabela nr. 9):

Tabela nr. 9

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponder i rrezikshmërisë	20%	50%	100%	100%	150%	150%

Si ekspozime në formën e pjesëve në fondet e investimeve, konsiderohen pjesët në fondet e hapura të investimeve.

79. Banka zbaton ponderë të rrezikshmërisë prej 100% të ekspozimeve në formën e pjesëve në fondet e investimeve për të cilat nuk ekziston vlerësim afatgjatë të kredisë nga IKR e njohur.

Për ekspozimet në formën e pjesëve në fondet e investimeve private, banka zbaton ponder të rrezikshmërisë prej 150%.

VI.1.13 Pozicione të tjera

80. Banka është e detyruar të zbatojë ponder të rrezikshmërisë prej 100% për të gjitha pozicionet e tjera që nuk përfshihen në ndonjë nga kategoritë e mëparshme të ekspozimeve. Në këtë kategori, ndër të tjera, përfshihen pozicionet në vijim:

- investimet në kapitalin e personave të tjerë juridikë dhe investimet tjera kapitale (me përjashtim të investimeve të cilat përfaqësojnë zë të zbritshëm nga kapitali bazë i rregullt, kapitali bazë shtesë dhe kapitali shtesë i bankës). Këto investime klasifikohen në kategorinë e së cilës i përket personi juridik, me ç'rast aplikohet ponderi i rrezikshmërisë prej 100%;
- kërkesat nga shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet, kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze dhe organizatat e tjera jofitimprurëse;

- mjetet bazë.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka aplikon ponderë të rrezikshmërisë prej 0% të mjeteve monetare, ekuivalentët monetare dhe ari, ndërsa për mjetet monetare në procedurën e arkëtimit aplikon ponderë të rrezikshmërisë prej 20%.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, të marrëveshjeve për shitjen definitive të planifikuar të aktiveve dhe shitjen e aktiveve me detyrim për riblerjen e saj (marrëveshjet repo), banka zbaton ponderin e rrezikshmërisë që i referohet aktiveve që është subjekt i marrëveshjes, dhe jo ponderi i rrezikshmërisë që i referohet palës tjetër kontraktuese.

VI.2 Instrumentet për mbrojtjen e kredisë

81. Gjatë përcaktimit të vlerës së ponderuar të kërkesës e cila përfshihet në aktivin e ponderuar sipas rrezikut të kredisë, banka mund të marrë parasysh ndikimin e instrumenteve të mbrojtjes së kredisë, në pajtim me kushtet dhe mënyrën e përcaktuar në të gjithë kreun VI. 2 të këtij vendimi.

82. Shuma e vlerës së ponderuar të kërkesës, e përfshirë si rezultat i efekteve nga instrumenti i mbrojtjes së kredisë, nuk mund të jetë më e madhe se shumta e vlerës së ponderuar të kërkesës pa marrë parasysh dispozitat e këtij kreu.

Nëse efektet e përdorimit të instrumentit për mbrojtjen e kredisë janë tashmë të përfshirë në përcaktimin e vlerës së ponderuar të kërkesës (p.sh. instrumenti ndikon në vlerësimin e kredisë së kërkesës ose të debitorit), ai instrument nuk mund të përdoret si instrument për mbrojtjen e kredisë.

Në rastet kur banka përdor më shumë instrumente për mbrojtjen e kredisë të një kërkesë, banka është e detyruar të ndajë shumën e kërkesës sipas shumës së instrumenteve të veçanta për mbrojtjen e kredisë dhe të përcaktojë shumën e vlerës së ponderuar të kërkesës për secilën pjesë të veçantë.

83. Banka është e detyruar në kuadër të politikave dhe procedurave të veta për administrim me rrezikun e kredisë t'i përcaktojë instrumentet për mbrojtjen e kredisë që i përdor, procedurën dhe aktivitetet për fitimin e tyre, si dhe mënyrën e administrimit me rreziqet nga aplikimi i këtyre instrumenteve (p.sh. rreziku ligjor, operacional, i tregut dhe i likuiditetit dhe rreziqe të tjera të ngjashme).

84. Instrumentet e mbrojtjes së kredisë mund të jenë të financuara ose të pafinancuara.

Instrumentet e financuara për mbrojtjen e kredisë janë instrumentet që i plotësojnë kushtet e kreut VI.2.1 të këtij vendimi dhe mund të përdoren gjatë përcaktimit të aktiveve të ponderuara sipas rrezikut të kredisë në mënyrën e përcaktuar në atë pjesë.

Instrumentet e pafinancuara për mbrojtjen e kredisë përdoren gjatë përcaktimit të aktiveve të ponderuara sipas rrezikut të kredisë sipas kushteve dhe në mënyrën e përcaktuar në kreun VI.2.2 të këtij vendimi.

85. Banka është e detyruar gjatë përcaktimit të vlerës së ponderuar të kërkesës të marrë parasysh ndikimin e mosharmonizimit të maturitetit që ka ndodhur si rezultat i afatit më të shkurtër të maturimit të mbetur ose afatit të vlefshmërisë të instrumentit për mbrojtjen e kredisë nga afati i mbetur i maturimit të kërkesës të cilës i referohet.

Gjatë përcaktimit të ndikimit të mos harmonizimit të afatit, merren parasysh rregullat në vijim:

- a) afati i mbetur i maturimit të kërkesës është i barabartë me afatin më të shkurtër prej: (1) afatit më të gjatë të mbetur në të cilin debitori është i detyruar të përmbushë plotësisht detyrimin e tij ose (2) pesë vjet;
- b) afati i mbetur i maturimit të instrumentit për mbrojtjen e kredisë është i barabartë me datën më të afërt në të cilën mund të përdoret ose të pushojë së ekzistuari instrumenti për mbrojtjen e kredisë, gjegjësisht në të cilën ofruesi i instrumentit për mbrojtjen e kredisë mund të tërheqë instrumentin e dhënë;
- c) nëse instrumenti për mbrojtjen e kredisë është i ndarë në shumë që mbërrijnë në disa afate të ndryshme të maturimit, banka është e detyruar të ndajë shumën e instrumentit sipas afateve të ndryshme të maturimit dhe në mënyrë përkatëse të përcaktojë shumën e vlerës së ponderuar të kërkesës për secilën pjesë të veçantë.

VI.2.1 Instrumentet e financuara për mbrojtjen e kredisë

86. Për nevojat e këtij vendimi, si instrumente të financuara për mbrojtjen e kredisë konsiderohen:

- sigurinë financiare nga kreu VI.2.1.1 i këtij vendimi;
- netimin e bilancit nga kreu VI.2.1.2 të këtij vendimi, dhe
- instrumentet financiare të tjera nga kreu VI.2.1.3 të këtij vendimi.

Instrumentet financiare për mbrojtjen e kredisë nga paragrafi 1 të kësaj pike mund të përdoren për nevojat e përcaktimit të aktiveve të ponderuara sipas rrezikut të kredisë, nëse i plotësojnë të gjitha kushtet e përkufizuara në kreun VI.2.1 të këtij vendimi.

Me përjashtim të pikës 85 të këtij vendimi, banka nuk mund të përdorë instrumentin e financiar për mbrojtjen e kredisë në përcaktimin e vlerës së ponderuar të kërkesës, nëse ai ka afat maturimi më të shkurtër të mbetur se afati maturimit të mbetur të kërkesës të cilit i referohet.

VI.2.1.1 Sigurimi financiar

87. Si siguri financiare konsiderohen instrumentet në vijim të financuara për mbrojtjen e kredisë, vetëm nëse i plotësojnë kushtet e pikës 88 të këtij vendimi:

- depozitat monetare ose ekuivalentët monetarë dhe ari në bankë;
- instrumentet e borxhit të emetuara nga qeveria qendrore e Republikës së Maqedonisë dhe Banka Popullore dhe nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore që kanë vlerësim kredie nga IKR ose AKI e njohur për të cilën është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë së kredisë të barabartë ose më të mirë se 4, në pajtim me rregullat e pikës 45 të këtij vendimi (duke përfshirë edhe instrumentet e lëshuara nga personat nga paragrafi 2 i kësaj pike me shkallë të cilësisë kreditore të barabartë ose më të mirë se 4);
- instrumentet e borxhit të emetuara nga bankat dhe kompanitë tjera tregtare që kanë vlerësim të njohur të kredisë afatgjatë nga IKR e njohur që është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë së kredisë e barabartë ose më e mirë se 3, në pajtim me rregullat nga, pika 58 paragrafi 1 dhe pika 64 paragrafi 1 të këtij vendimi (duke përfshirë instrumentet e lëshuara nga personat nga paragrafi 3 të kësaj pike me shkallë të cilësisë së kredisë të barabartë ose më të mirë se 3);
- instrumentet e borxhit të emetuara nga bankat dhe kompanitë tjera tregtare që kanë vlerësim të njohur të kredisë afatshkurtër nga IKR e njohur që është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë së kredisë e barabartë ose më e mirë se 3, në pajtim me rregullat nga pikat 60, 65 dhe 183 të këtij vendimi;
- instrumentet e borxhit të lëshuara nga bankat me seli jashtë Republikës së Maqedonisë të cilat nuk kanë vlerësim kreditor nga IKR e njohur, nëse i plotësojnë kushtet e paragrafit 4 të kësaj pike;
- instrumentet e borxhit të emetuara nga bankat me seli në Republikën e Maqedonisë që kuotojnë në Bursën e Maqedonisë SHA Shkup;
- pjesë në fondet investuese nëse janë të plotësuara kushtet nga paragrafi 5 i kësaj pike;
- aksione ose obligacione të konvertueshme që përfshihen në indeksin kryesor të aksioneve (si indeksi kryesor të aksioneve të Bursës maqedonase SHA Shkup konsiderohet indeksi maqedonas i aksioneve - MBI10).

Si instrumente të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore nga paragrafi 1 alinea 2 të kësaj pike konsiderohen edhe instrumentet e borxhit të emetuara nga:

- institucionet publike që kanë trajtim të qeverisë qendrore për të cilat zbatohet ponderë i rrezikshmërisë në pajtim me pikën 51 paragrafi 1 të këtij vendimi;
- bankat e zhvillimit shumëpalëshe për të cilat aplikohet ponderi i rrezikshmërisë prej 0%, në pajtim me pikën 56 të këtij vendimi;
- organizatat ndërkombëtare për të cilat aplikohet ponderi i rrezikshmërisë prej 0%, në pajtim me pikën 57 të këtij vendimi.

Si instrumente borxhi nga paragrafi 1 alinea 3 të kësaj pike konsiderohen edhe instrumentet e borxhit të emetuara nga:

- vetëqeverisja lokale dhe pushteti rajonal, në pajtim me pikën 49 paragrafi 1 të këtij vendimi;
- bankat shumëpalëshe të zhvillimit në pajtim me pikën 55 paragrafi 1 ky vendim,
- institucionet publike, në pajtim me pikën 50 paragrafi 1 të këtij vendimi.

Instrumentet e borxhit të lëshuara nga bankat me seli jashtë Republikës së Maqedonisë, të cilat nuk kanë vlerësim kredie nga IKR e njohur, mund të konsiderohen si siguri financiare nëse plotësohen kushtet në vijim:

- instrumentet kuotojnë në bursë të njohur;
- të gjitha instrumentet e tjera financiare të emetuara nga ajo bankë të cilat janë me të njëjtin prioritet të arkëtimit si dhe instrumenti i financuar për mbrojtjen e kredisë, kanë vlerësim të kredisë prej IKR të njohur për të cilën është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë së kredisë prej së paku 3, në pajtim me rregullat e kreut VI.1.5 të këtij vendimi;
- banka ka informacione në bazën e të cilit mund të konkludojë se instrumenti i financuar për mbrojtjen e kredisë duhet të ketë vlerësim që është më i favorshëm se vlerësimi për të cilën është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë së kredisë prej së paku 3, dhe
- banka është e sigurt se instrumenti i borxhit mund lehtë të shitet në treg.

Pjesët në fondet e investimeve mund të konsiderohen si siguri financiare vetëm nëse plotësohen kushtet në vijim:

- çmimi i pjesëve publikohet në bazë ditore dhe
- fondi i investimit kufizohet të investojë vetëm në instrumentet që mund të njihen si siguri financiare, në pajtim me dispozitat e kësaj pike.

Nëse instrumentet e borxhit nga paragrafi 1, alinetë 2, 3 dhe 4 kanë vlerësim kredie prej dy IKR të njohura, banka aplikon vlerësimin më pak të favorshëm të kredisë. Nëse këto instrumente borxhi kanë vlerësime krediti prej tre ose më shumë IKR të njohura, banka është e detyruar të veçojë dy vlerësimet e kreditit më të favorshmet dhe të aplikojë më pak të favorshmet nga këto dy vlerësime.

88. Sigurimi financiar nga pika 87 të këtij vendimi duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- a) Ekziston lidhje e ulët (korrelacioni), gjegjësisht nuk ekziston lidhje materiale pozitive (korrelacioni) ndërmjet aftësisë kreditore të debitorit dhe vlerës së sigurisë financiare. Lidhje materiale pozitive ekziston kur sigurimi është lëshuar nga debitori ose personi i lidhur me debitorin. Letrat me vlerë të emetuara nga debitori ose personi i lidhur me të nuk mund të njihen si siguri financiare;

- b) Ekziston siguri juridike, dhe atë:
- në pajtim me marrëveshjen e sigurimit financiar banka ka të drejtë pa vonesë të arketojë ose të mbajë sigurimin në rast të mospagesës së kërkesës, paaftësia paguese ose hapja e procedurës së falimentimit ndaj debitorit ose personit me të cilin ndodhet siguria financiare ose në rast të realizimit të ndonjë ngjarjeje tjetër kontraktuale,
 - banka është e detyruar t'i përmbushë të gjitha detyrimet kontraktuale dhe ligjore dhe t'i ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme që të mund marrëveshja për sigurimin financiar të kryhet pa kurrfarë kufizimesh, në pajtim me rregullat që vlejnë për këtë lloj marrëveshjesh,
 - për marrëveshjet e sigurimit financiar që përfshijnë zbatim të rregulloreve nga një vend tjetër, banka është e detyruar të marrë mendim juridik nga një avokat nga vendi rregulloret e të cilit zbatohen, me të cilën konfirmohet mundësia e kryerjes së marrëveshjes në pajtim me rregulloret e shtetit tjetër. Përveç kësaj, që të sigurohet banka që marrëveshja për sigurim financiar mund të kryhet pa kurrfarë kufizimesh, ajo është e detyruar, së paku një herë në vit gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, të marrë mendim juridik shtesë nga një avokat nga vendi, rregullat e të cilit zbatohen për mundësinë e kryerjes së tij;
- c) Janë përmbushur kërkesat operacionale të cilat i referohen detyrimit të bankës:
- të ketë marrëveshje me shkrim për sigurinë financiare dhe procedurat e përcaktuara për aktivizimin e tij në kohë,
 - të vendosë dhe zbatojë politika dhe procedura të përshtatshme për kontroll të rreziqeve që rrjedhin nga përdorimi i sigurisë financiare. Krahas rreziqeve nga pika 83 e këtij vendimi, kontrolli duhet t'i mbulojë edhe rreziqet nga joefikasiteti ose reduktimi i efikasitetit të sigurimit financiar, përfundimit të tij, rreziqet të cilat rrjedhin nga vlerësimi i tij, rreziku i përqendrimit të llojeve të veçanta të sigurimit financiar, etj,
 - të vendosë dhe të zbatojë politika ose procedura me të cilat përkufizohen llojet dhe shumat e pranueshme të sigurisë financiare,
 - rregullisht ta përcaktojë vlerën e tregut të sigurisë financiare, që nënkupton harmonizimin e vlerës së saj me vlerën e tregut së paku një herë në tremujor ose më shpesh, nëse vjen në ndryshim të rëndësishëm në çmimet e tregut ose nëse kërkesa e siguruar tejkalon 5% të mjeteve të veta të bankës;
 - nëse siguria financiare mbahet nga një palë e tretë - kujdestar i pronës, instrumenti të mos jetë pjesë e aktivitetit të kujdestarit të pronës, por të mbahet në llogari të veçantë.

89. Kërkesave që janë të mbuluara me siguri financiare që i plotëson kriteret e këtij kreu, banka e zbaton ponderin e rrezikshmërisë që do të aplikohet në rastin e ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj atij sigurimi (ponderi i rrezikshmërisë së sigurimit).

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, të kërkesave të mbuluara me:

- sigurimi financiar nga pika 87 paragrafi 1 alinea 6 dhe me instrumentet pronësore që janë pjesë e MBI10, banka aplikon ponderë të rrezikshmërisë prej 50%,
- ari në bankë, banka aplikon ponderë të rrezikshmërisë prej 20%, dhe
- depozitimi monetar në bankën, banka aplikon ponderë të rrezikshmërisë prej 0%.

Gjatë përcaktimit të lartësisë së mbulimit të kërkesës me sigurinë financiare dhe përcaktimin e vlerës së ponderuar të kërkesës, banka është e detyruar t'i respektojë rregullat në vijim:

- ponderi i rrezikut të sigurimit zbatohet vetëm në pjesën e siguruar të kërkesës. Në pjesën e pasiguruar të kërkesës aplikohet ponderi i rrezikut në pajtim me kategorinë e ekspozimit në të cilën shpërndahej kërkesa;
- merret parasysh shuma e vlerës së tregut të sigurimit financiar, i përcaktuar në pajtim me pikën 88 nënpika c) alinea 4 e këtij vendimi;
- ponderi më i ulët i rrezikshmërisë që e zbaton banka të kërkesave të mbuluara me sigurim financiar nuk mund të jetë më e ulët se 20%, me përjashtim të rasteve nga paragrafi 2 të kësaj pike dhe pikave 90 dhe 91 të këtij vendimi;
- në rast të mos harmonizimit të valutës ndërmjet kërkesës dhe sigurimit financiar, vlera e tregut të sigurimit financiar korrigjohet me zbatimin e formulës në vijim:

$$G^* = G \times (1 - 0,08), \text{ ku:}$$

G e paraqet vlerën e tregut të sigurimit financiar G^* e paraqet shumën e korrigjuar të sigurimit financiar që merret parasysh gjatë përcaktimit të shumës së pjesës së siguruar të kërkesës.

90. Kërkesës së mbuluar me sigurim financiar të ndodhur në bazë të marrëveshjes repo ose marrëveshje për dhënie kredi ose huadhënien e letrave me vlerë, banka mund të aplikojë ponderë të rrezikshmërisë prej 0%, nëse plotësohen kushtet në vijim:

- kërkesa dhe sigurimi financiar janë depozitë në para, mjetet monetare ose ekuivalentët monetar ose instrumente borxhi të lëshuara nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore për të cilat, në pajtim me kreun VI.1.1 të këtij vendimi, zbatohet ponderi i rrezikshmërisë prej 0%;
- kërkesa dhe sigurimi financiar shprehen në të njëjtën valutë;
- afati i maturimit të marrëveshjes nuk është më i gjatë se një ditë (p.sh. marrëveshjet e repove njëditore) ose kryhet në bazë ditore të tregut harmonizimi i vlerës së kërkesës dhe vlera e sigurimit financiar ose në

bazë ditore mbulohet diferenca në çmimin e tregut (ang. daily remargining);

- periudha ndërmjet datës së harmonizimit të fundit me çmimin e tregut kur debitori nuk e ka kryer detyrimin e tij për të paguar diferencën në çmimin e tregut dhe data e kryerjes së sigurimit, nuk mund të jetë më e gjatë se katër ditë;
- shlyerja kryhet përmes sistemit të shlyerjes i cili përdoret rregullisht për këtë lloj të pozicioneve;
- marrëveshja është lidhur në bazë të dokumentacionit standard që përdoret për këtë lloj të pozicioneve;
- në pajtim me marrëveshjen, palët kontraktuese kanë të drejtë të anulojnë ose refuzojnë kontratën, në rast të mospërbushjes së detyrimeve të palës tjetër kontraktuese;
- pala tjetër është pjesëmarrëse kryesor në treg. Si pjesëmarrës kryesor i tregut konsiderohen personat në vijim:
 - a) qeveritë qendrore ose bankat qendrore për të cilat zbatohet ponderi i rrezikshmërisë prej 0%;
 - b) bankat;
 - c) institucionet tjera financiare, duke përfshirë edhe kompanitë e sigurimit, për të cilat zbatohet ponder i rrezikshmërisë prej së paku 20%;
 - ç) zyrat e kleringut të autorizuar.

Nëse marrëveshjet repo ose marrëveshjet për dhënie të kredisë ose huadhënien e letrave me vlerë të mbuluara me sigurim financiar plotësojnë të gjitha kushtet e paragrafit 1 të kësaj pike, përveç kushtit që pala tjetër kontraktuese të jetë pjesëmarrëse bazë e tregut, në ato pozicione banka mund të aplikojë ponder të rrezikshmërisë prej 10%.

91. Në pozicionet në derivativët financiarë me të cilat tregtohet përmes sportelit që janë të mbuluara me sigurim financiar, banka mund të aplikojë ponder të rrezikshmërisë prej 0%, nëse:

- vlera e tyre e tregut shprehet në bazë ditore;
- të mbuluara janë me depozitë në para, mjete monetare ose ekuivalentë monetar, dhe
- nuk ekziston mos harmonizim valutor ndërmjet pozicionit në derivativët financiarë dhe sigurimin financiarë.

Pozicioneve në derivativët financiarë me të cilat tregtohet përmes sportelit dhe që i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1, alinetë 1 dhe 3, dhe janë të mbuluara me instrumente borxhi të lëshuara nga qeveria qendrore ose bankë qendrore për të cilat aplikohet ponder i rrezikshmërisë prej 0%, banka mund të aplikojë ponderë të rrezikshmërisë prej 10%.

Banka mund të aplikojë ponderë të rrezikshmërisë prej 0% të pozicioneve nga paragrafi 2 të kësaj pike, vetëm nëse marrëdhënia ndërmjet pozicionit në derivativin financiar dhe vlerës së tregut të instrumentit të borxhit është së paku 1:1,20.

Për nevojat e paragrafëve 2 dhe 3 të kësaj pike, si qeveri qendrore ose bankë qendrore konsiderohen edhe bankat e zhvillimit shumëpalësh dhe organizatat ndërkombëtare për të cilat aplikohet ponderë i rrezikshmërisë prej 0%.

VI.2.1.2 Netimi i bilancit

92. Banka mund të njohë netim bilancin e kërkesave të ndërsjella dhe detyrimet me debitorin si instrument të financuar për mbrojtjen e kredisë nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

- kreditë dhe depozitat netohen në bankë;
- marrëveshja e netimit të bilancit mund të zbatohet në të gjitha rastet pa kurrfarë kufizimesh, duke përfshirë edhe rastet e paaftësi paguese, falimentimi ose likuidimi i debitorit;
- banka mund në çdo moment t'i përcaktojë kërkesat dhe detyrimet monetare që janë subjekt i marrëveshjes për netim;
- banka kryen monitorim dhe kontrollim rregullisht për rreziqet që mund të rrjedhin nga ndërprerja e vlefshmërisë së kontratës për netimin e bilancit;
- për marrëveshjet e netimit të bilancit që përfshijnë aplikimin e rregulloreve nga një vend tjetër, banka është e detyruar të marrë mendim ligjor nga një avokat nga vendi, rregullat e të cilit zbatohen, me të cilën konfirmohet mundësia për ekzekutimin e marrëveshjes në pajtim me rregulloret e vendit tjetër. Krahas kësaj, që të sigurohet banka se kontrata mund të ekzekutohet pa kurrfarë kufizimesh, ajo është e detyruar, së paku një herë në vit gjatë kohëzgjatjes së kontratës, të marrë mendim juridik shtesë nga një avokat nga vendi, rregulloret e të cilit zbatohen për mundësinë e ekzekutimit të tij, dhe
- banka monitoron dhe kontrollon rregullisht ekspozimin mbi një bazë neto.

93. Nëse marrëveshja e netimit të bilancit plotëson kushtet e këtij kreu të vendimit, banka mund gjatë përcaktimit të aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë, të përfshijë diferencën ndërmjet kredive dhe depozitave që janë subjekt i marrëveshjes (neto shuma). Vlera e ponderuar e kërkesës fitohet si produkt i shumës neto dhe ponderit të rrezikut që aplikohet për kredinë, gjegjësisht për debitorin. Shuma neto përfshihet në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë vetëm nëse diferenca ndërmjet kredive dhe depozitave është pozitive. Nëse diferenca është e barabartë me zero ose është negative, shuma neto nuk përfshihet në aktivin e ponderuar sipas rrezikut të kredisë.

Në rast të mos harmonizimit të valutës ndërmjet kredive dhe depozitave që janë subjekt i netimit, vlera e depozitës korrigjohet me aplikimin e formulës në vijim:

$$C^* = C \times (1 - 0,08), \text{ ku:}$$

C e paraqet vlerën e depozitit

C* e paraqet vlerën e korrigjuar të depozitit që merret parasysh gjatë përcaktimit të shumës neto.

VI.2.1.3 Instrumente të tjera të financuara

94. Si instrumente të tjera të financuara konsiderohen instrumentet në vijim, të cilat i plotësojnë kriteret e këtij kreu të vendimit:

- depozitat monetare ose ekuivalentët monetar teka një palë të tretë që nuk është një nga palët kontraktuese, ose
- policat e sigurimit të jetës.

95. Depozitat monetare ose ekuivalentët monetarë nga pika 94, alinea 1 të këtij vendimi duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- marrëveshja për pengun ose transferimin e depozitit monetar /ekuivalentin monetar të bankës është bërë në bazë të ligjit dhe banka ka të drejtë pa vonesë të arkëtojë ose të përvetësojë me depozitën monetare/ekuivalentin monetar në rast të mospagesës së kërkesës, paaftësia paguese ose hapja e procedurës së falimentimit ndaj debitorit ose ndaj personit me të cilin ndodhet depozitimi monetar/ekuivalenti monetar ose në rast të realizimit të ndonjë ngjarjeje tjetër kontraktuale;
- pala e tretë duhet të njoftohet për pengun ose të drejtën e transferimit;
- në bazë të njoftimit nga alinea 2 të kësaj pike, pala e tretë mund të kryejë pagesën e depozitës monetare/ekuivalentin monetar vetëm në bankë ose të personit tjetër, pas pëlqimit paraprak të bankës; dhe
- pengun ose transferimin është në dobi të bankës dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme.

96. Policat e sigurimit të jetës nga pika 94 alinea 2 e këtij vendimi duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- polica e sigurimit të jetës është dhënë si peng në bankë ose është vinkuluar në favor të bankës;
- kompania e sigurimit që ka lëshuar policën është njoftuar për pengun dhe nuk mund të kryejë pagesë në bazë të policës pa pëlqimin paraprak nga banka;
- në rast të mospagesës së kërkesës, banka ka të drejtë të anulojë policën e sigurimit të jetës dhe të paguajë vlerën e blerjes së policës, me ç'rast nuk ekzistojnë dispozita ligjore që e kufizojnë ngarkesën e vlerës së blerjes;
- banka duhet të njoftohet për çdo vonesë të debitorit në shlyerjen e detyrimeve të tij në bazë të policës për sigurim të jetës;
- me përjashtim të pikës 86, paragrafit 3, të këtij vendimi, nëse afati i maturimit të policës është më i shkurtër se afati i mbetur i maturimit të kërkesës, polica mund të përdoret si instrument për mbrojtjen e kredisë vetëm nëse banka ofron kushtet shumë të fituar me pagesën e policës të zëvendësojë me instrument tjetër për mbrojtjen e kredisë me afat maturimi deri në fund të afatit të maturimit të kërkesës, në pajtim me dispozitat e këtij vendimi;

- pengu ose vinkulimi duhet të kenë fuqinë e një dokumenti ekzekutiv, në pajtim me ligjin;
- vlerën e blerjes së policës e publiko kompania e sigurimit që e ka lëshuar këtë vlerë nuk mund të zvogëlohet;
- banka duhet të jetë në gjendje në kohën e duhur ta paguajë vlerën e blerjes së policës, gjegjësisht arkëtimi i policës të kryhet në afat të arsyeshëm;
- kompania e sigurimit nuk guxon të paguajë vlerën e blerjes së policës, pa pëlqimin paraprak të bankës; dhe
- kompania e sigurimit është kompani sigurimesh ose një degë e kompanisë së huaj sigurimi që ka marrë leje për të kryer punë sigurimi nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ose kompani sigurimi nga vendi anëtar i Bashkimit European ose është kompani me seli jashtë Republikës së Maqedonisë që është subjekt i rregullimit dhe mbikëqyrjes së sigurimit që së paku është e barabartë me rregullimin dhe mbikëqyrjen e vendeve anëtare të Bashkimit European.

97. Vlera e ponderuar e kërkesës e siguruar me depozitë monetare/ekuivalent monetar nga pika 95 e këtij vendimi, përcaktohet si produkt i shumës së depozitës monetare/ekuivalenti monetar dhe ponderit të rrezikut që do të aplikohet në rastin e ekspozimit direkt ndaj personit ku ndodhet ajo depozitë/ekuivalenti (ponderi i rrezikut të palës së tretë).

Në rast të mos harmonizimit të valutës së kërkesës dhe depozitës monetare/ekuivalenti monetar, vlera e depozitës monetare/ekuivalenti monetar korrigjohet me përdorimin e formulës në vijim:

$G^* = G \times (1 - 0,08)$, ku:

G e paraqet vlerën e depozitës monetare/ekuivalenti monetar që i plotëson kushtet e këtij vendimi;

G^* e paraqet shumën e korrigjuar të depozitës monetare/ekuivalenti monetar që merret parasysht gjatë përcaktimit të vlerës së ponderuar të kërkesës.

98. Vlera e ponderuar e kërkesës e siguruar me policën e sigurimit të jetës nga pika 96 e këtij vendimi përcaktohet si produkt i:

- vlera e blerjes së policës së sigurimit të jetës dhe
- ponderi i rrezikshmërisë që, në pajtim me këtë vendim, zbatohet për kompaninë e sigurimit që e ka lëshuar policën.

Nëse kompania e sigurimit nuk ka vlerësim afatgjatë të kredisë të përcaktuar nga IKR e njohur, vlera e ponderuar e kërkesës përcaktohet duke përdorur ponder të rrezikshmërisë prej 70%.

Në rast të mos harmonizimit të valutës së kërkesës dhe policës së sigurimit të jetës, banka është e detyruar të korrigjojë vlerën e blerjes së policës së sigurimit të jetës me aplikimin e formulës në vijim:

$$G^* = G \times (1 - 0,08), \text{ ku:}$$

G e paraqet shumën e vlerës së blerjes së policës së sigurimit të jetës;

G* e paraqet shumën e korrigjuar të vlerës së blerjes së policës së sigurimit të jetës që përfshihet në përcaktimin e vlerës së ponderuar të kërkesës.

99. Në rastet kur kërkesa nuk është e mbuluar plotësisht nga një instrument tjetër i financuar për mbrojtjen e kredisë, banka mund pjesën e siguruar të zbatojë procedurën e përcaktuar në këtë kapitull të Vendimit, nëse pjesa e siguruar dhe e pasiguruar e kërkesës kanë të njëjtin rend të arkëtimit nga klienti (banka dhe ofruesi i instrumentit ndajnë humbjet proporcionalisht).

Në rastet nga paragrafi 1 të kësaj pike, shuma totale e vlerës së ponderuar të kërkesës fitohet me zbatimin e formulës në vijim:

$$(E - G^*) \times r + G^* \times g$$

E e paraqet shumën e kërkesës së përcaktuar në pajtim me pikën 35 të këtij vendimi. Nëse bëhet fjalë për kërkesë jashtë bilancit, ajo kërkesë është përfshirë plotësisht në formulën për përcaktimin e shumës totale të ponderuar, gjegjësisht aplikohet faktor i konvertimit prej 100%;

G* e paraqet vlerën e instrumentit të financuar të mbetur për mbrojtjen e kredisë të përcaktuar në pajtim me këtë kreu të vendimit;

r shënon ponderin e rrezikshmërisë që, në pajtim me këtë vendim, zbatohet në kategorinë e ekspozimit të cilës i përket kërkesa e siguruar me instrument tjetër të financuar për mbrojtjen e kredisë;

g shënon ponderin e rrezikshmërisë që në pajtim me këtë vendim zbatohet tek personi i tretë/ ofruesi i instrumentit.

VI.2.2 Instrumentet e pafinancuara për mbrojtjen e kredisë

100. Si instrumente të pafinancuara për mbrojtjen e kredisë konsiderohen garancitë dhe kundërgarancitë.

Banka mund të njohë vetëm instrumentet e pafinancuara për mbrojtjen e kredisë që i plotësojnë kriteret nga pikat 101 dhe 102 të këtij vendimi.

101. Garancitë dhe kundërgarancitë duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- 1) të jetë qartë i përkufizuar fushëveprimi i instrumentit (ekziston lidhje e qartë ndërmjet instrumentit dhe kërkesës së bankës të cilës i referohet ai instrument);
- 2) garancioni dhe kundërgarancioni është lëshuar nga:
 - a) qeveria qendrore ose banka qendrore, përfshirë edhe institucionet publike që kanë trajtimin e qeverisë qendrore dhe personat nga pika 39 paragrafi 2 të këtij vendimi,
 - b) banka zhvillimi shumëpalëshe,
 - c) organizata ndërkombëtare,
 - ç) bankë,
 - d) kompani tjetër tregtare, duke përfshirë edhe personin amë, filialet ose personat, në të cilët banka realizon pjesëmarrjen, nëse kanë vlerësim krediti nga IKR e njohur për të cilën është përcaktuar se i përket shkallës së cilësisë kreditore e barabartë ose më e mire se 2;
- 3) marrëveshja e garancisë ose kundërgarancisë nuk përmban dispozita ekzekutimi i të cilave është jashtë nga kontrollit të bankës, dhe i cili:
 - emetuesit të garancisë/kundërgarancisë i japin të drejtën në mënyrë të njëanshme të shkëput marrëveshjen,
 - ofrojnë mundësi për rritjen e kostos për përdorimin e mbrojtjes së kredisë në rast të përkeqësimit të cilësisë kreditore të kërkesës ose debitorit,
 - e kufizojnë emetuesin e garancisë/kundërgarancisë të kryejë pagesë në kohë në rast se debitori nuk i shlyen detyrimet e tij në bazë të çfarëdo lloj kërkesë të maturimit,
 - i japin të drejtë lëshuesit të garancisë/kundërgarancisë të shkurtojë afatin e maturimit të instrumentit për mbrojtjen e kredisë; dhe
- 4) garancia ose kundërgarancia është lidhur në atë mënyrë që mundëson ekzekutimin e tyre në pajtim me rregulloret përkatëse.

Krahas kriterëve nga paragrafi 1 të kësaj pike, garancitë mund të përdoren si instrument i pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, nëse i plotësojnë edhe kriteret shtesë në vijim:

- garancia paraqet kërkesë të drejtpërdrejtë nga personi që e ka lëshuar,
- në rast të mosshlyerjes së detyrimeve nga debitori, banka ka të drejtë në periudhë të arsyeshme nga emetuesi i garancisë t’ia paguajë shumën e maturimit. Pagesën që duhet të kryejë lëshuesi i garancisë nuk guxon të jetë e kushtëzuar me detyrimin e bankës që më parë të kërkojë arkëtimin e kërkesës së maturimit nga debitori;
- nëse me garancinë ofrohen kredi për blerje të objekt banimit, plotësimi i kriterit nga paragrafi 1 nënpika 3) alinea 3 është i kufizuar në 36 muaj. Kjo do të thotë se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve nga debitori, banka mund të arkëtojë kërkesën e saj nëpërmjet bartjes dhe shitjes së objektit të banimit. Nëse ai nuk arrin ta shesë atë objekt banimi për një periudhë deri në 36 muaj, banka është e detyruar të aktivizon garancinë dhe të kërkon arkëtimin e kërkesës së maturimit nga emetuesi i garancisë;

- garancia bazohet në detyrim që ka marrë përsipër lëshuesi i garancisë në formë të shkruar ose në formë tjetër të përshtatshme që mund të shërbejë si dëshmi e lëshimit të garancisë; dhe
- garancia i mbulon të gjitha pagesat që rrjedhin nga kërkesat të cilave i referohet. Në të kundërt, shuma që përfshihet në përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut të kredisë duhet të reduktohet në mënyrë të përshtatshme për atë pjesë të kërkesës që nuk është e mbuluar me garancinë.

Përveç kritereve nga paragrafi 1 të kësaj pike, kundërgarancitë mund të përdoren si instrument i pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, nëse i plotësojnë edhe kriteret shtesë në vijim:

- kundërgarancia i mbulon të gjitha elementët e rrezikut të kredisë që rrjedh nga kërkesa të cilës i referohet;
- kundërgarancia dhe garancia të cilës i referohet kundërgarancia i plotësojnë kriteret e paragrafit 2 të kësaj pike, me atë dallim që kundërgarancia nuk duhet ta plotësojë kriterin e paragrafit 2 alinea 1;
- banka nuk posedon informacione nga të cilat mund të konkludojë se shumën që e mbulon kundërgarancia është më e vogël se shuma që e mbulon garancinë të cilës i referohet;
- banka mund t'i njohë si instrumente të pafinancuara për mbrojtjen e kredisë edhe kundërgarancitë e lëshuara nga persona të tjerë, përveç personave nga paragrafi 1 nënpika 2) të kësaj pike, nëse ato kundërgaranci janë të mbuluara me garancitë e personave nga paragrafi 1 nënpika 2) të kësaj pike dhe janë të plotësuara të gjitha kushtet e tjera të kësaj pike.

102. Krahas plotësimit të kushteve të pikës 101 të këtij vendimi, banka është e detyruar të përfshijë përdorimin e instrumenteve të pafinancuara për mbrojtjen e kredisë në procesin e menaxhimit të të gjitha rreziqeve dhe të vendos sistem të menaxhimit të rrezikut të përqendrimit që rrjedh nga përdorimi i këtyre instrumenteve.

Me përjashtim të pikës 85 të këtij vendimi, banka nuk mund të përdorë garancinë/kundërgarancinë në përcaktimin e vlerës së ponderuar të kërkesës, në rastet në vijim:

- afati i mbetur i maturimit të garancisë/kundërgarancisë është më i shkurtër se tre muaj dhe më i shkurtër se afati i maturimit të mbetur të kërkesës të cilës i referohet; ose
- afati i maturimit i dakorduar për garancinë/ kundërgarancinë është më i shkurtër se një vit dhe është më i shkurtër se afati i maturimit të mbetur të kërkesës të cilës i referohet.

103. Vlera e ponderuar e kërkesës së siguruar me instrument të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë përcaktohet si produkt i shumës së instrumentit (garanci/kundërgaranci) dhe ponderit të rrezikut që, në pajtim me këtë vendim, zbatohet ofruesi i instrumentit.

Në rast të mos harmonizimit të valutës ndërmjet kërkesës dhe instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, vlera e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë korrigjohet me zbatimin e formulës në vijim:

$$G^* = G \times (1 - 0,08), \text{ ku:}$$

G e përfaqëson vlerën e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë;

G* e përfaqëson shumën e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë që merret parasysht gjatë përcaktimit të vlerës së ponderuar të kërkesës.

Në rast të mos harmonizimit të maturitetit të instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë dhe kërkesa, e cila lejohet në pajtim me këtë kapitull, vlera e instrumentit korrigjohet në mënyrë shtesë me zbatimin e formulës në vijim:

$$G_a = G^* \times (t - t^*) / (T - t^*)$$

G_a përfaqëson vlerën e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë e cila merret parasysht gjatë përcaktimit të vlerës së ponderuar të kërkesës;

G* përfaqëson shumën e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë të korrigjuar për mos harmonizimin e valutës (nëse nuk ka mos harmonizim valutor G* = G);

t tregon shumën më të vogël të vlerës së parametrin T dhe numrin e viteve deri në datën e maturimit të instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, i përcaktuar në pajtim me pikën 85 të këtij vendimi;

T tregon numrin e viteve deri në datën e maturimit të kërkesës i përcaktuar në pajtim me pikën 85 të këtij vendimi, me ç'rast ky numër nuk mund të jetë më i madh se pesë vjet;

t* është e barabartë me 0,25.

104. Në rastet kur kërkesa nuk është e siguruar plotësisht me instrument të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, banka mund në pjesën e siguruar të zbatojë procedurën e përcaktuar në pikën 103 të këtij vendimi, nëse pjesa e siguruar dhe e pasiguar e kërkesës kanë renditje të barabartë të arkëtimit (banka dhe ofruesi i instrumentit ndajnë humbjet proporcionalisht).

Në rastet nga paragrafi 1 të kësaj pike, shuma totale e vlerës së ponderuar fitohet me zbatimin e formulës në vijim:

$$(E - G_a) \times r + G_a \times g$$

E e përfaqëson shumën totale të kërkesës të përcaktuar në pajtim me pikën 35 të këtij vendimi. Nëse bëhet fjalë për kërkesë jashtëbilancit, ajo

kërkesë plotësisht përfshihet në formulën për përcaktimin e shumës totale të ponderuar, gjegjësisht zbatohet faktori i konvertimit prej 100%;

Ga përfaqëson vlerën e instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë të përcaktuar në pajtim me pikën 103 të këtij vendimi. Nëse nuk ka mos harmonizim të maturimit ndërmjet kërkesës dhe instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, $G_a = G^*$. Nëse nuk ka mos harmonizim valutor ndërmjet kërkesës dhe instrumentit të pafinancuar për mbrojtjen e kredisë, $G^* = G$.

Dallimi ndërmjet E dhe Ga jep shumën e pjesës së pasiguruar të kërkesës;

r tregon ponderin e rrezikshmërisë i cili në pajtim me këtë vendim zbatohet në kategorinë e ekspozimit të cilës i përket kërkesa;

g tregon ponderin e rrezikshmërisë i cili në pajtim me këtë vendim i zbatohet ofruesit të instrumentit.

VII. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT VALUTOR

105. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor llogaritet në atë mënyrë, që përmbledhja e shumës absolute e pozicionit neto në ari dhe pozicioni agregat valutor i bankës shumëzohet me 8%.

106. Pozicioni neto i bankës në ar përfaqëson diferencën ndërmjet të gjitha pozicioneve aktive dhe pasive të bankës në ar, duke përfshirë të gjitha pozicionet jashtë bilancit të shprehura në ar (marrëveshjet forward dhe fjuçers në ar, opsionet në ar, etj.).

107. Pozicioni agregat valutor i bankës, i cili përcaktohet në pajtim me pikat 108 dhe 109 të këtij vendimi, përfshin pozicionet valutore aktive dhe pasive të bankës.

Pozicionet nën aktivet valutore, përkatësisht pozicionet pasive valutore konsiderohen edhe aktivet në denarë, gjegjësisht pozicionet pasive në denarë me klauzolë valutore.

108. Pozicioni valutor neto në një valutë paraqet shumë prej:

- pozicioni i spotit neto, i cili është i barabartë me diferencën ndërmjet aktivit valutor dhe pasivit valutor në atë valutë, duke përfshirë interesin e mosmaturimit;
- pozicioni forward neto i cili është i barabartë me diferencën ndërmjet të gjitha shumave që do të pranohen dhe të gjitha shumat që do të jenë të paguara në bazë të marrëveshjeve valutore forward, duke përfshirë edhe marrëveshjet valutore fjuçers dhe kryegjënë e marrëveshjeve valutore svop që nuk është e përfshirë në spot-pozicionin;
- pozicionet jashtë bilancit në valutë të huaj (garanci të parevokueshme, letra kreditore të pambuluara dhe instrumente të ngjashme), të cilat janë të klasifikuara në kategoritë e rrezikut "G" dhe "D". Në rastin e garancive dhe akreditiveve në valutë të huaj që janë të mbuluara me depozitë në atë valutë, në llogaritjen e pozicionit neto valutor përfshihet shuma e pambuluar e këtyre garancive dhe akreditiveve;

- vlera e opsioneve valutore të shprehur në pajtim me pikën 173 të këtij vendimi.

Pozitat nga paragrafi 1 alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike të cilat janë të klasifikuara në kategoritë e rrezikut "C", "Ç" dhe "D" paraqiten në bazë neto, gjegjësisht reduktohen për shumën përkatëse të korigjimit të vlerës/rezervës së veçantë. Pozicionet jashtë bilancit nga paragrafi 1 alinea 3 të kësaj pike paraqiten në bazë neto, gjegjësisht reduktohen me shumën përkatëse të rezervës së veçantë.

Në pozicionin valutor neto nuk përfshihen pozicionet e bankës në valutë të huaj që rrjedhin nga operacionet e saj në emër dhe llogari të të tjerëve, si dhe pozicionet e bilancit që, në pajtim me kreun III të këtij vendimi, përfaqësojnë zëra të zbritshëm nga kapitali bazë dhe shtesë.

Pozicioni valutor neto në një valutë shprehet në denarë duke aplikuar kursin e mesëm të Bankës Popullore i cili vlen në ditën kur është përcaktuar pozicioni valutor neto për atë valutë.

109. Shuma e të gjitha pozicioneve valutore të shkurtra neto në valuta të veçanta të shprehura në denarë e paraqet pozicionin total të shkurtër valutor të bankës, ndërsa shuma e të gjitha pozicioneve të gjata neto valutore në valuta të veçanta të shprehura në denarë e paraqet pozicionin total afatgjatë valutor të pozicionit të bankës.

Pozicioni i shkurtër valutor ekziston kur shuma e pozicioneve aktive është më e vogël se shuma e pozicioneve pasive.

Pozicioni i gjatë valutor ekziston kur shuma e pozicioneve aktive është më e madhe se shuma e pozicioneve pasive.

Shuma më e madhe e totalit të pozicionit të shkurtër valutor dhe e pozicionit total të gjatë valutor e përfaqëson pozicionin agregat valutor të bankës.

VIII. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIQEVE TË TREGUT

110 Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregu përmbledhje e:

- 1) kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të pozicionit, si përmbledhje e:
 - kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumente të borxhit, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII.3 të këtij vendimi, dhe
 - kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet personale, të përcaktuara në pajtim me kreun VIII.4 të këtij vendimi, dhe
- 2) kapitalit të nevojshëm për mbulimin e tejkallimit të kufijve të ekspozimit, ët përcaktuara në pajtim me kreun VIII.5 të këtij vendimi.

Në shumën e kapitalit nga paragrafi 1 të kësaj pike përfshihet edhe kapitali I përcaktuar në pajtim me kreun XI të këtij vendimi, në varësi të subjektit të opsionit.

111. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të pozicionit përcaktohet në bazë të dy komponentëve në vijim: rrezik specifik dhe i përgjithshëm.

Rreziku specifik është rreziku i ndryshimit të çmimit të instrumentit financiar si rezultat i faktorëve që janë të lidhura me emetuesin e atij instrumenti, gjegjësisht emetuesin e lëndës së derivatit, në derivatet financiare.

Rreziku i përgjithshëm është rreziku i instrumenteve financiare si rezultat i ndryshimeve të normave të interesit të tregut ose ndryshimet në çmimet e tregut të kapitalit.

112. Banka e përcakton pozicionin neto të një instrumenti financiar si diferencë midis pozicionit të tij të gjatë (blerje) dhe të shkurtër (shitje, huadhënie). Gjatë përcaktimit të pozicionit neto, derivatet trajtohen si pozicione të lëndës së derivatit.

Banka mund të kryejë netimin e paragrafit 1 të kësaj pike, nëse bëhet fjalë për:

- долгоpozicione të gjata dhe të shkurtra në instrument financiar të njëjtë të emetuar nga një person;
- pozicione të gjata dhe të shkurtra në instrumente financiare të ndryshme të emetuara nga një person, vetëm nëse instrumentet financiare janë me prioritet të barabartë të arkëtimit (ang. seniority) ose instrumentet financiare në të cilën banka ka pozicion të shkurtër janë me prioritet më të ulët të arkëtimit nga instrumentet në të cilën banka ka pozicion të gjatë.

VIII.1 Trajtimi i derivateve financiare dhe instrumentet tjera financiare

113. Gjatë përcaktimit të kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, pozicionet në derivate financiare dhe instrumentet tjera financiare paraqesin kombinim të pozicionit të gjatë dhe të shkurtër, të paraqitura në pajtim me dispozitat e këtij kreu. Në Aneks nr.1 që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, është dhënë pasqyrë e trajtimit të derivateve financiare gjatë përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumente pronësore dhe të borxhit.

114. Derivatet financiare me të cilat ndërmerren detyrimet për blerje ose shitje të instrumentit të caktuar të borxhit ose norma e interesit (forvard-marrëveshje, fjuçers-marrëveshje) paraqiten si kombinim i pozicionit të gjatë dhe të shkurtër, ku:

- njëri pozicion i afatit të maturimit të fjuçers-marrëveshjes, gjegjësisht të dates së shlyerjes të forvard-marrëveshjes ose marrëveshje e ngjashme;
- pozicioni tjetër mbërrin në afatin e maturimit të subjektit të derivatit.

Gjatë përcaktimit të kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut (rrezik specifik dhe i përgjithshëm) nga investimet në instrumentet e borxhit, përfshihen pozicionet nga paragrafi 1 i kësaj pike, të shprehura përmes vlerës së tregut ose momentale të lëndës së derivatit.

Në marrëveshjet-forward dhe fjuçers nga paragrafi 1 të kësaj pike, si pozicion i gjatë konsiderohet ai pozicion kur banka fiton paraprakisht normë të interesit të kontraktuar, ndërsa si pozicion i shkurtër konsiderohet ai pozicion kur banka paguan paraprakisht normë interesi të kontraktuar.

115. Blerja e marrëveshjes fjuçers ose forward ku lëndë është norma e interesit (ang. Interest rate, forward interest rate agreements) paraqiten si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit, gjegjësisht të datës së shlyerjes së forwardit dhe pozicionit të gjatë në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të lëndës së derivatit.

Shitja e marrëveshjes fjuçers ose forward ku lëndë është norma e interesit paraqitet si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit, gjegjësisht të datës së shlyerjes së forwardit dhe pozicionit të gjatë në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të lëndës së derivatit.

Në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut specifik nga investimet në instrumentet e borxhit, pozicionet nga paragrafët 1 dhe 2 të kësaj pike përfshihen në kategorinë e pozicioneve të cilat nuk marrin rrezik (ponder 0%).

Marrëveshjet-forward ku lëndë është kursi valutor (ang. Foreign Exchange forward - FX forwards) paraqiten si pozicion i gjatë në instrumentet e borxhit në valutën që blehet dhe pozicioni i shkurtër në instrumente të borxhit në valutën që shitet, ku mirret parasysh afati kur është parashikuar blerja, gjegjësisht shitja e valutës. Pozicionet e gjata dhe të shkurtra në marrëveshjet-forward ku lëndë është kursi valutor përfshihen gjatë përcaktimit të kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit, gjegjësisht, pavarësisht që përfshihen në përcaktimin e kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor, këto marrëveshje-forward përfshihen edhe në përcaktimin e kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit.

116. Blerja e marrëveshjes fjuçers ose forward ku lëndë është instrumenti i borxhit (ang. forward contract, bond future) paraqitet si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit, gjegjësisht të datës së shlyerjes së forwardit dhe pozicionit të gjatë në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të instrumentit të borxhit.

Shitja e marrëveshjes fjuçers ose forward ku lëndë është instrumenti i borxhit paraqitet si kombinim i pozicionit të gjatë në instrument borxhi që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit,

gjegjësisht të datës së shlyerjes së forvardit dhe pozicionit të shkurtër në instrumente të borxhit që mbërrin në afatin e maturimit të instrumentit të borxhit.

Në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut specifik nga investimet në instrumentet e borxhit, pozicioni i shkurtër nga paragrafi 1 të kësaj pike dhe pozicioni gjatë nga paragrafi 2 të kësaj pike përfshihen në kategorinë e pozicioneve të cilat nuk marrin rrezik (ponder 0%).

117. Blerja e marrëveshjes fjuçers ose forvard ku lëndë është letra me vlerë e pronësisë ose portfolio të instrumente pronësore (ang. equities forward contracts, equity futures) paraqiten si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrument të borxhit që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit, gjegjësisht të datës së shlyerjes së forvardit dhe pozicionit të gjatë në letra me vlerë të pronësisë (ose portfolio të instrumenteve pronësore). Pozicioni i shkurtër përfshihet në përcaktimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit, ndërsa pozicioni i gjatë përfshihet në përcaktimin e rrezikut (rrezik specifik dhe i përgjithshëm) nga investimet në instrumentet e borxhit.

Shitja e marrëveshjes fjuçers ose forvard ku lëndë është letra me vlerë e pronësisë (ose portfolio të instrumenteve pronësore) paraqitet si kombinim i pozicionit të gjatë në instrument të borxhit që mbërrin në afatin e maturimit të fjuçersit, gjegjësisht të datës së shlyerjes së forvardit dhe pozicionit të shkurtër në letra me vlerë të pronësisë (ose portfolio të instrumenteve pronësore). Pozicioni i gjatë përfshihet në përcaktimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit, ndërsa pozicioni i shkurtër përfshihet në përcaktimin e rrezikut (rrezik specifik dhe i përgjithshëm) nga investimet në instrumentet e borxhit.

Marrëveshjet forvard dhe fjuçers të treguesve të bursës paraqiten në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të kësaj pike, ku pozicionet në treguesin e bursës mund të paraqiten si një pozicion në treguesin e bursës ose si pozicione në secilin prej instrumenteve pronësore që janë pjesë nga treguesi i bursës - komponentë të treguesit të bursës. Varësisht nga mënyra e shfaqjes, pozicionet në treguesin e bursës shprehen përmes vlerës së tregut të treguesit të bursës ose përmes vlerës së tregut ose momentale të komponentëve të caktuara të treguesit të bursës.

118. Swapet e normës së interesit (ang. interest rate swap) në të cilat banka merr normë të ndryshueshme të interesit dhe paguan norma fikse të interesit paraqiten si kombinim i pozicionit të gjatë në instrumentet e borxhit me normë interesi të ndryshueshme që mbërrin në datën kur ndodh ndryshimi i ardhshëm i normës së interesit dhe pozicioni i shkurtër në instrumentet e borxhit që mbërrin në afatin e maturimit të swapit.

Swapet e normave të interesit në të cilat banka merr normë fike të interesit dhe paguan norma të interesit paraqiten si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrumentet me normë interesi të ndryshueshme që mbërrin në datën kur ndodh ndryshimi i ardhshëm i normës së interesit dhe pozicioni i gjatë në instrumentet e borxhit që mbërrin në afatin e maturimit të swapit.

Në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut specifik nga investimet në instrumentet e borxhit, pozicionet nga paragrafët 1 dhe 2 të kësaj pike përfshihen në kategorinë e pozicioneve të cilat nuk marrin rrezik (ponderë 0%).

Swapet e valutave (ang. Cross-currency swap) paraqiten me paragrafët 1,2, dhe 3 të kësaj pike, si kombinim i pozicionit të gjatë në instrument të borxhit në njërën valutë me normë të interesit fikse/të ndryshueshme dhe pozicionit të shkurtër në instrumentet e borxhit në valutën tjetër me normë të interesit fikse/të ndryshueshme, ku merret parasysh në secilën prej valutave që shkëmbehen. Pozicionet në këtë lloj të swapeve përfshihen edhe gjatë përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor si pozicione në valutat që shkëmbehen në pajtim me afatin e tyre.

119. Swapet e instrumente pronësore (ang. Equity swap) paraqiten si kombinim i pozicionit të gjatë në letra me vlerë pronësore që e pranon edhe pozicioni i shkurtër në letra me vlerë pronësore duke i dhënë.

Swapet e instrumenteve pronësore në të cilat banka pranon normë interesi të ndryshueshme paraqiten si kombinim i pozicionit të gjatë në instrumente të borxhit normë interesi fikse ose të ndryshueshme që mbërrin në afatin e maturimit të swapit, gjegjësisht të datës kur ndodh ndryshimi i ardhshëm i normës së interesit dhe pozicionit të shkurtër në letra me vlerë pronësore. Pozicioni i gjatë përfshihet në përcaktimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit, ndërsa pozicioni i shkurtër përfshihet në përcaktimin e rrezikut (rrezik specifik dhe i përgjithshëm) nga investimet në instrumentet e borxhit.

Swapet e instrumenteve pronësore në të cilat banka paguan normë interesi fikse ose të ndryshueshme paraqiten si kombinim i pozicionit të shkurtër në instrumente të borxhit me normë interesi fikse ose të ndryshueshme që mbërrin në afatin e maturimit të swapit, gjegjësisht të datës kur ndodh ndryshimi i ardhshëm i normës së interesit dhe pozicionit të gjatë në letra me vlerë pronësore. Pozicioni i shkurtër përfshihet në përcaktimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit, ndërsa pozicioni i gjatë përfshihet në përcaktimin e rrezikut (rrezik specifik dhe i përgjithshëm) nga investimet në instrumentet pronësore.

120. Investimet në pjesë në fondet investuese (ang. Collective investment undertakings) përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë dhe rrezikut valutor (nëse bëhet fjalë për investimet në valutë të huaj), ndërsa nuk përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezeqeve të tregut.

121. Pozicionet në letrat me vlerë konvertibile (ang. Convertible securities) paraqiten si pozicione në instrumente të borxhit ose instrumente pronësore. Letrat me vlerë konvertibile konsiderohet si letër me vlerë pronësore nëse:

- deri në datën e parë kur mund të kryhet konvertimi mbasin më pak se tre muaj, gjegjësisht periudha deri në datën tjetër kur mund të kryhet konvertimi është më i vogël se një vit (nëse data e parë tashmë ka kaluar);
- lartësia e vlerës rrjedhëse të tregut të instrumentit të borxhit është më e madhe se 10% e vlerës së sasisë përkatëse të letrave me vlerë pronësore që mund të merr nëse kryhet konvertimi.

122. Pozicionet në letra me vlerë (instrumente pronësore, instrumentet e borxhit) nga portfolio për tregtim që përkohësisht shiten në palë tjetër kontraktuese në bazë të marrëveshjes-repo ose që në bazë të marrëveshjes përkatëse jepen kredi të palës tjetër kontraktuese paraqiten si kombinim i pozicionit të gjatë në letrën me vlerë që është përkohësisht e shitur, gjegjësisht e dhënë për kredi dhe pozicioni i shkurtër në instrument borxhi pa rrezik me afat përkatës dhe interes që është e barabartë me normën e kthimit të këtyre marrëveshjeve.

Pozicioni në letrën me vlerë që shitet, gjegjësisht jepet kredi dhe pozicioni në instrumentet e borxhit pa rrezik përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit dhe/ose instrumente pronësore, të shprehura përmes vlerës së tregut të lëndës së marrëveshjes. Në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut specifik, pozicionet në instrumentet e borxhit pa rrezik përfshihen në kategorinë e pozicioneve të cilat nuk marrin rrezik (ponder 0%).

Pozicionet në letra me vlerë nga portfolio për tregtim që përkohësisht blehen në palë tjetër kontraktuese në bazë të marrëveshjes-repo ose që në bazë të marrëveshjes përkatëse huazohen nga pala tjetër kontraktuese paraqiten si pozicion i gjatë në instrumentin e borxhit pa rrezik me afat përkatës dhe interes që është e barabartë me normën e kthimit të këtyre marrëveshjeve.

Pozicioni nga paragrafi 3 të kësaj pike përfshihet në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit.

123. Pozicionet në opsione dhe instrumente që kanë karakteristika të opsioneve (англ. interest rate options, debt instrument options, equity options, stock indices option, financial future options, swaoptions, foreign currency options, warrants) paraqiten në pajtim me kreun XI të këtij vendimi dhe në mënyrë përkatëse përfshihen në kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, rrezikun nga ndryshimi i çmimeve të mallrave ose rreziku i valutës.

VIII.2 Garantimi dhe/ose vendosja e emetimit të letrave me vlerë

124. Pozicionet që dalin nga detyrimi i bankës për garantimin dhe/ose vendosjen e emetimit të letrave me vlerë përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumente pronësore ose të investimeve në instrumente borxhi, në pajtim me krerët VIII.3 dhe VIII.4 të këtij vendimi.

Përfshirja e pozicioneve nga paragrafi 1 i kësaj pike bëhet në mënyrën në vijim:

- përcaktohet pozicioni neto i bankës në letrat me vlerë, emetimin e të cilave e garanton, gjegjësisht për të cilat pa kushte është detyruar se do t'i pranojë me çmimin e dakorduar. Pozicioni neto paraqet diferencën midis shumës së emetimit të letrave me vlerë që e garanton banka dhe shumën e letrave me vlerë që janë regjistruar ose janë transferuar te palët e treta që kanë marrë detyrim për subgarantimin e emetimit;
- pozicioni neto ulet me faktorët e reduktimit nga Tabela nr. 10.

Tabela nr. 10

	Faktori i reduktimit
Ditë pune 0	100%
Ditë pune 1	90%
Ditë pune 2-3	75%
Ditë pune 4	50%
Ditë pune 5	25%
Mbi 5 ditë pune	0%

Me ditë pune 0 nënkuptohet ditë pune në të cilën banka fiton detyrim të pakushtëzuar për të marrë shumën e përcaktuar të letrave me vlerë me çmim të dakorduar paraprakisht.

VIII.3 Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit

125. Banka është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit të cilat udhëheqen në portfoli për tregtim.

Në llogaritjen nga paragrafi 1 të kësaj pike, banka është e detyruar t'i përfshijë pozicionet në bazë të garancisë dhe/ose vendosjes së emetimit të instrumenteve të borxhit, si dhe të gjitha pozicioneve tjera, vlera e të cilave varet nga lëvizja e normave të interesit (p.sh. marrëveshja-forward ku lëndë është kursi valutor).

Banka është e detyruar t'i përcaktojë pozicionet e secilit instrument të borxhit nga paragrafi 1 të kësaj pike në pajtim me pikën 112 dhe kreu VIII.1, të këtij vendimi, dhe të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet e borxhit për secilën valutë veçmas.

VIII.3.1 Rreziku specifik

126. Banka kryen klasifikimin e pozicioneve në pajtim me afatin e tyre të mbetur dhe karakteristikat e emetuesit.

Me afatën e mbetur të instrumenteve të borxhit, në kuptim të këtij vendimi, ce nënkuptohet periudha e mbetur deri në afatin faktik të tyre (për instrumentet me norma

fikse të interesit), gjegjësisht deri në periudhën në të cilën kryhet përsëri përcaktimi i normave të interesit (për instrumentet me normat e interesit të ndryshueshme).

127. Në bazë të klasifikimit të kryer sipas afatit të mbetur, banka kryen ponderim të pozicioneve në pajtim me ponderët nga tabela nr. 11.

Tabela nr. 11

Pozicione që nuk marrin rrezik	Pozicione të kualifikuara			Pozicione të tjera
	deri më 6 muaj	Nga 6 deri më 24 muaj	Mbi 24 muaj	
0,00%	0,25%	1,00%	1,60%	8,00%

Si pozicione që nuk marrin rrezik konsiderohen pozicionet që janë të emetuara nga persona ose janë të siguruara me instrumentet e mbrojtjes së kredisë që, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi, u ndahet ponder i rrezikut në rrezik kreditor prej 0%.

Pozicione të kualifikuara janë pozicionet që:

- janë të emetuara ose të garantuara nga Qeveritë Qendrore të cilat, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi, u ndahet ponder i rrezikut prej 20% ose 50%;
- janë të emetuara nga bankat qendrore, organizatat ndërkombëtare, bankat e zhvillimit shumëpalëshe dhe organet e vetëqeverisjes lokale dhe të qeverisjes rajonale, të cilat, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi, janë të shpërndara në shkallë të cilësisë kreditore prej 2 ose 3;
- janë të emetuara ose të garantuara nga bankat dhe shoqëri tjera tregtare, në pajtim me kreun VI të këtij vendimi, janë të shpërndara në shkallë të cilësisë kreditore prej 1 ose 2.

Të gjitha pozicionet nuk përfshihen në pozicionet nga paragrafët 2 dhe 3 të kësaj pike konsiderohen për pozicione të tjera.

128. Kapitali për mbulimin e rrezikut specifik paraqet përmbledhje të vlerave absolute të pozicioneve të ponderuara të fituara.

VIII.3.2 Rreziku i përgjithshëm

129. Banka e llogarit shumën e rrezikut të përgjithshëm në bazë të maturimit të mbetur të pozicioneve në instrumentet e borxhit dhe norma e tyre e interesit. Me aplikimin e ponderëve prej Tabela nr.12 fitohen pozicionet të ponderuara të gjata dhe të shkurtra në secilin instrument të borxhit.

Tabela nr. 12

Zonë	Grupe dhe maturimi i mbetur		Ponder (në %)
	Norma e interesit prej 3% dhe më	Norma e interesit deri 3%	
Zonë 1	0 - 1 muaj	0 - 1 muaj	0.00
	1 - 3 muaj	1 - 3 muaj	0.20

	3 - 6 muaj 6 - 12 muaj	3 - 6 muaj 6 - 12 muaj	0.40 0.70
Zonë 2	1 - 2 vjet 2 - 3 vjet 3 - 4 vjet	1.0 - 1.9 vjet 1.9 - 2.8 vjet 2.8 - 3.6 vjet	1.25 1.75 2.25
Zonë 3	4 - 5 vjet 5 - 7 vjet 7 - 10 vjet 10 - 15 vjet 15 - 20 vjet mbi 20 vjet	3.6 - 4.3 vjet 4.3 - 5.7 vjet 5.7 - 7.3 vjet 7.3 - 9.3 vjet 9.3 - 10.6 vjet 10.6 - 12 vjet 12 - 20 vjet mbi 20 vjet	2.75 3.25 3.75 4.50 5.25 6.00 8.00 12.50

130. Përpara se të bëhet shfaqja e pozicioneve në derivate financiare, në pajtim me kreun VIII.1 të këtij vendimi, banka mund të bëjë netimin e pozicionit të gjatë dhe të shkurtër në të njëjtin derivat financiar, nëse plotësohen kushtet në vijim:

a) Pozicionet janë me vlerë të njëjtë nominale dhe janë të paraqitura në valutë të njëjtë;

b) Kanë të njëjtën normë referuese të interesit (për pozicionet me norma të ndryshueshme të interesit) ose të njëjtin interes të kuponit (për pozicionet me normë fikse të interesit), ose norma nuk dallohet ndjeshëm (jo më shumë se 15 pikë bazë = 0,15 pikë përqindje);

c) Afatet e maturimit të pozicioneve me norma fikse të interesit, gjegjësisht afatet e ardhshme mbi të cilat bëhet ripërcaktimi i normave të interesit (për pozicionet me norma të ndryshueshme të interesit) i plotësojnë kufizimet në vijim:

- bien në të njëjtën ditë, për pozicionet të cilat këto afate janë më të shkurtra se një muaj;
- nuk dallohen më shumë se shtatë ditë, për pozicionet tek të cilat këto afate shënojnë ndërmjet një muaji dhe një viti;
- nuk dallohen më shumë se shtatë ditë, për pozicionet tek të cilat këto afate shënojnë ndërmjet një muaji dhe një viti.

131. Përmbledhja e të gjitha pozicioneve të ponderuara të gjata në grup të veçantë të maturitetit të mbetur jep pozicionin afatgjatë të ponderuar për atë grup maturimi të mbetur. Përmbledhja e të gjitha pozicioneve të ponderuara të shkurtra në grup të veçantë të maturitetit të mbetur jep pozicionin e shkurtër për atë grup maturimi të mbetur. Shuma më e vogël e këtyre dy përmbledhjeve në secilën grup të maturimit të mbetur konsiderohet për pozicion të ponderuar të harmonizuar të asaj grupe të maturimit të mbetur.

Shuma e mbetur (dallimi që mund të jetë me shenjë pozitive ose negative) konsiderohet për pajtueshmëri të pozicionit të ponderuar të gjatë ose pozicionit për pajtueshmëri të ponderuar të shkurtër në secilën zonë (pika 132 e këtij vendimi).

132. Përmbledhja e pozicioneve të gjata të paharmonizuara të ponderuara të grupeve të maturimit të mbetur që i takojnë një zone konsiderohet e paharmonizuar e pozicionit të ponderuar të gjatë të asaj zone. Përmbledhja e pozicioneve të shkurtra të paharmonizuara të ponderuara të grupeve të maturimit të mbetur që i takojnë një zone konsiderohet e paharmonizuar të ponderuar të pozicionit të shkurtër të asaj zone. Shuma më e vogël e këtyre përmbledhjeve konsiderohet e harmonizuar e pozicionit të ponderuar të zonës.

Shuma e mbetur (dallimi që mund të jetë me shenjë pozitive ose negative) paraqet pozicion të ponderuar të paharmonizuar të gjatë ose pozicion të paharmonizuar të shkurtër të asaj zone dhe merret parasysh gjatë përcaktimit të harmonizimit horizontal ndërmjet zonave nga pika 133 të këtij vendimi.

133. Shuma më e vogël e pozicionit të paharmonizuar të ponderuar të gjatë dhe të shkurtër në zonën 1 dhe pozicionit të paharmonizuar të shkurtër dhe të gjatë konsiderohet për pozicion të ponderuar të harmonizuar ndërmjet zonave 1 dhe 2.

Nëse shuma e pozicionit të paharmonizuar të ponderuar të gjatë dhe të shkurtër të zonës 2 është më e madhe se shuma e pozicionit të paharmonizuar të shkurtër dhe të gjatë të zonës 1, shuma e mbetur nga zona 2 krahasohet me pozicionin e paharmonizuar të ponderuar të gjatë dhe të shkurtër të zonës 3. Shuma më e vogël e këtyre dy shumave konsiderohet e harmonizuar të pozicionit të ponderuar ndërmjet zonave 2 dhe 3.

Nëse shuma e pozicionit të paharmonizuar të ponderuar të gjatë dhe të shkurtër të zonës 1 është më e madhe se shuma e pozicionit të paharmonizuar të shkurtër dhe të gjatë të zonës 2, shuma e mbetur nga zona 1 krahasohet me pozicionin e paharmonizuar të ponderuar të gjatë dhe të shkurtër të zonës 3. Shuma më e vogël e këtyre dy shumave konsiderohet e harmonizuar të pozicionit të ponderuar ndërmjet zonave 1 dhe 3.

Harmonizimi horizontal ndërmjet zonave nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të kësaj pike bëhet vetëm nëse pozicionet e paharmonizuara të ponderuara të zonave që krahasohen janë me shenjë të ndryshme (krahasohet pozicioni i gjatë i paharmonizuar i ponderuar nga një zonë me pozicion të shkurtër të paharmonizuar të ponderuar nga zona tjetër). Nëse pozicionet e paharmonizuara të ponderuara të zonave që krahasohen janë me shenjë të njëjtë (p.sh. të dy zonat që krahasohen kanë pozicion të paharmonizuar të gjatë), përmbledhja e tyre është pjesë nga pozicioni i mbetur nga paragrafi 5 të kësaj pike.

Shuma e mbetur e pozicionit të paharmonizuar ndërmjet zonave 1,2 dhe 3 konsiderohet pozicion i mbetur.

134. Shuma e kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm nga investimet në instrumentet e borxhit paraqet përmbledhje të:

- 10% e shumës të pozicionit të ponderuar të harmonizuar të secilës grup të maturimit të mbetur;
- 40% e shumës të pozicionit të harmonizuar të zonës 1;
- 30% e shumës të pozicionit të harmonizuar të zonës 2;
- 30% e shumës të pozicionit të harmonizuar të zonës 3;
- 40% e shumës të pozicionit të harmonizuar ndërmjet zonave 1 dhe 2;
- 40% e shumës të pozicionit të harmonizuar ndërmjet zonave 2 dhe 3;

- 150% e shumës të pozicionit të harmonizuar ndërmjet zonave 1 dhe 3;
- 100% e shumës të pozicionit të mbetur.

VIII.4 Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumentet pronësore

135. Banka është e detyruar të përcaktojë pozicionin e gjatë ose të shkurtër të çdo letre me vlerë pronësore për çdo treg kombëtar në të cilin tregton banka me atë letër me vlerë (ang. market-by-market basis) dhe të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut të investimeve në instrumentet pronësore, si shumë e kapitalit të nevojshëm për të mbuluar këtë rrezik për çdo treg kombëtar.

Si pozicione në instrumente pronësore që janë pjesë e portfolios për tregtim konsiderohen edhe pozicionet në bazë të garantimit dhe/ose vendosjes së emetimit të instrumente pronësore.

136. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga investimet në instrumente pronësore të çdo tregu kombëtar llogaritet si përmbledhje e:

- shumës së rrezikut specifik të përcaktuar me pikat a137 të këtij vendimi shumëzuar me 4%;
- shumës së rrezikut të përgjithshëm të përcaktuar me pikën 138 të këtij vendimi shumëzuar me 8%.

137. Rreziku specifik definohet si pozicion-bruto i instrumente pronësore, gjegjësisht përmbledhje e vlerës absolute e të gjitha pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në instrumente pronësore të veçanta.

138. Rreziku i përgjithshëm e paraqet pozicionin neto të instrumente pronësore, gjegjësisht dallimin ndërmjet përmbledhjes së pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në instrumente pronësore të veçanta.

VIII.5 Kapitali i nevojshëm për mbulimin e tejkalimit të kufijve të ekspozimit

139. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e tejkalimit të kufijve të ekspozimit fitohet me përfshirjen e këtyre pozicioneve në instrumentet e borxhit dhe instrumentet pronësore që kanë rrezik specifik më të lartë, në pajtim me kriteret VIII.3 VIII.3 dhe VIII.4 të këtij vendimi, të transaksioneve me instrumentet e borxhit, instrumente pronësore, valuta dhe mallra për të cilat përcaktohet kapitali për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-a të këtij vendimi dhe të instrumenteve financiare për të cilat përcaktohet kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut e palës tjetër kontraktuese, të përcaktuar në pajtim me kreun VIII-6 të këtij vendimi.

140. Për çdo tejkalim të kufijve të ekspozimit të përcaktuara me Ligjin për bankat (3%, 10%, 25%, 65%, 800%), e cila ka ndodhur si rezultat i ekspozimit të pikës 139 të këtij vendimi, banka është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e tejkalimit të kufijve të ekspozimit.

Ekspozimi i bankës ndaj personit dhe personave lidhur me të, që rezulton nga pozicionet në portfolio të aktiviteteve bankare, nuk mund t'i tejkalon kufijt e ekspozimit të përcaktuara me Ligjin për bankat.

141. Nëse tejkalimi i kufijve të ekspozimit zgjat më pak se 10 ditë, kapitali është i nevojshëm për mbulimin e këtij tejkalimi fitohet kur shuma e tejkalimit do të shumëzohet me 200%.

Nëse tejkalimi i kufijve të ekspozimit zgjat 10 ditë e më shumë, banka është e detyruar ta shpërndajë shumën e tejkalimit në kolonën 1 të Tabelës nr. 13. në pajtim me pjesëmarrjen e tij në përqindje në mjeteve vetanake. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e tejkalimit fitohet kur shuma e tejkalimit do të shumëzohet me ponderin përkatës të Tabelës nr. 13.

Tabela nr. 13

Tejkalimi i kufijve (si përqindje nga mjetet vetanake)	Ponder
Deri 40%	200%
40 - 60%	300%
60 - 80%	400%
80 - 100%	500%
100 - 250%	600%
Mbi 250%	900%

VIII-a. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT TË SHLYERJES/DORËZIMIT

142. Banka është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga shlyerja/dorëzimi për transaksionet me instrumentet e borxhit, instrumente pronësore, valuta dhe mallra, dhe atë:

- për të gjitha transaksionet që nuk janë të shlyera në afat prej pesë apo më shumë ditë pune pas datës së dakorduar të shlyerjes, në pajtim me pikën 143 të këtij vendimi, dhe
- për të gjitha transaksionet tek të cilat është parashikuar dorëzim i lirë me pikën 144 të këtij vendimi.

Banka nuk është e detyruar të përcaktojë kapitalin për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit në bazë të marrëveshjeve-repo dhe marrëveshjet për marrjen, gjegjësisht huadhënien e letrave me vlerë dhe të mallrave të palës tjetër kontraktuese.

143. Në rastet kur transaksioni i caktuar nuk është shlyer në afat prej pesë apo më shumë ditë pune pas datës së dakorduar të shlyerjes, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit llogaritet si produkt i dallimit ndërmjet çmimit të dakorduar të shlyerjes për atë pozicion dhe vlerës së saj aktuale të tregut dhe ponderi përkatës nga kolonën 2 të Tabelës nr. 14.

Tabela nr. 14

Numri i ditëve të punës pas datës së dorëzimit	% të dallimit në çmime
5 - 15	8%
16 - 30	50%
31 - 45	75%
46 dhe më shumë	100%

Kapitali nga paragrafi 1 të kësaj pike përcaktohet vetëm nëse dallimi ndërmjet çmimeve të instrumentit konkret do të thotë humbje për bankën (në rast të blerjes, kur çmimi aktual i tregut është më i lartë se çmimi i dakorduar, ose në rast të shitjes, kur çmimi aktual i tregut është më i ulët se çmimi i dakorduar i shlyerjes).

144. Për pozicionet tek të cilat është parashikuar dorëzimi i lirë, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit përcaktohet në rastet në vijim:

- nëse është kryer pagesë për instrumentet e borxhit, instrumentet pronësore, valutat dhe mallrat, para dorëzimit të tyre, ose dorëzimi është kryer para se të bëhet pagesa;
- tek transaksionet me vendet e huaja, nëse ka kaluar një ose më shumë ditë nga momenti kur është kryer pagesa ose dorëzimi nga alinea 1 të këtij paragrafi.

Në rastet e paragrafit 1 të kësaj pike, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të shlyerjes/dorëzimit përcaktohet në pajtim me Tabelën nr.15.

Tabela nr. 15

Numri i ditëve të punës pas datës së pagesës ose dorëzimit	Shuma e kapitalit të nevojshëm
Deri një ditë pune	0
Prej një deri katër ditë pune	Shuma e dakorduar e pagesës/dorëzimit të kryer ponderohet në pajtim me kreun VI të këtij vendimi (rrezik kreditor)
Pas ditës së pestë të punës	Shuma e dakorduar e pagesës/dorëzimit të kryer, rritur për ekspozimin aktual pozitiv (nëse ekziston) fiton trajtim të zërit të zbritshëm nga mjetet vetanake

Ekspozimi aktual pozitiv është i barabartë me dallimin pozitiv ndërmjet vlerës objektive të pagesës/dorëzimit të kryer dhe vlerës objektive të pagesës/dorëzimit të pakryer, në ditën e përcaktimit të kapitalit nga paragrafi 1 të kësaj pike.

VIII-6. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT NGA PALA TJETËR KONTRAKTUESE

145. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga pala tjetër kontraktuese llogaritet për instrumentet financiare në vijim:

- derivate financiare;
- Repo-marrëveshjet për shitje/blerje të letrave me vlerë dhe mallrave dhe marrëveshjet për kredi/huadhënie të letrave me vlerë dhe mallarve;
- transaksionet për kreditim të blerjes së letrave me vlerë me pagesë të caktuar të shumës (ang. Margin lending transactions);
- transaksionet afatgjata të shlyerjes.

146. Për nevojat e përcaktimit të kapitalit për mbulimin e rrezikut nga pala tjetër kontraktuese, banka është e detyruar të përcaktojë shumën e ekspozimit të ponderuar të rrezikut të palës tjetër kontraktuese si produkt i:

- ekspozimi i rrezikut prej palës tjetër kontraktuese për të gjitha pozicionet nga pika 145 paragrafi 1 të këtij vendimi, e përcaktuar në pajtim me pikën 147 dhe pikën 149 ose 150 të këtij vendimi dhe
- ponderi i rrezikut për palën kontraktuese, i përcaktuar në pajtim me kreun VI të këtij vendimi.

147. Banka e përcakton ekspozimin ndaj rrezikut të palës tjetër kontraktuese për secilin pozicion nga pika 145 paragrafi 1 të këtij vendimi me zbatimin e metodës së ekspozimit origjinal ose metodën e vlerës së tregut, në pajtim me pikat 149 dhe 150 të këtij vendimi. Banka është e detyruar të zbatojë të njëjtën metodë për të gjitha pozicionet që i përkasin të njëjtit grup nga pika 145 paragrafi 1 të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, vetëm banka që përdor metodën origjinale të ekspozimit për përcaktimin e ekspozimit ndaj rrezikut të palës tjetër kontraktuese për grup të caktuar pozicionesh, mund të kalojë në përdorimin e metodës së vlerës së tregut.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka është e detyruar të zbatojë metodën e vlerës së tregut për përcaktimin e ekspozimit të rrezikut nga pala tjetër kontraktuese për pozicionet nga pika 145 paragrafi 1 të këtij vendimi që i referohen instrumenteve pronësore, metale të çmuara ose mallra.

148. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të palës tjetër kontraktuese fitohet kur ekspozimi i ponderuar ndaj rrezikut të palës tjetër kontraktuese nga pika 147 të këtij vendimi do të shumëzohet me 8%.

149. Gjatë përdorimit të metodës së ekspozimit origjinal, ekspozimi i rrezikut nga pala tjetër kontraktuese nga pozicioni i veçantë (marrëveshje) paraqet produkt të vlerës nominale (ang. notional value) të pozicionit dhe përqindjes përkatëse nga Tabela nr.16:

Tabela nr. 16

Afati kontraktual i maturimit	Marrëveshje që i referohen normave të interesit	Marrëveshje që i referohen kursit valutor dhe arit
Deri më 1 vit	0,5%	2%
1-2 vjet	1,0%	5%
Për secilin vit shtesë	+ 1,0%	+ 3%

150. Në pajtim me metodën e vlerës së tregut, ekspozimi i rrezikut nga pala tjetër kontraktuese nga pozicioni i veçantë (marrëveshje) paraqet përmbledhje të:

- **ekspozimi aktual** i përcaktuar si kosto për zëvendësim të pozicionit. Kostoja për zëvendësim e paraqet vlerën e tregut të pozicionit, gjegjësisht shumën që duhet të paguajë në rast të nevojës për zëvendësim të pozicionit. Nëse kjo shumë është negative, atëherë kostoja është e barabartë me zero;
- **ekspozimi i mundshëm i rrezikut nga pala tjetër kontraktuese** e cila fitohet si produkt i vlerës nominale dhe përqindjes përkatëse nga Tabela nr.17.

Tabela nr. 17

Afati i mbetur	Marrëveshje që i referohen normave të interesit	Marrëveshje që i referohen kursit valutor dhe arit	Marrëveshje që i referohen instrumenteve pronësore	Marrëveshje që i referohen metaleve të çmuara, përveç arit	Marrëveshje që i referohen mallrave që nuk janë metal i çmuar
Deri më 1 vit	0%	1.0%	6.0%	7.0%	10.0%
Nga 1 deri më 5	0.5%	5.0%	8.0%	7.0%	12.0%
Mbi 5 vite	1.5%	7.5%	10.0%	8.0%	15.0%

Marrëveshjet që nuk mund të shpërndahen në asnjë prej kategorive nga Tabela nr. 17, banka është e detyruar të zbatojë përqindjen e duhur për marrëveshjet që i referohen mallrave që nuk janë metal i çmuar.

Për marrëveshjet tek të cilat është parashikuar pagesë e kryegjësë në shumë raste, banka është e detyruar t'i shumëzojë përqindjet nga Tabela nr. 17 me numrin e pagesave të mbetura të kryegjësë, në pajtim me dispozitat e marrëveshjes.

IX. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT NGA NDRYSHIMI I ÇMIMEVE TË MALLRAVE

151. Banka është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave për të gjitha pozicionet nga portfolio e aktiviteteve bankare dhe nga portfoli për tregtim.

152. Nën mallra, në kuptim të këtij vendimi, nënkuptohet produkti fizik me të cilën tregtohet ose mund të tregtohet në tregun sekondar, siç janë produktet bujqësore, mineralet (përfshirë edhe naftën), metalet e çmuara (pa arin) dhe derivatet dhe instrumentet tjera financiare që i referohen këtyre produkteve.

Çdo pozicion i bankës në mallra shprehet në njësitë standarde të matjes (p.sh. fuçi, tonelata, kilogramë). Banka është e detyruar të shpreh vlerën e tregut për secilin mall në denarë. Kur vlera e tregut të mallit shprehet në valutë tjetër, banka është e detyruar të shpreh atë vlerë në denarë, me zbatimin e kursit valutor të tregut.

153. Gjatë përcaktimit të kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave, banka është e detyruar ta shfaq pozicionin e gjatë ose të shkurtër në secilin mall. Pozicioni në çdo mall, pozicionet në derivate financiare dhe instrumente të tjera financiare që i referohen mallrave shfaqen në pajtim me pikat 154 dhe 155 të këtij vendimi.

Nëse pozicioni i caktuar në mallra paraqet ekspozim ndaj rreziqeve të tjera të definuara me këtë vendim, banka është e detyruar në mënyrë përkatëse ta përfshijë edhe në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e atyre rreziqeve.

154. Pozicionet në derivate financiare dhe instrumente tjera financiare që i referohen mallrave shfaqen si kombinim i pozicionit të gjatë dhe të shkurtër me afat përkatës, dhe atë:

- për marrëveshjet fjuçers dhe forvard ku lënda është mall i caktuar, si pozicioni i gjatë dhe i shkurtër në lëndën e marrëveshjes (malli);
- për swap të mallrave si kombinim i pozicionit të gjatë dhe të shkurtër të mallrave që janë lëndë e swapit.

Pozicionet në marrëveshjet repo dhe marrëveshjet për marrjen ose dhënien e kredisë të palës tjetër kontraktuese përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve si pozicione në mallrat që janë lëndë e këtyre marrëveshjeve.

155. Banka mund të kryen netimin e pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në derivate të mallrave nëse bëhet fjalë për llojin e njëjtë dhe sasi e njëjtë malli, vlera e të cilës është shprehur me valutë të njëjtë që kanë afat të njëjtë të maturimit.

156. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të ndryshimit të çmimeve të mallrave llogaritet për secilin mall, si përmbledhje e:

- 15% të pozicionit neto të mallit të përcaktuar në pajtim me pikën 157 të këtij vendimi, shumëzuar me çmimin aktual të tregut të atij malli; dhe
- 3% e pozicionit bruto të mallit të përcaktuar në pajtim me pikën 158 të këtij vendimi, shumëzuar me çmimin aktual të tregut të atij malli.

157. Pozicioni neto i bankës në një mall paraqet dallim ndërmjet pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në atë mall.

158. Pozicioni bruto i bankës në një mall paraqet përmbledhje të vlerës absolute të pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në atë mall.

159. Kapitali i përgjithshëm i bankës i nevojshëm për mbulimin e rrezikut të ndryshimeve në çmimet e mallrave është i barabartë me shumën e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të ndryshimeve në çmimin e secilit mall me të cilin banka tregton.

X. KAPITALI I NEVOJSHËM PËR MBULIMIN E RREZIKUT OPERATIV

160. Banka e përcakton kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ me përdorimin e treguesit bazë. Treguesi bazë paraqet përmbledhje në pozicionet në vijim pozitive dhe negative, të realizuara si rezultat i punës së rregullt të bankës:

- 1) Të hyra nga interesi;
- 2) Shpenzime nga interesi;
- 3) Të hyra nga dividendi, përveç të hyrave nga investimet në shoqëri të asociuara, filiale dhe investime të përbashkëta;
- 4) Të hyra nga provizionet dhe tarifat;
- 5) Shpenzime nga provizionet dhe tarifat;
- 6) Të hyra dhe të dalura nga pozicionet të cilat janë pjesë nga portfoli për tregtim;
- 7) Të hyra dhe të dalura në bazë të dallimeve të kursit;
- 8) Të hyra të realizuara dhe të dalura nga pozicionet që nuk maten sipas vlerës objektive përmes bilancit të suksesit, nëse dalin nga pozicionet që janë pjesë nga portfoli për tregtim;
- 9) Të hyra dhe të dalura nga pozicionet për mbrojtjen e vlerës të pozicioneve tjera.
- 10) Të hyra tjera operative.

Në të hyrat tjera operative nuk përfshihen të hyrat e jashtëzakonshme dhe të hyrat e realizuara në bazë të marrëveshjes së bërë të sigurimit në emër dhe për llogari të bankës. Në të dalurat nga provizionet dhe tarifat përfshihen kostot për shërbime nga pala tretë, vetëm nëse bëhet fjalë për shërbim të personit amë, personit vartës të bankës ose personit vartës të personit amë të bankës.

Gjatë llogaritjes së treguesit bazë nuk përfshihet çfarëdo lloj korrigjimi i vlerës së pozicioneve.

Treguesi bazë llogaritet në bazë vjetore për periudhën që përfundon në fund të vitit financiar (31.12.).

Nëse banka nuk disponon me raporte financiare të rishikuara, gjatë përcaktimit të treguesit bazë mund t'i merr parasysh reportet e parishikuara.

161. Në bazë të treguesit bazë, banka mund ta përcaktojë kapitalin për mbulimin e rrezikut operativ me përdorimin e një nga këto dy qasje në vijim:

- qasje në tregues bazë, në pajtim me kreun X.1 të këtij vendimi;
- qasje të standardizuar, nëse banka i plotëson kriteret nga kreu X.2 të këtij vendimi.

162. Banka Popullore mund të përcaktojë edhe sasi më të madhe të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, nga kapitali i përcaktuar në pajtim me kriteret X.1 ose X.2 të këtij vendimi, nëse vlerëson se ai kapital nuk i korrespondon ekspozimit të bankës së rrezikut operativ.

X.1 Qasje e treguesit bazë për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ

163. Në pajtim me qasjen e treguesit bazë, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ përcaktohet kur mjedisi aritmetik i shumave pozitive trevjeçare të treguesit bazë, i përcaktuar në pajtim me pikat a160 të këtij vendimi, do të shumëzohet me 15%.

Nëse në çfarëdolloj nga tre vitet e fundit banka ka realizuar tregues bazë të barabartë ose më të vogël se zero, ajo shumë dhe ai vit nuk përfshihen në përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, gjegjësisht nuk merren parasysh gjatë llogarisë në mjedisin aritmetik.

X.2 Qasje e standardizuar për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ

X.2.1 Kriteret për zbatimin e qasjes së standardizuar

164. Banka mund të përdorë qasjen e standardizuar për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, vetëm nëse i plotëson të gjitha kriteret për zbatimin e qasjes së standardizuar të përcaktuara në pikat 165, 166, 167 dhe 168 të këtij vendimi (në tekstin në vijim: kriteret e nevojshme). kriteret e nevojshme).

165. Banka është e detyruar t'i shpërndajë aktivitetet e tij financiare në linjat afariste të definuara në tabelën nr. 18 dhe të përcaktojë treguesin bazë të pikës 160 të këtij vendimi për secilën linjë afariste.

Tabela nr. 18

Linjat afariste	Aktivitetet	Norma e kapitalit të nevojshëm për linjën afariste
1	2	3
Shërbimet e lidhura me financimin e tregtarëve që, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare	Shitblerja, garancia dhe/ose vendosja e emetimit të letrave me vlerë me detyrim të ndërmarrë për riblerje të	18%

Konsiderohen për tregtar të mëdhenj dhe të mesëm	emetimit dhe shërbime lidhur me garantimin dhe ose vendosjen Këshillime të personave juridik në lidhje me kapitalin, strategjitë afariste dhe të ngjashme Shërbime gjatë zbatimit të bashkimit dhe shkrirjes, marrjen e aksioneve ose pjesë në shoqëritë tjera, privatizimet Këshillime investimi Shërbimet të lidhura me hulumtime të investimit dhe analizë financiare, si dhe lloje të tjera rekomandime të përgjithshme për transaksionet me instrumente financiare	
Tregtim dhe shitje	Tregtim në emrin tuaj dhe për llogarinë tuaj Ndërmjetësim i tregut të parasë Pranimi dhe realizimi i urdhëresave lidhur me një ose më shumë instrumente financiare, që nuk janë të përfshira në linjën afariste "shërbime brokerimi me pakicë" Realizimi i urdhëresave në emër të klientëve, zbatimi i ofertës dhe shitja e instrumenteve financiare pa detyrime për blerjen e tyre (nëse nuk janë përfshirë në linjën afariste "shërbime brokerimi me pakicë") Operacione përmes sistemeve multilaterale për tregtim	18%
Banking me pakicë (personave fizik dhe SHM)	Mbledhjen e depozitave dhe burime tjera kthyesë të mjeteve Kreditimi dhe aktivitete tjera të ngjashme të financimit të klientit (financimi i projekteve tregtare,	12%

	faktoring, forfeiting dhe të ngjashme) Lizing financiar Lëshimi i garancive, avalitë dhe instrumentet tjera të ngjashme	
Banking tregtare (tregtarë të mesëm dhe të mëdhenj në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare)	Mbledhjen e depozitave dhe burime tjera kthyesë të mjeteve Kreditimi dhe aktivitete tjera të ngjashme të financimit të klientit (financimi i transaksioneve tregtare, faktoring, forfeiting dhe të ngjashme) Lizingu financiar Lëshimi i garancive, avalitë dhe instrumentet tjera të ngjashme	15%
Qarkullim pagesor dhe shlyerje	Shërbime në qarkullimin pagesor në vend dhe jashtë vendit Lëshimi dhe administrimi i mjeteve pagesore	18%
Shërbime si agjenti	Ofrimi i shërbimeve të bankës-kujdestarit të pronës dhe shërbime tjera të ngjashme të ruajtjes dhe administrimit të mjeteve financiare në emër dhe	15%
Menaxhimi me mjetet	Menaxhimi me mjetet dhe portfolio të letrave me vlerë me urdhërpagesë dhe për llogari të klientit Menaxhimi me fondet për investime të përbashkëta (fondet pensionale dhe investuese) Forma tjera të menaxhimi me mjetet	12%
Shërbime brokerimi me pakicë (Personat fizik dhe SHM)	Pranimi dhe realizimi i urdhëresave për transferim me një ose më shumë instrumente financiare që nuk janë të përfshira në linjën afariste "shitje dhe tregtim" Realizimi i urdhëresave në emër për llogarit të klientëve,	12%

	zbatimi i ofertës dhe shitja e instrumenteve financiare pa detyrime për blerjen e tyre	
--	--	--

166. Banka është e detyruar të vendosë dhe të zbatojë politikë për shpërndarjen e aktiviteve pas linjave afariste në të cilën do t'i përcakton parimet për shpërndarjen e aktiviteve financiare në linjat përkatëse afariste dhe për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ me ndryshimin e qasjes së standardizuar.

Bordi Drejtues është i detyruar të përgatisë dhe ta sjellë politikën nga paragrafi 1 të kësaj pike. Bordi Mbikëqyrës i bankës është i detyruar ta rishikojë dhe ta miratojë këtë politikë.

Politika nga paragrafi 1 i kësaj pike duhet të jetë lëndë e rishikimit të rregullt dhe harmonizimit me aktivite financiare që i kryen banka dhe rreziqet të cilat është ekspozuar si rezultat i tyre aktiviteve.

167. Banka e kryen shpërndarjen e aktiviteve financiare në linjë afariste të veçantë me zbatimin e parimeve në vijim:

- të përfshira janë të gjitha aktivitetet e bankës;
- të gjitha aktivitetet që janë në funksion i ndonjë aktiviteti tjetër (aktivitet ndihmës) përfshihen në linjën afariste të cilës i takon aktiviteti bazë. Nëse aktiviteti ndihmës kryhet si mbështetje e disa aktiviteve, banka përdorë kritere për shpërndarjen e saj, ku këto kritere duhet vazhdimisht të zbatohen në të gjitha rastet e ngjashme;
- nëse aktiviteti nuk mund të përfshihet në asnjë linjë afariste, ai aktivitet përfshihet në atë linjë afariste për të cilën është përcaktuar norma më e lartë e kapitalit të nevojshëm (kolona nr. 3 nga Tabela nr.18). Në këtë linjë afariste shpërndahen dhe të gjitha aktivitetet përkatëse ndihmëse të atij aktiviteti;
- kostot e bëra në një linjë afariste, të cilat njëkohësisht i referohen linjës tjetër afariste, mund të shpërndahen në linjat përkatëse afariste sipas metodave të brendshme për shpërndarje;
- procesin që e përdor banka për shpërndarjen e aktiviteve të veçanta sipas linjave afariste duhet të jetë plotësisht e dokumentuar. Banka është e detyruar të ketë përkufizime të qarta dhe të detajuara për secilën linjë afariste;
- shpërndarja e aktiviteve sipas linjave afariste dhe mënyra e llogarisë së treguesit bazë janë lëndë e kontrollit të pavarur nga shërbimi i auditimit të brendshëm ose shoqëria për auditim.

168. Përveç kritereve nga pikat 165, 166 dhe 167 të këtij vendimi, banka është e detyruar t'i plotësojë edhe kriteret në vijim për zbatimin e qasjes së standardizuar:

- sistemi për menaxhimin me rrezikun operativ është i dokumentuar plotësisht dhe i referohet të gjithë veprimtarisë së bankës;
- qartë janë përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve të veçanta të bankës, si dhe të punonjësve në bankë që janë të përfshira në sistemin e menaxhimit me rrezikun operativ;
- monitorohen të gjitha të dhënat që janë të rëndësishme për menaxhimin e rrezikut operativ, veçanërisht të dhënat për humbjet e konsiderueshme të realizuara si pasojë e ekspozimit ndaj këtij rreziku;
- është vendosur sistem i raportimit të rregullt të organeve të bankës për ekspozimin ndaj rrezikut operativ dhe për humbjet e realizuara, që mundëson marrjen e të dhënave përkatëse dhe në kohë dhe informacionet mbi ekspozimin ndaj rrezikut operativ. Banka është e detyruar të ketë procedura për marrjen e masave nga organet përkatëse, në bazë të informacioneve të marra;
- sistemi për menaxhimin me rrezikun operativ është lëndë e kontrollit të pavarur të rregullt nga shërbimi i brendshëm i auditimit dhe shoqëria për auditim.

Shërbimi për auditim të brendshëm është i detyruar, para fillimit të zbatimit të qasjes së standardizuar, të përcaktojë plotësimin e kriterëve të nevojshme, si dhe të kontrollojë në bazë të rregullt nëse banka vazhdon t'i plotësojë kriteret e nevojshme.

X.2.2 Llogaritja e kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ me zbatimin e qasjes së standardizuar

169. Banka që i plotëson kriteret e nevojshme e përcakton kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ nëpërmjet llogaritjes së treguesit bazë të ponderuar sipas rrezikut për çdo linjë afariste dhe treguesit bazë të ponderuar sipas rrezikut për secilin nga tre vitet e fundit.

Treguesi bazë i ponderuar sipas rrezikut për çdo linjë afariste paraqet produkt të treguesit bazë për atë linjë afariste, i përcaktuar në pajtim me pikat 160 dhe 165 të këtij vendimi dhe normës së kapitalit të nevojshëm të përcaktuar në kolonën nr. 3 nga Tabela nr. 18. 3 одТабела 6р.

Shuma e të gjitha treguesve të ponderuara sipas rrezikut për çdo linjë afariste gjatë një viti jep treguesin e ponderuar sipas rrezikut për atë vit. Gjatë përcaktimit të treguesit bazë të ponderuar sipas rrezikut për vitin e caktuar, merren parasysh të gjithë treguesit bazë të ponderuar sipas rrezikut për çdo linjë afariste, pa dallim të shenjës së tyre (pozitiv ose negativ).

Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ fitohet kur përmbledhja e treguesve bazë të ponderuar sipas rrezikut për secilin nga tre vitet e fundit do të ndahet me 3. Nëse treguesi bazë i ponderuar sipas rrezikut për vitin e caktuar është negativ, gjatë përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ merret parasysh me vlerën që është e barabartë me zero.

170. Banka që e përdor qasjen e treguesit bazë për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, është e detyruar ta njoftojë Bankën Popullore për qëllimin dhe datën kur planifikon të fillojë ta përdorë qasjen e standardizuar.

Banka është e detyruar t'i plotësojë kriteret e nevojshme. Nëse banka ndërpret t'i plotëson kriteret e nevojshme, është e detyruar të dorëzojë me shkrim arsyetim te Banka Popullore në afat prej pesë ditëve të punës, duke shënuar arsyet e mosplotësimit të kriterëve, masave që i merr për largimin e atyre arsyeve, si dhe afatin në të cilin do të sigurohet sërish plotësimi i plotë i kriterëve të nevojshme.

Banka Popullore mund t'i udhëzojë bankës afate të ndryshme dhe masa nga masat dhe afatet e shënuara në arsyetimin me shkrim nga paragrafi 2 i kësaj pike.

171. Nëse, në bazë të arsyetimit të dorëzuar me shkrim nga pika 170 të këtij vendimi ose nëpërmjet kryerjes së funksionit mbikëqyrës, Banka Popullore vlerëson se banka nuk i plotëson kriteret e nevojshme, as nuk mund në afat përkatës të sigurojë plotësimin e kriterëve të nevojshme, mund t'i udhëzojë bankës të ndërpret të zbatojë qasjen e standardizuar, gjegjësisht të fillojë të përcaktojë kapitalin për mbulimin e rrezikut operativ me zbatimin e qasjes së treguesit bazë.

Banka që e zbaton qasjen e standardizuar nuk mund të vendosë të kalojë në qasjen e treguesit bazë për përcaktimin e kapitalit për mbulimin e rrezikut operativ, nëse paraprakisht nuk e njofton Bankën Popullore dhe nëse nuk merr pëlqim nga ajo. Banka është e detyruar t'i shënojë arsyet për shkak të cilave planifikon të kalojë në përdorimin e qasjes së treguesit bazë për përcaktimin e kapitalit për mbulimin e rrezikut operativ.

XI. TRAJTIMI I OPSIONEVE

172. Në kuptim të këtij vendimi, të gjitha pozicionet në opsione konsiderohen të gjitha opsionet e normave të interesit, instrumentet e borxhit, instrumentet pronësore, kursi valutor dhe instrumentet e tjera financiare me të cilat tregton banka në bursën zyrtare ose nëpërmjet sportelit, si dhe të gjitha instrumentet e tjera që kanë karakteristika të ngjashme të opsioneve.

173. Banka që blen opsione është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut nga opsionet e blera të letrave me vlerë, duke përfshirë edhe opsionet që janë të blera për shkak të mbrojtjes të pozicioneve të caktuara nga portfolio për tregtim.

Shuma e kapitalit të fituar në pajtim me pikat 174 dhe 175 të këtij vendimi në mënyrë përkatëse përfshihet në kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut të pozicionit (krerët VIII.3 dhe VIII.4 të këtij vendimi), kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor (kreu VII i këtij vendimi) dhe kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave (kreu IX i këtij vendimi).

174. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut në bazë të opsioneve të blera, është më e vogël nga shumat në vijim:

- a) vlera e tregut e lëndës së opsionit shumëzuar me:
- përmbledhja e rrezikut specifik dhe të përgjithshëm - për opsionet e instrumenteve të borxhit ose instrumenteve pronësore;
 - 8% - për opsionet valutore;
 - 15% - për opsionet e mallrave;
- ose b) vlera e tregut të opsionit.

175. Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut në bazë të opsioneve të blera për shkak të mbrojtjes së pozicionit të caktuar në portfolio për tregtim (kombinimi i opsionit "put" dhe pozicionit të gjatë në instrument financiar, valutë e huaj ose mallra pozicioni i së cilës mbrohet, ose kombinimi i blerë opsioni "koll" dhe pozicionit të shkurtër në instrument financiar, valutë e huaj ose malli pozicioni i së cilës mbrohet), paraqet dallim ndërmjet:

- a) vlerës së tregut të lëndës së opsionit shumëzuar me:
- përmbledhja e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut specifik dhe të përgjithshëm në bazë të lëndës së opsionit - për opsionet e instrumenteve të borxhit dhe instrumenteve pronësore;
 - 8% - për opsionet valutore;
 - 15% - për opsionet e mallrave; dhe
- b) vlera e brendshme e opsionit (англ. in the money).

176. Banka nuk mund të kryejë shitje të opsioneve pa pëlqimin paraprak nga Banka Popullore për metodën që do të përdorë për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, rrezikun nga ndryshimet e çmimeve të mallrave dhe rrezikun valutor të lidhura me opsionet (p.sh. metoda dellta - plus ose model tjetër i brendshëm).

XII. PËRDORIMI I REJTINGJEVE KREDITORE PËR PËRCAKTIMIN E PONDERËVE TË RREZIKSHMËRISË

177. Banka mund të zgjedhë një ose më shumë IKR ose AKI të njohura, rejtingjet kreditore të së cilave do t'i përdorë për përcaktimin e shkallës së cilësisë kreditore, gjegjësisht ponderin e rrezikshmërisë të kategorive të veçanta të ekspozimit.

Banka mund t'i përdorë vlerësimet kreditore AKI të njohura vetëm për kërkesat nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka nuk mund të zgjidh IKR të njohur që është:

- filiali i bankës;
- personi amë i bankës; ose
- Personi në të cilën banka direkt ose indirekt realizon pjesëmarrje ose së bashku me bankat tjera, direkt ose indirekt është pronar i mbi 50% i numrit të përgjithshëm të aksioneve ose hise ose me të drejtë të votës të atij personi.

Banka është e detyruar me akt të brendshëm të përcaktojë mënyrën e përzgjedhjes së IKR të njohur dhe mënyrën e përdorimit të rejtingjeve kreditore të saj.

178. Banka është e detyruar t'i përdorë rejtingjet kreditore të IKR së përzgjedhur, gjegjësisht vlerësimet kreditore të AKI të njohur, vazhdimisht dhe në mënyrë të njëjtë për të gjitha kategoritë të ekspozimit, gjegjësisht për të gjitha llojet e produkteve kreditore për të cilat e ka zgjedhur ajo IKR, gjegjësisht AKI.

Banka mund ta përdorë rejtingun kreditor të IKR së përzgjedhur, gjegjësisht vlerësimin kreditor të AKI së përzgjedhur, vetëm nëse ai rejting, gjegjësisht vlerësimi i referohet kërkesës së përgjithshme, gjegjësisht të ekspozimit në bazë të kryegjësë dhe interesit.

179. Banka është e detyruar t'i përdorë rejtingjet e kërkuara kreditore nga IKR e njohur.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka mund të përdorë edhe rejtingje të pakërkuara kreditore nga IKR e njohur, vetëm nëse Banka Popullore ka lejuar rejtingje të tilla të përcaktuara nga ajo IKR.

180. Nëse për kategori të caktuar ekspozimi ekziston rejting kreditor prej vetëm një IKR e përzgjedhur, gjegjësisht vlerësim kreditor prej vetëm një AKI e përzgjedhur, ai rejting përdoret për përcaktimin e shkallës së cilësisë së kredisë, gjegjësisht ponderit të rrezikut të kërkesës.

Nëse për kategorinë e caktuar ekspozimi ekzistojnë rejtingje kreditore, gjegjësisht vlerësime kreditore prej dy IKR dhe/ose AKI të cilat i përgjigjen ponderëve të ndryshëm të rrezikut, banka është e detyruar ta zbatojë ponderin më të lartë të rrezikut.

Nëse për kategorinë e caktuar ekspozimi ekzistojnë rejtingje kreditore, gjegjësisht vlerësime kreditore prej tri ose më shumë IKR dhe/ose AKI të zgjedhura, banka është e detyruar ta zbatojë më të lartën prej dy ponderëve më të ulët të rrezikut.

181. Në rastet kur kërkesa e bankës është në bazë të instrumentit financiar për të cilin ekziston rejting kreditor afatgjatë nga IKR e zgjedhur, banka është e detyruar të përdorë atë rejting për përcaktimin e ponderit të rrezikut të kërkesës (dhe jo rejtingun kreditor afatgjatë të debitorit), në bazë të tabelës përkatëse nga kreu VI të këtij vendimi, për kategorinë e ekspozimit të cilës i takon instrumenti financiar ose debitori.

Nëse për instrumentin financiar nga i cili rezulton kërkesa e bankës nuk ka rejting afatgjatë të kredisë nga IKR e përzgjedhur, por ka së paku një rejting kredie nga IKR e përzgjedhur për debitorin ose ndonjë instrument tjetër financiar të lëshuar prej tij, banka është e detyruar të përdorë ponderin më të lartë të rrezikut të dy ponderëve në vijim:

- 1) Ponderi më i lartë i rrezikut prej: (1) ponderi që i përshtatet rejtingut kreditor afatgjatë të debitorit ose (2) ponderi i cili i përshtatet instrumenteve tjera financiare të emetuar nga debitori; ose

- 2) Ponderi i rrezikut i cili në pajtim me kreun VI të këtij vendimi zbatohet në rastet kur nuk është përcaktuar rejting kreditor afatgjatë i debitorit.

182. Për përcaktimin e ponderit të rrezikut të kërkesës nga debitori i përcaktuar, banka nuk duhet t'i përdorë rejtingjet kreditorë të personave (ose instrumentet e emetuara prej anës së tyre të cilat së bashku me debitorin u takojnë grupit të njëjtë persona të lidhur.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, të kërkesës nga debitori që është filial e personit amë të caktuar, banka e zbaton:

- Ponderin e rrezikut të përcaktuar në bazë të rejtingut kreditor të personit amë (nëse personi amë ka rejting kreditor), ose
- më i larti prej dy ponderëve: (1) 100% ose (2) ponderi i rrezikut të qeverisë qendrore ku gjendet selia e personit amë.

183. Banka përdorë rejting kreditor afatshkurtër për kërkesa afatshkurtra nga bankat dhe shoqëritë tjera tregtare.

Kërkesave afatshkurtra nga paragrafi 1 të kësaj pike zbatohen ponderët e rrezikut nga tabela në vijim (Tabela nr.19), pavarësisht prej rejtingut kreditor afatshkurtër të atyre kërkesave:

Tabela nr. 19

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5	6
Ponderi i rrezikut	20%	50%	100%	150%	150%	150%

Nëse ponderi i rrezikut të kërkesës afatshkurtër (instrument financiar afatshkurtër i emetuar nga banka ose shoqëri tregtare tjetër) është 150% banka është e detyruar të përdorë ponderin e njëjtë për të gjitha kërkesat e pasiguruara afatgjata dhe afatshkurtra nga ai debitor për të cilin nuk është përcaktuar rejting kreditor nga IKR e njohur.

Nëse ponderi i rrezikut të kërkesës afatshkurtër (instrument financiar afatshkurtër i emetuar nga banka ose shoqëri tregtare tjetër) është 50%, banka është e detyruar t'i përdorë ponderët në vijim të rrezikut:

- 100% për të gjitha kërkesat afatshkurtra nga ai debitor për të cilët nuk është përcaktuar rejting kreditor nga IKR e njohur, nëse në pajtim me pikën 181 paragrafi 2 të këtij vendimi, ponderi i rrezikut të atyre kërkesave është i barabartë ose më i ulët se 100%;
- 150% për të gjitha kërkesat afatshkurtra nga ai debitor për të cilët nuk është përcaktuar rejting kreditor nga IKR e njohur, nëse në pajtim me pikën 181 paragrafi 2 të këtij vendimi, ponderi i rrezikut të atyre kërkesave është 150%.

184. Banka mund ta përdorë rejtingun kreditor që i referohet kërkesave të shprehura në valutën vendase të debitorit vetëm për përcaktimin e ponderit të rrezikut të atyre kërkesave, dhe jo edhe për kërkesat nga debitori të shprehura në valutë të huaj.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka mund të përdorë rejtingun kreditor që i referohet kërkesës së shprehur në valutën vendase të debitorit për përcaktimin e ponderit të rrezikut të kërkesës nga debitori në valutë të huaj të bankës zhvillimit shumëpalëshe, në miratimin e së cilës ka marrë pjesë edhe banka.

XIII. PROCEDURA DHE KRITERET E NJOHJES SË IKR-së

XIII.1 Procedura për njohje

185. Çdo IKR, rejtingjet e së cilës do të përdoren nga banka në Republikën e Maqedonisë për nevojat e këtij vendimi është e detyruar për parashtrim kërkesë në Bankën Popullore për njohjen e saj (Aneksi nr.2).

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij vendimi, institucionet: "Fiç rejtings", "Medius" dhe "Standard dhe Purs", që konsiderohen për IKR të njohur, nuk kanë detyrim për dorëzimin e kërkesës në Bankën Popullore për njohjen e tyre.

186. Banka Popullore mund të zbatojë procedurë direkte ose indirekte për njohjen e IKR-së dhe shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të saj në shkallë përkatëse të cilësisë së kredisë.

Procedura direkte për njohjen e IKR nënkupton vlerësim të Bankës Popullore të harmonizimit të metodologjisë dhe rejtingjeve kreditore të asaj IKR me kriteret dhe kushtet të përcaktuara në kreun XIII të këtij vendimi.

Procedura indirekte për njohjen e IKR-së nënkupton njohjen e IKR-së, duke përfshirë dhe shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të saj në shkallë përkatëse të cilësisë së kredisë, pa zbatimin e vlerës për harmonizimin e metodologjisë dhe rejtingjeve kreditore të asaj IKR me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në kreun XIII të këtij vendimi. Procedura indirekte për njohjen mund të zbatohet për IKR në vijim:

- IKR me seli në vend anëtar të Bashkimit Europian që është e regjistruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 1060/2009 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, ose
- IKR është e njoftuar nga organi kompetent i vendit anëtar të Bashkimit Europian.

187. Në rastet kur IKR në të njëjtën kohë parashtron kërkesë në Bankën Popullore dhe deri te organet kompetente të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, Banka Popullore mund të zbatojë procedurë të njohjes së përbashkët me organet tjera kompetente. Roli i Bankës Popullore në procedurë të njohjes së përbashkët do të varet nga marrëveshja e arritur me organet tjera kompetente që do të marrin pjesë në atë procedurë.

Qëllimi i procedurës së njohjes së përbashkët është i përbashkët për të kryer njohjen e IKR, dhe të shpërndahen rejtingjet kreditore të saj në shkallët përkatëse të cilësisë së kredisë.

Pjesëmarrja e Bankës Popullore në procedurën e njohjes së përbashkët nuk e kufizon të drejtën e saj të kërkon informacione shtesë nga IKR, që ka parashtruar kërkesë për njohjen dhe të kryejë vlerësim shtesë të kërkesës së parashtruar. Nevoja për informacione shtesë mund të rezultojnë nga kërkesat e veçanta të përfshira në rregulloret e Republikës së Maqedonisë, që nuk mund të jenë të përfshira në procedurën e njohjes së përbashkët.

188. Pavarësisht mënyrës se si zbatohet procedura e njohjes, në kërkesën për njohje, IKR-ja dorëzon:

- 1) Dëshmi se rejtingjet e saj kreditore do të përdoren për nevojat e këtij vendimi së paku prej një banke në Republikën e Maqedonisë (deklaratë nga Aneksi nr.3) ku ajo bankë:
 - nuk është personi amë i saj ose filial i saj,
 - direkt ose indirekt nuk realizon pjesëmarrje në atë IKR, në rastet kur së bashku me bankat tjera në Republikën e Maqedonisë direkt ose indirekt është pronar i mbi 50% i numrit të përgjithshëm të aksioneve ose hiseve ose me të drejtë të votës të asaj IKR;
- 2) Paketë e zakonshme - informacione (Aneksi nr.5) në bazë të cilës Banka Popullore do të përcaktojë nëse metodologjia dhe rejtingjet kreditore të IKR i plotësojnë kriteret të definuara në kreun XIII të këtij vendimi;
- 3) Dëshmi se IKR është regjistruar në pajtim me dispozitat e Rregullores 1060/2009 të Parlamentit Europian dhe Këshillit ose se është e njohur nga organi kompetent i vendit anëtar të Bashkimit Europian. Kjo dëshmi dorëzohet vetëm nëse Banka Popullore zbaton procedurë indirekte të njohjes;
- 4) Deklaratë për harmonizim të metodologjisë dhe procedurave në nivelin e të gjithë grupit, nëse IKR si person amë i asaj grupe parashtron kërkesë për njohjen e nivelit të gorpës (Aneksi nr.4) në pajtim me pikën 190 të këtij vendimi;
- 5) Dëshmi përkatëse për njohjen e IKR, nga organi kompetent i vendeve të treta dhe deklaratë të nënshkruar nga IKR me të cilën i lejon organit kompetent të vendit të tretë të dorëzojë të gjithë dokumentacionin në Bankën Popullore lidhur me procedurën e njohjes së saj për nevojat e përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor (nëse IKR është e njohur nga organi kompetent i vendit që nuk është anëtarë e Bashkimit Europian).

Në kërkesën nga paragrafi 1 të kësaj pike, IKR është e detyruar t'i shënojë segmentet e tregut për të cilat kërkon njohje. IKR mund të kërkon njohjen për të gjitha segmentet e tregut, për pjesë nga segmentet bazë të tregut ose për çfarëdolloj segmenti shtesë të tregut, në mënyrë përkatëse të kategorive të ekspozimit të definuara në këtë vendim.

Në procedurën e njohjes Banka Popullore mund të kërkon edhe dokumentacion shtesë nga dokumentacioni nga paragrafi 1 i kësaj pike, nëse vlerëson se ajo është e nevojshme për zbatimin e duhur të procedurës.

189. Dokumentacioni nga pika 188 të këtij vendimi dorëzohet në origjinal ose në kopje të vërtetuar te personi i autorizuar (noter), e nënshkruan nga personi i autorizuar ose nga organi përkatës, të jetë e pastër, pa përmirësime tjera shtesë, dhe në gjuhën maqedonase. Nëse dokumentacioni që duhet të dorëzohet është në gjuhën tjetër, së bashku me origjinalin dorëzohet edhe përkthimi në gjuhën maqedonase, i vërtetuar nga përkthyesi i autorizuar.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, dokumentacioni mund të dorëzohet edhe në gjuhën angleze, ku Banka Popullore e mban të drejtën e procedurës për njohjen të kërkon përkthim të një pjese ose të gjithë dokumentacionit në gjuhën maqedonase, të vërtetuar nga përkthyesi i autorizuar.

190. IKR mund të parashtroj kërkesë për njohjen në nivel të gjithë grupit të cilës i takon ose në nivel të filialit të veçantë.

Banka Popullore do të kryejë njohjen e IKR në nivel të gjithë grupit, nëse IKR mund të tregoj se të gjitha filialet-anëtare të grupit zbatojnë vlerësime të njëjta kreditore, metodologji, procedura dhe praktika për përcaktimin e rejtingjeve kreditore.

Nëse vlerësimet kreditore, metodologjia, procedurat dhe praktikat e filialeve-anëtare të veçanta të grupës në mënyrë të ndërsjellë ndjeshëm dallohen, Banka Popullore do të kërkojë prej secilës filiali të parashtroj kërkesë të veçantë për njohje.

191. Në të gjitha rastet do të përcaktohet se IKR e caktuar i plotëson kriteret të përcaktuara në kreun XIII të këtij vendimi, Banka Popullore lëshon pëlqim për njohjen e asaj IKR. Në pajtueshmërinë shënohen segmentet e tregut për të cilat mund të përdoren rejtingjet kreditore të IKR së njohur, si dhe mënyra e shpërndarjes së rejtingjeve kreditore të saj në shkallë përkatëse të cilësisë së kredisë.

192. Banka Popullore mban listë të IKR së njohur që e publikon dhe në kohë e përditëson në ueb faqen e saj.

Lista nga paragrafi 1 i kësaj pike i përmban së paku informacionet në vijim:

- Emri i IKR-së së njohur;
- Segmentet e tregut për të cilat mund të përdoren rejtingjet kreditore të saj;
- Mënyra e shpërndarjes së rejtingjeve kreditore të IKR së njohur sipas shkallëve të cilësisë së kredisë;
- Përcaktimi nëse banka në Republikën e Maqedonisë mund të përdorë rejtingje kreditore të pakërkua të ndara nga IKR e njohur.

Përveç listës së IKR-së së njohur, Banka Popullore publikon në kohë të dhënat për të gjitha rastet kur ka kryer rishpërndarjen e rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur ose ka tërhequr plotësisht ose pjesërisht pëlqimin për njohje.

XIII.2 Kriteret për njohje

193. Gjatë vendimarrjes për njohjen e IKR-së së caktuar, Banka Popullore vlerëson:

- Harmonizimi i metodologjisë së saj me kriteret për objektivitete, pavarësi, mbikëqyrje e vazhdueshme dhe rishikim i transparencës, në pajtim me kreun XIII.2.1 të këtij vendimi;
- besueshmëria dhe përdorimin e tregut të rejtingjeve të tij kreditore, si dhe transparenca e tyre, në pajtim me kreun XIII.2.2 të këtij vendimi.

XIII.2.1 Kriteret për vlerësimin e metodologjisë të IKR

194. Metodologjia konsiderohet për objektive nëse është konservative, sistemike, konsekuente dhe lëndë e konfirmimit të vazhdueshëm bazuar në përvojat historike.

Nëse IKR përdor metodologji të ndryshme për ndarjen e rejtingjeve kreditore në segmente të ndryshme të tregut, është e detyruar t'i arsyetojë karakteristikat e çdo metodologjie. Banka Popullore në veçanti i shqyrton dhe i vlerëson metodologjitë e veçanta dhe mund të sjell vendim për njohjen e IKR për të gjitha ose për pjesë nga segmentet e tregut për të cilat IKR ka parashtruar kërkesë për njohje.

Banka Popullore e vlerëson plotësimin e kriterit për objektivitete të metodologjisë përmes faktorëve në vijim:

- përdorimin e teknikave sasiore (si p.sh. matricat e tranzicionit ose teknikat e analizës së normës së mospagimit) me të cilat tregohet gjithëpërfshirja e metodologjisë për ndarjen e rejtingjeve të kredisë dhe aftësinë e saj për të parashikuar rejtingun e kredisë me kalimin e kohës, për kategori të ndryshme ekspozimi;
- dëshmi se, sipas metodologjisë, janë parashikuar dhe zbatuar procedurat/procedura për vlerësimin e faktorëve që ndikojnë mbi aftësinë kreditore të personit juridik ose instrumentit financiar që vlerësohet;
- dëshmi e zbatimit të qëndrueshëm të metodologjisë në përcaktimin e rejtingjeve kreditore në kuadër të segmenteve të veçanta të tregut.

195. Metodologjia e IKR duhet të jetë e pavarur nga ndikimet politike dhe kufizimet, si dhe nga ndikimet ekonomike mbi rejtingjet kreditore individuale.

Pavarësia e metodologjisë vlerësohet në bazë të faktorëve në vijim:

- struktura pronësore dhe organizative e IKR-së;
- burimet e financimit të IKR-së;
- numri i të punësuarve dhe ekspertiza e tyre;
- menaxhimi korporativ i IKR-së.

Për nevojat e përcaktimit të pavarësisë së metodologjisë në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të kësaj pike, IKR është e detyruar të dorëzojë dokumentacion me të cilën do të konfirmojë se:

- ekzistojnë mekanizma përkatës për mbrojtjen e pavarësisë së procedurës për përcaktimin e rejtingjeve kreditore nga ndikimi i strukturës pronësore të IKR-së;
- struktura organizative e IKR-së mundëson demarkacion të qartë funksional dhe organizativ të veprimtarisë të përcaktimit të rejtingjeve kreditore nga veprimtaritë tjera të IKR që mund të ndikojnë negativisht mbi objektivin e vlerësimit kreditor (p.sh. ofrimi i shërbimeve këshillimore);
- ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm për mbrojtjen e IKR-së nga ndikimi i klientëve të rëndësishëm dhe të mëdhenj (nga aspekti i shumës së pjesëmarrjes së tyre në të hyrat totale të IKR-së) mbi objektivitetin e vlerësimit kreditor;
- disponon me numër të përshtatshëm të punonjësve në raport të vëllimit të veprimtarisë së saj, me çka do të mundësohet zbatimi konsistent i metodologjisë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me klientët, kur ajo është parashikuar me metodologjinë (si mënyrë për mbledhjen e të dhënave të nevojshme dhe informatave për përcaktimin e rejtingut të kredisë). Punonjësit duhet të kenë edhe përvojë të përshtatshme dhe ekspertizë të nevojshme për realizimin e detyrave të caktuara të punës (p.sh. së paku një person në ekipin që kryen analizat dhe vendos për shumën e rejtingut të kredisë të ketë së paku tre vjet përvojë si analist i kredive ose në pozicion të ngjashëm);
- kryhet auditim i brendshëm i rregullt dhe i pavarur i procedurës për përcaktimin e rejtingjeve të kredisë;
- janë vendosur procedurat e duhura të brendshme të punës me shkrim, rregullat për menaxhimin korporativ, politikat për shumën e provioneve dhe kodi i sjelljes me të cilat sigurohet integriteti i procedurës për përcaktimin e rejtingjeve të kredisë;
- janë vendosur mekanizma për njohjen e rasteve aktuale dhe të mundshme të konfliktit të interesave, marrjen e masave të duhura për parandalimin, menaxhimin ose largimin e këtyre rasteve dhe publikimin e tyre.

196. Metodologjia duhet të parashikojë monitorim dhe rishikim të vazhdueshëm të rejtingjeve të kredisë, si dhe detyrim për ndryshimin e rejtingjeve të kredisë në varësi të ndryshimeve në situatën financiare të klientit të cilit i referohet rejtingu. Rishikimi duhet të kryhet së paku një herë në vit, por më shpesh nëse ndodh ngjarje e rëndësishme që mund të nënkuptojë ndryshim në rejtingun e kredisë.

Si ngjarje e rëndësishme konsiderohet çdo ndryshim (financiar, tregu ose çfarëdolloj ndryshimi tjetër) që është mjaft e madhe për të shkaktuar, menjëherë ose në të ardhmen e afërt, ndryshim në rejtingun e kreditit të ndarë nga IKR (pa dallim nëse bëhet fjalë për rejtingun e klientit ose në letrat me vlerë të emetuara prej tij).

Vlerësimi i përmbushjes së kriterit për monitorim dhe rishikim të vazhdueshëm kryhet nëpërmjet faktorëve në vijim:

- konfirmimi i rejtingjeve të kredisë bazuar në përvojën historike, i cili duhet të bëhet së paku një herë në vit, për secilin segment të tregut - duke krahasuar rejtingun e ndarë të klientit të caktuar (ose në emetimet e letrave me vlerë të tij) me rezultatet aktuale të arritura në periudhën e mëparshme;
- procedurat e brendshme për monitorimin dhe identifikimin e ndryshimeve në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm për çdo klient që mund të paraqesin ngjarje të rëndësishme në kuptimin e paragrafit 2 të kësaj pike;
- mundësia e marrjes së informacioneve për bashkëpunimin e vendosur dhe kontaktet me klientët e IKR-së të cilëve u ka ndarë rejtingjet e kredisë – IKR është e detyruar që me kërkesë të Bankës Popullore t'i dorëzojë të gjitha informacionet në lidhje me përfshirjen e kontakteve të realizuara me organet e menaxhimit të klientëve të saj;
- informimi me kohë i Bankës Popullore për të gjitha ndryshimet e rëndësishme në metodologjinë e IKR-së – Banka Popullore duhet të informohet menjëherë për të gjitha ndryshimet e rëndësishme në metodologjinë. Si ndryshime të rëndësishme në metodologjinë konsiderohen së paku ndryshimet në informacionet që janë dorëzuar si pjesë e paketës së zakonshme të informacioneve.

197. Konsiderohet se metodologjia e IKR-së është transparente nëse IKR publikon parimet bazë të procedurës për përcaktimin e rejtingjeve të kredisë, në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për përdoruesit e mundshëm.

Transparenca e metodologjisë vlerësohet përmes:

- vëllimit të informacioneve të cilat i publikon IKR – informacionet e publikuara i referohen së paku përshkrimit të kategorive individuale të rejtingjeve të kredisë dhe njoftimit në kohë për ndryshimet e rëndësishme në metodologjinë;
- mënyra në të cilën ato informacione publikohen – në faqen publike të internetit të IKR-së, publikimet falas, etj.

XIII.2.2 Krite për vlerësimin e rejtingjeve kreditore

198. Rejtingjet individuale të kreditit të IKR-së duhet të jenë të besueshme dhe të pranueshme nga tregu, që tregon përmes vlerësimit të faktorëve në vijim:

- përdorimi i tregut i shprehur si pjesëmarrje e rejtingjeve të kredisë së IKR-së në secilin segment të tregut ose rajon gjeografik;

- shumën e të ardhurave totale të IKR-së nga dhënia e rejtingjeve të kredisë të realizuara në segmentet individuale të tregut;
- çfarëdo lidhje ndërmjet mënyrës së përcaktimit të çmimeve (provisioneve) që i paguan IKR për dhënien e rejtingjeve të kredisë dhe procedurën për përcaktimin e rejtingjeve të kredisë;
- rejtingjet kreditore të IKR-së përdoren ose do të përdoren prej së paku dy bankave me seli në Republikën e Maqedonisë për nevojat e menaxhimit me rrezikun kreditor nga ato banka.

199. Transparenca e rejtingjeve të kredisë të cilat i ka ndarë IKR nënkupton disponueshmërinë e tyre në kushte të barabarta për të gjitha bankat e interesuara, në momentin kur këto rejtingje kreditore ndahen ose rishikohen nga IKR, pa dallim nëse IKR e paguan atë qasje ose jo.

Me termin "kushte të barabarta" nënkuptohet ekzistenca e kushteve të barabarta ekonomike për qasje në rejtingjet kreditore të ndara nga IKR, gjegjësisht mosekzistenca e diskriminimit të çmimeve. Si "banka të interesuara" konsiderohen bankat, pavarësisht nga selia e tyre, të cilat përcaktojnë nivelin e nevojshëm të kapitalit për mbulimin e rrezikut të kredisë në mënyrën e përcaktuar me këtë vendim.

XIII.3 Shpërndarja e rejtingjeve kreditore

200. Banka Popullore kryen shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të IKR të njohura në shkallët e cilësisë kreditore dhe ponderët përkatës të rrezikut të përcaktuara me kreun VI të këtij vendimi.

Shpërndarja nga paragrafi 1 i kësaj pike kryhet gjatë procedurës së njohjes të IKR-së përkatëse, si dhe gjatë ndjekjes së saj.

201. Banka Popullore e kryen shpërndarjen e rejtingjeve kreditore afatgjata të IKR-së së njohur të faktorëve sasiorë dhe cilësorë të përcaktuara në krerët XIII.3.1 dhe XIII.3.2 të këtij vendimi.

202. Banka Popullore kryen shpërndarjen e rejtingjeve kreditore afatshkurtra të IKR-së së njohur duke pasur parasysh shpërndarjen e rejtingjeve kreditore afatgjata të saj bërë në pajtim me pikën 201 të këtij vendimi, si dhe në bazë të shpërndarjes së brendshme bërë nga IKR dhe dorëzuar në paketën e zakonshme të informacioneve.

203. Banka Popullore kryen shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të pjesëve në fondet investuese të IKR-së së njohur duke pasur parasysh shpërndarjen e rejtingjeve kreditore afatgjata të saj bërë në pajtim me pikën 201 të këtij vendimi, si dhe në bazë të shpërndarjes së rejtingjeve kreditore të pranueshme të pjesëve në fondet investuese nga IKR dhe dorëzuar në paketën e zakonshme të informacioneve.

Si rejtingje kreditore të pranueshme të pjesëve në fondet investuese konsiderohen rejtingjet kreditore të cilat gjatë vlerësimit kreditor në

pjesën më të madhe fillon nga cilësia kreditore e aktivitetit të fondit investues. Faktorë të tjerë (cilësia e menaxhimit me fondin, ndryshimet e fondit ndaj ndryshimeve të tregut, niveli i diversifikimit të fondit, harmonizimi i maturimit të aktiveve dhe detyrimeve të fondit, etj.) mund të merren pjesërisht parasysh gjatë përcaktimit të rejtingut të kredisë, në varësi të madhësisë dhe natyrës së tyre.

204. Me përjashtim të këtij vendimi, rejtingjet kreditore të kërkuara të "Fiç rejtings", "Mudis" dhe "Standard dhe Purs" shpërndahen në shkallët e cilësisë së kredisë nga kreu VI të këtij vendimi, të mënyrës të përcaktuar në Aneks nr.6. Banka, e cila për segmente të veçanta të tregut përdor rejtingjet kreditore të kërkuara të këtyre tre institucioneve, përcakton vlerën e ponderuar të kategorive individuale të ekspozimit, në bazë të shpërndarjes së kryer në Aneksi nr.6.

XIII.3.1 Faktorët sasiorë

205. IKR është e detyruar t'i dorëzojë në Bankën Popullore faktorët sasiorë në vijim që përdoren për shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të saj:

- mesatarja dhjetëvjeçare e realizuar në normën trevjeçare kumulative të mospagesës së të gjithë personave në të cilën IKR u ka ndarë rejting afatgjatë të njëjtë;
- dy normat e fundit trevjeçare kumulative të mospagesës së të gjithë personave në të cilën IKR u ka ndarë rejting afatgjatë të njëjtë.

Nëse bëhet fjalë për IKR të sapokrijuar ose IKR e cila nuk disponon me seri mjaftë të gjatë të dhënash për përcaktimin e normave të nevojshme të mospagesës nga paragrafi 1 i kësaj pike, ajo në Bankën Popullore i dorëzon vlerësimet, gjegjësisht normat e mospagesës së të gjithë personave të cilave u ka ndarë rejting afatgjatë të njëjtë.

206. Banka Popullore kryen krahasimin e faktorëve sasiorë nga pika 205 të këtij vendimi, me normat e krahasuara në vijim:

- norma nga pika 205 paragrafi 1 nënparagrafi 1 krahasohet me normën kumulative trevjeçare afatgjatë të mospagesës (Tabela nr. 20);
- norma nga pika 205 paragrafi 1 nënparagrafi 1 krahasohet me normat për monitorimin dhe vlerësimin (Tabela nr.21).

Tabela nr. 20

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5
Norma kumulative krahasuese afatgjatë trevjeçare të mospagesës	0,10%	0,25%	1,00%	7,50%	20,00%

Tabela nr. 21

Shkalla e cilësisë së kredisë	1	2	3	4	5
Norma e monitorimit	0,8%	1,0%	2,4%	11,0%	28,6%

Norma e vlerësimit	1,2%	1,3%	3,0%	12,4%	35,0%
--------------------	------	------	------	-------	-------

Banka Popullore kryen fillimisht shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur përmes krahasimit nga paragrafi 1 nënparagrafi 1 të kësaj pike. Shpërndarja fillimisht konfirmohet me përdorimin e normave për ndjekjen dhe rivlerësimi i mënyrës në vijim:

- nëse norma e fundit trevjeçare kumulative të mospagesës për normë të caktuar të cilësisë së kredisë në të cilën është shpërndarë rejtingu kreditor përkatës është mbi nivelin e normës për monitorim që referohet në atë shkallë të cilësisë së kredisë (Tabela nr.20 reshti 2), Banka Popullore do të shqyrtojë arsyen për dallimin që rezulton. Rishpërndarja e rejtingut kreditor në shkallë më pak të favorshme të cilësisë së kredisë do të kryhet nëse Banka Popullore përcakton se shkalla më e lartë e mospagesës është rezultat i standardeve më të këqija për vlerësim kreditor ose gabime në llogartijen të bëra nga IKR e njohur;
- nëse dy normat e fundit trevjeçare kumulative të mospagesës për normë të caktuar të cilësisë së kredisë në të cilën është shpërndarë rejtingu kreditor përkatës janë më të larta se niveli i normës për rivlerësim që referohet në atë shkallë të cilësisë së kredisë (Tabela nr.21, reshti 3), Banka Popullore do të kryejë rishpërndarjen e rejtingut kreditor në shkallë më pak të favorshme të cilësisë së kredisë.

XIII.3.2 Faktorët sasiore

207. Me rishpërndarjen e rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur, Banka Popullore i merr parasysh edhe faktorët sasiore në vijim:

- Madhësia dhe përfshira e klientëve/emetuesve të letrave me vlerë që i rendit IKR e njohur;
- diferencën e rejtingjeve të kredisë që i ndan IKR e njohur;
- rëndësia e çdo rejtingu kreditor;
- definimi i normës së mospagesës.

XIII.4 Monitorimi i IKR-së së njohur

208. IKR e njohur është e detyruar vazhdimisht t'i plotësojë kriteret e definuara në kreun XIII të këtij vendimi, në bazë të cilëve është njohur nga Banka Popullore.

209. IKR e njohur është e detyruar ta informon Bankën Popullore për:

- çdo ndryshim domethënës në metodologjinë e tij që ndikon në plotësimin e kriterëve nga kreu XIII i këtij vendimi (në pajtim me pikën 196 të këtij vendimi);
- norma trevjeçare kumulative e mospagesës për vitin e mëparshëm për çdo segment të tregut për të cilën është e njohur nga Banka Popullore (e dhëna dorëzohet më së voni deri në fund të vitit aktual);

- pakoja e zakonshme e informacioneve (dorëzohet në çdo pesë vjet); dhe
- Informacione tjera që mund t'i kërkojë Banka Popullore për nevojat e këtij vendimi.

IKR që është e njohur nga organi kompetent i një vendi tjetër është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Bankën Popullore nëse ai organ mbikëqyrës e ka tërhequr nga lista e IKR-ve të njohura ose ka kryer ndryshim në mënyrën e shpërndarjes së rejtingjeve kreditore të saj.

210. Në bazë të informacioneve të pikës 209 të këtij vendimi, Banka Popullore kryen monitorim të rregullt të:

- shpërndarjes së kryer të rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur,
- plotësimi i kriterëve të definuara në kreun XIII të këtij vendimi nga IKR e njohur (së paku në çdo pesë vjet).

211. Në të gjitha rastet kur Banka Popullore do të përcaktojë se shpërndarja e kryer më nuk i përgjigjet shkallës së vërtetë të cilësisë së kredisë, do të kryejë vlerësim të shpërndarjes në pajtim me kreun XIII.3 të këtij vendimi.

IKR e njohur ku Banka Popullore ka kryer rishpërndarjen e rejtingjeve kreditor të saj, në pajtim me kreun XIII.3 të këtij vendimi, mund të kërkojë rivlerësim të shpërndarjes përmes dorëzimit të dëshmive përkatëse nga të cilat mund të konstatohet se normat kumulative të mospagesës nuk janë ndjeshëm më të mëdha se vlerat e normave të krahasimit. Në këto raste, Banka Popullore mund të rivlerësojë shpërndarjen dhe t'i rishpërndajë rejtingjet e kredisë së asaj IKR në shkallë më të favorshme të cilësisë së kredisë.

Nëse organi kompetent i vendit anëtar të Bashkimit European kryen shpërndarjen e rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur ndryshe nga shpërndarja e kryer nga Banka Popullore, Banka Popullore mund ta përshtatë shpërndarjen personale me shpërndarjen e kryer nga ai organ mbikëqyrës.

XIII.5 Tërheqja e pëlqimit të dhënë

212. Banka Popullore mund plotësisht ose pjesërisht ta tërheqë pëlqimin e dhënë për njohjen e IKR-së së caktuar.

Banka Popullore mund plotësisht ta tërheqë pëlqimin e dhënë nëse konstaton se:

- IKR-ja e njohur nuk i plotëson kriteret e definuara në kreun XIII të këtij vendimi;
- të IKR-së që ka qenë e njohur përmes procedurës indirekte për njohjen dhe ka qenë i tërhequr pëlqimi nga organi kompetent përkatës të vendit anëtar të Bashkimit European

ose ka pushuar të regjistrohet në pajtim me Rregulloren 1060/2009 të Parlamentit Europian dhe Këshillit;

- IKR-ja e njohur nuk i plotëson kërkesat në pikëpamje të dorëzimit të informacioneve dhe të dhënave në Bankën Popullore, në pajtim me pikën 209 të këtij vendimi; ose
- IKR-ja e njohur e përdorë pëlqimin e Bankës Popullore për nevojat e reklamimit dhe marketingut të saj.

Banka Popullore mund pjesërisht ta tërheqë pëlqimin për përdorimin e rejtingjeve kreditore të IKR-së së njohur për segment të caktuar të tregut nëse konstaton se:

- IKR e njohur nuk i plotëson kriteret e definuara në kreun XIII të këtij vendimi vetëm për segment të caktuar të tregut;
- të IKR-së që ka qenë e njohur përmes procedurës indirekte për njohjen dhe ka qenë i tërhequr pëlqimi nga organi kompetent përkatës të vendit anëtar të Bashkimit Europian për përdorimin e rejtingjeve të saj për segment të caktuar të tregut.

213. Krahas rasteve të pikës 212 të këtij vendimi, Banka Popullore mund ta tërheqë plotësisht ose pjesërisht pëlqimin për njohjen e IKR të caktuar dhe nëse merr dëshmi se organi tjetër kompetent ia ka revokuar pëlqimin.

214. Krahas rasteve të pikës 212 të këtij vendimi, Banka Popullore mund ta tërheqë pëlqimin për njohjen e IKR-së së caktuar me të cilën u lejohet bankave për nevojat e këtij vendimi të përdorin rejtingje kreditore të pakërkua nga ajo IKR, nëse konstaton se:

- cilësia e rejtingjeve kreditore të pakërkua është ndjeshëm më i keq se cilësia e rejtingjeve kreditore të kërkuara;
- IKR e njohur i përdor rejtingjet kreditore të pakërkua si mjet për t'i detyruar personat që kanë të bëjnë ato rejtingje të kërkojnë nga ajo ndarje të rejtingjeve kreditore të kërkuara (rejtingje që paguhen).

215. Në rastet kur Banka Popullore ka dhënë pëlqimin për njohjen e IKR në nivel të grupit, Banka Popullore mund të tërheqë pjesë nga pëlqimi i emetuar për filial të veçantë që është anëtare e grupit, nëse konstaton se filiali:

- nuk i përdor vlerësimet e njëjta kreditore, metodologjinë dhe procedurat si dhe personin amë (personi që në emër të grupit ka marr pëlqimin për njohjen e grupit nga Banka Popullore);
- e përdor pëlqimin për nevojat e reklamimit dhe marketingut të vet;
- i përdor rejtingjet kreditore të pakërkua si mjet për t'i detyruar personat që kanë të bëjnë ato rejtingje të kërkojnë nga ajo ndarje të rejtingjeve kreditore të kërkuara (rejtingje që paguhen).

XIV. MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT NË BAZË TË KONSOLIDUAR

216. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar të zbatojë këtë vendim në bazë individuale dhe të konsoliduar.

Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar e përcakton normën e mjaftueshmërisë së kapitalit përmes përcaktimit të shumës së mjeteve vetanake dhe të aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut, në bazë të raporteve të konsoliduara të grupit bankar.

217. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar dhe që, në pajtim me këtë vendim, është e detyruar të konstatojë kapital për mbulimin e rrezikut valutor dhe të rreziqeve të tregut në bazë individuale, është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtyre rreziqeve dhe në bazë të konsoliduar.

Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar dhe që, në pajtim me këtë vendim, nuk është e detyruar të përcaktojë kapital për mbulimin e rrezikut valutor dhe të rreziqeve të tregut në bazë individuale, është e detyruar të përcaktojë kapital për mbulimin e këtyre rreziqeve në bazë të konsoliduar, nëse grupi bankar nuk i plotëson përjashtimet e përcaktuara në pikat 29 dhe 30 të këtij vendimi.

218. Përcaktimi i mjaftueshmërisë së kapitalit në bazë të konsoliduar themelohet në bazë të përcaktimit të pozicioneve që përfshihen në portfolion e aktiviteteve bankare dhe pozicioneve që përfshihen në portfoli për tregtim në nivel të grupit bankar, gjegjësisht të përcaktimit të aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut kreditor dhe aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve tjera të grupit bankar.

XIV.1 Përcaktimi i mjeteve vetanake në bazë të konsoliduar

219. Shuma e mjeteve vetanake të grupit bankar nuk guxon të jetë më e ulët se shuma e përcaktuar me Ligjin për Bankat.

220. Mjetet vetanake të grupit bankar përcaktohen në pajtim me kreun III të këtij vendimi, në bazë të raporteve financiare të konsoliduara të grupit bankar.

Krahas pozicioneve nga paragrafi 1 të kësaj pike, në përcaktimin e mjeteve vetanake në bazë të konsoliduar si rezerva të konsoliduara konsiderohen edhe pozicionet në vijim:

- shuma e jokontrollimit (pakica) pjesëmarrja e shumave të kapitalit bazë të pranueshëm shtesë, kapitali bazë i pranueshëm, i pranueshëm kapitali shtesë dhe mjete vetanake të pranueshme të filialit të bankës në pajtim me pikat 220-a dhe 220-b të këtij vendimi;
- çdo dallim i përcaktuar si rezultat i konsolidimit të kryer, përfshirë edhe rezervat nga dallimet e kursit të bëra gjatë konsolidimit;
- pjesëmarrja e anëtarëve të grupit në personat e tretë për të cilat Banka Popullore ka dhënë pëlqim të mos përfshihen në konsolidimin.

Pozicionet nga paragrafi 2 të kësaj pike janë pjesë përbërëse të kapitalit bazë të rregullt, kapitalit bazë shtesë dhe kapitalit shtesë të grupit bankar. Nëse këto pozicione kanë vlerë negative, paraqesin zë të zbritshëm të kapitalit bazë të rregullt, kapitalit bazë shtesë dhe kapitalit shtesë, respektivisht.

220-a. Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica), kapitali bazë shtesë i pranuar, kapitali bazë i pranuar, kapitali shtesë i pranuar dhe mjetet vetanake të pranuara përbëhen nga pozicionet e kapitalit bazë të rregullt, pozicionet nga kapitali bazë i shtuar dhe pozicionet nga kapitali shtesë i filialit të bankës, respektivisht, që i përkasin personave të tretë.

Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica) dhe shumat e kapitalit bazë shtesë, kapitalit bazë të pranuar dhe kapitalit shtesë të pranuar të filialit përfshihen në pjesën përkatëse të mjeteve vetanake të bankës në bazë të konsoliduar, nëse:

- filiali është bankë;
- Filiali është anëtar i grupit bankar të cilës i përket banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Palët e treta që kanë investuar në pozicionet që janë pjesë nga mjetet vetanake të filialit të bankës nuk janë anëtare të grupit bankar të cilës i përket banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar.

Pjesëmarrja e jokontrollimit (pakica) dhe shumat e kapitalit bazë të shtuar të pranuar, kapitali bazë i pranuar dhe kapitali shtesë i pranuar i filialit që janë direkt ose indirekt të financuara nga banka (personi amë) ose nga filiali i saj, nuk mund të përfshihen në përcaktimin e mjeteve vetanake të bankës në bazë të konsoliduar.

220-b. Shuma e pjesëmarrjes së jokontrollimit (pakicës) së filialit që mund të përfshihet në kapitalin bazë të rregullt në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

1) shumës më të ulët prej:

- shumës së kapitalit bazë të rregullt të filialit i nevojshëm për mbulimin e nivelin të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
- shumës së kapitalit bazë të rregullt të filialit që duhet të mbahet për nevojat e përcaktimit të kapitalit bazë të rregullt në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

- 2) raporti ndërmjet shumës së kapitalit të rregullt bazë që i përket personave të tretë që kanë investime në filialin dhe shuma totale e kapitalit të rregullt bazë të filialit, i shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë të pranuar të filialit që mund të përfshihet në mjetet vetanake të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

- 1) shumës më të ulët prej:

- shumës së kapitalit bazë të filialit i nevojshëm për mbulimin e nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
- shumës së kapitalit bazë të filialit që duhet të mbajë për nevojat e përcaktimit të kapitalit bazë në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

- 2) raporti ndërmjet shumës së kapitalit bazë që i përket personave të tretë që kanë investime në filialin dhe shuma totale e pozicioneve të kapitalit bazë të filialit, i shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë shtesë të pranuar të filialit që përfshihet në kapitalin bazë të shtuar të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me dallimin ndërmjet shumës së kapitalit bazë të pranuar nga paragrafi 2 të kësaj pike dhe shuma e pjesëmarrjes pakicë nga paragrafi 1 të kësaj pike.

Shuma e mjeteve vetanake të pranura të filialit që mund të përfshihet në mjetet vetanake të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me produktin e:

- 1) shumës më të ulët prej:

- shumës së mjeteve vetanake të filialit i nevojshëm për mbulimin e nivelit të përcaktuar me ligj, kapitali total i brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;
- shumës së mjeteve vetanake të filialit që duhet të mbajë për nevojat e përcaktimit të mjeteve vetanake në bazë të konsoliduar për shkak të mbulimit të nivelit të përcaktuar me ligj, totalin e kapitalit të brendshëm për mbulimin e rreziqeve, shtresat mbrojtëse të kapitalit, si dhe çfarëdolloj shume tjetër që duhet të mbajë filialin në pajtim me rregulloret ose në pajtim me kërkesat e organit kompetent;

- 2) raporti ndërmjet shumës së mjeteve vetanake të personave të tretë që kanë investime në filialin dhe shuma totale e pozicioneve të mjeteve vetanake të filialit, i shprehur në përqindje.

Shuma e kapitalit bazë shtesë të pranuar të filialit që përfshihet në kapitalin bazë të shtuar të bankës në bazë të konsoliduar është e barabartë me dallimin ndërmjet shumës së mjeteve vetanake të pranuar nga paragrafi 4 të kësaj pike dhe shuma e kapitalit bazë të pranuar nga paragrafi 2 të kësaj pike.

XIV.2 Përcaktimi i aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut kreditor në bazë të konsoliduar

221. Pozicionet nga portfolio të aktiviteteve bankare të grupit bankar përcaktohen në bazë të raporteve financiare të konsoliduara të grupit, të përpunuara me përdorimin e metodës së konsolidimit të plotë ose metodës tjetër, në varësit të marrëdhënieve ndërmjet personit amë të grupit bankar dhe anëtarëve tjerë të grupit.

222. Aktivi i ponderuar sipas rrezikut të kredisë përcaktohet me zbatimin e ponderëve të rrezikshmërisë nga kreu VI të këtij vendimi të pozicioneve nga portfolio të aktiviteteve bankare të grupit bankar.

Kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor në nivel të grupit bankar është i barabartë me 8% të shumës të aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut kreditor të grupit bankar, të përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 të kësaj pike.

XIV.3 Përcaktimi i aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve tjera në bazë të konsoliduar

223. Aktivi i ponderuar sipas rreziqeve tjera të grupit bankar përcaktohet kur përmbledhja e kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor të grupit bankar, i përcaktuar në pajtim me pikën 224 të këtij vendimi, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut të grupit bankar, i përcaktuar në pajtim me pikën 225 të këtij vendimi, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ, i përcaktuar në pajtim me pikën 226 të këtij vendimi dhe kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave, i përcaktuar në pajtim me pikën 227 të këtij vendimi, do të shumëzohet me 12,5.

Me përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor të grupit bankar, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut të grupit bankar, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ dhe kapitali i nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave të grupit bankar, përdoret metoda e mbledhur, në mënyrën e përcaktuar në pikat 224, 225, 226 dhe 227 të këtij vendimi

224. Çdo anëtare e grupit bankar është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor të bazës individuale, në pajtim me kreun VII të këtij vendimi.

Përmbledhja e kapitalit të përcaktuar nga paragrafi 1 të kësaj pike për të gjithë anëtarët e grupit e jep kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut valutor të grupit bankar. Me përcaktimin e kapitalit, nuk mund të kryhet netimi i pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në valutë të njëjtë ndërmjet anëtarëve të grupit.

225. Çdo anëtare e grupit bankar është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut në bazë individuale, në pajtim me kreun VIII të këtij vendimi.

Përmbledhja e kapitalit të përcaktuar nga paragrafi 1 të kësaj pike për të gjithë anëtarët e grupit e jep kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut për grupin bankar. Me përcaktimin e kapitalit, nuk mund të kryhet netimi i pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në instrumente financiare të njëjta ndërmjet anëtarëve të grupit.

Në rast se anëtar i caktuar i grupit nuk detyrohet të përcaktojë kapital për mbulimin e rreziqeve të tregut, pozicionet e tij nga portofoli për tregtim përfshihen në përcaktimin e aktiveve të ponderuara sipas rrezikut të kredisë në bazë të konsoliduar.

226. Çdo anëtare e grupit bankar është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ në bazë individuale, në pajtim me kreun X të këtij vendimi.

Përmbledhja e kapitalit të përcaktuar nga paragrafi 1 të kësaj pike për të gjithë anëtarët e grupit e jep kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut operativ për grupin bankar.

227. Çdo anëtare e grupit bankar është e detyruar të përcaktojë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut nga ndryshimi i çmimeve të mallrave në bazë individuale, në pajtim me kreun IX të këtij vendimi.

Përmbledhja e kapitalit të përcaktuar nga paragrafi 1 të kësaj pike për të gjithë anëtarët e grupit e jep kapitalin e nevojshëm për mbulimin e rrezikut të ndryshimit të çmimeve të mallrave për grupin bankar. Me përcaktimin e kapitalit, nuk mund të kryhet netimi i pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në instrumente financiare dhe mallra të njëjta ndërmjet anëtarëve të grupit.

228. Me përjashtim të pikës 223 paragrafi 2 të këtij vendimi, pas pëlqimit paraprak të Bankës Popullore, banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar mund ta zbatojë metodën e konsolidimit të plotë për përcaktimin e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve, nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

- personi amë i përcakton pozicionet në portfolio për tregtim dhe/ose pozicioni neto në ar dhe pozicioni agregat valutor dhe i ndjek rreziqet e tregut, rreziku valutor dhe rreziku nga ndryshimi i çmimeve të mallrave me këto pozicione në nivelin e të gjithë grupit dhe në bazë të rregullt;
- çdo anëtare e grupit në bazë individuale e mban normën e përshkruar të mjaftueshmërisë së kapitalit;

- personi amë ka ekspertizë të duhur dhe burime për zbatimin e metodës në konsolidim të plotë në bazë ditore;
- mjetet vetanake mund lirshëm të transferohen ndërmjet anëtarëve të grupit.

Nëse Banka Popullore lëshon pëlqim për përdorimin e metodës së konsolidimit të plotë, gjatë përcaktimit të kapitalit i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të tregut, rreziku valutor dhe rreziku nga ndryshimi i çmimeve të mallrave, mund të kryhet netimi i pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në të njëjtat instrumente financiare dhe mallra ndërmjet anëtarëve të grupit. Nëse banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar vendos të kryen netimin e pozicioneve të shkurtra dhe të gjata në të njëjtat instrumente financiare dhe mallra, është e obliguar të zbatojë të njëjtën qasje tek të gjithë anëtarët e grupit bankar.

XV. RAPORTET

229. Bankat përbëjnë raporte për zbatimin e këtij vendimi sipas gjendjes kontabël në datat 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor dhe e dorëzojnë në Bankën Popullore.

Afati i dorëzimit të raporteve me gjendjen më 31 dhjetor është pesë ditë pune pas skadimit të afatit për dorëzimin e raportit financiar vjetor të pa audituar.

Afati për dorëzimin e raporteve me gjendjen e datave 31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator është pesëmbëdhjetë ditë pune pas skadimit të periudhës për të cilën dorëzohen raportet.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, banka që është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar t'i dorëzojë raportet për mjaftueshmërinë e kapitalit në bazë të konsoliduar sipas gjendjes kontabël më 30 qershor dhe 31 dhjetor, në afat prej 30 ditësh pas skadimit të afateve nga paragrafi 2 dhe paragrafi 3 të kësaj pike, të parashikuara për dorëzimin e raporteve për mjaftueshmërinë e kapitalit në bazë individuale.

230. Me kërkesë të veçantë të Bankës Popullore, banka është e detyruar të përgatisë raporte me gjendjen në ditë tjetër dhe në afat tjetër që është i ndryshëm nga gjendja dhe afatet e shënuara në pikën 229 të këtij vendimi.

XVI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

231. Guvernatori i Bankës Popullore me udhëzim e nënshkruan mënyrën e zbatimit të këtij vendimi.

232. Kursimoret dhe Filialat e bankave të huaja janë të obliguara ti zbatojnë përkatësisht dispozitat e këtij vendimi, duka pasur parasysh dispozitat e Ligjit të Bankave dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji me të cilin rregullohet funksionimi kursimoreve dhe të filialeve të bankave të huaja në Republikën e Maqedonisë.

233. Për kontratat për instrumentet e kapitalit hibrid dhe instrumentet e subordinuara të lidhura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të zbatohen rregulloret të cilat ishin të vlefshme në ditën e lidhjes së tyre. Në rast të zgjatjes së afatit të kontratës për instrument hibrid ose instrument të subordinuar të lidhur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, banka është e detyruar të harmonizojë kontratën me dispozitat e këtij vendimi.

234. Anekset nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

235. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi nga kursimoret, ndalon se vlejtori Vendimi për Metodologjinë për Përcaktimin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 159/2007, 32/2008, 31/2009, 96/2009, 157/2009 и 91/2011).

236. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet prej më datë 1.7.2012 për bankat dhe filialet e bankave të huaja, gjegjësisht për Kursimoret.

V.nr.02-15/III-1/2012
29.03.2012 Shkup

Guvernator
dhe Kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

Aneks nr. 1

Derivat financiarë	Rreziku nga investimet në instrumentet e borxhit		Rreziku nga investimet në instrumente pronësore	
	Rreziku specifik	Rreziku i përgjiths	Rreziku specifik	Rreziku i përgjiths
Fjuçers dhe forward të:				
- obligacionet shtetërore	Jo	Po, si dy pozicione		
- obligacionet e ndërmarrjeve	Po	Po, si dy pozicione		
- treguesit të normave të interesit (p.sh. LIBOR)	Jo	Po, si dy pozicione		
- instrumente pronësore		Po, si pozicion në instrumentin e borxhit pa kupon	Po	Po, si pozicion në subjektin
- tregues të bursës		Po, si pozicion në instrumentin e borxhit pa kupon	Po	Po, si pozicion në subjektin
Forwardet e normës së interesit (ang. Forward)	Jo	Po, si dy pozicione		
Forwardet e kursit valutor (ang. FX forward)	Jo	Po, si një pozicion në çdo valutë		
Swapet	Jo	Po, si dy pozicione	Po	Po, si dy pozicione në subjektin

Aneksi nr. 2

KËRKESE PËR NJOHJEN E _____ për institucion të jashtëm të njohur për rejtingun e kredisë për nevojat për përcaktimin e kapitalit të nevojshëm për të mbuluar rrezikun e kredisë

I. TË DHËNA PËR PERSONIN E AUTORIZUAR TË KËRKESES

(të rrethohet): z. /znj.

Emri:

Mbiemri:

Vendi i punës:

Vendbanimi (i përhershëm ose përkohshëm):

Kodi postar dhe vendi i banuar:

Shteti:

Tel. numër:

Faksi:

Posta elektronike:

II. TË DHËNA PËR AUTORIZUESIN²

(të rrethohet): z. /znj.

Ime:

²Të plotësohet në rast të lëshimit të autorizuar për parashtrimin e kërkesës për njohje.

Mbiemri:

Vendi i punës:

Vendbanimi (i përhershëm ose përkohshëm):

Kodi postar dhe vendi i banuar:

Shteti: _____

Tel. numër:

Faksi:

Posta elektronike:

AUTORIZIMI

Unë, i nënshkruari/ e nënshkruara, e autorizoj _____ (emri dhe mbiemri i autorizuesit) si autorizues i im dhe e autorizoj në emrin tim të parashtroj kërkesë për njohjen e _____ (emri i kërkuarit) nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, si institucion i jashtëm i njohur për vlerësim të rrezikut kreditor për nevojat e përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor.

Nënshkrim i persona të autorizuar të kërkesës

III. TË DHËNAT BAZË

1. Segmenti i tregut për të cilin kërkohet njohje:

2. Emri dhe selia e filialeve për të cilin kërkuar kërkon njohje:

3. Lista e vendeve në të cilën kërkuesi kërkon ose ka për qëllim të kërkon njohje (të rrethohet ose të plotësohet):

1. Austria
2. Belgjika
3. Bullgaria
4. Qipro
5. Republika Çeke
6. Danimarka
7. Estonia
8. Finlanda
9. Franca
10. Gjermania
11. Greqia
12. Hungaria
13. Irlanda
14. Italia
15. Letonia
16. Lituania
17. Luksemburg
18. Malta
19. Holanda
20. Polonia
21. Portugalia
22. Rumania
23. Sllovakia
24. Sllovenia
25. Spanja
26. Suedia
27. Britania e Madhe
28. Islanda
29. Lihtenshtajni
30. Norvegjia
31. Tjera:

IV. SHTOJCA (të rrethohet ose të plotësohet)

1. Deklaratë nga banka në Republikën e Maqedonisë për qëllimin t'i përdorë rejtingjet kreditore të kërkuesit për nevojat e përcaktimit të kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor (Aneksi nr. 3);
2. Deklaratë për harmonizimin e vlerësimeve kreditore, metodologjinë, procedurat dhe praktikën për përcaktimin e rejtingjeve kreditore në nivel të tërë grupit të cilës i përket kërkuesi (Aneksi nr. 4);

3. Paketë e zakonshme e plotësuar - informacione në pajtim me Aneksin nr. 5 të këtij vendimi;
4. Tjetër:

Kërkuesi (emri dhe selia):

Vendi dhe data:

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar / autorizuesi i kërkuesit:

Nënshkrim i personit të autorizuar / autorizuesi i kërkesës:

Aneksi nr. 3

DEKLARATË PËR QËLLIMIN E PËRDORIMIT TË REJTINGJEVE KREDITORE TË

Ne, në cilësi të anëtarëve të Bordit Drejtues të _____ (emri dhe selia e bankës), konstatojmë se nëse _____ (emri i kërkuesit) të njihet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, _____ (emri i bankës) do t'i përdorë rejtingjet e kërkuesit gjatë llogaritjes së kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor me zbatimin e qasjes së standardizuar.

Vendi dhe data:

Emri dhe mbiemri i anëtarëve të Bordit Drejtues të _____ (emri i bankës):

Nënshkrimi i anëtarëve të Bordit Drejtues të _____ (emri i bankës):

Aneksi nr. 4

**DEKLARATË PËR HARMONIZIMIN E METODOLOGJISË DHE PROCEDURAT
NË KUADËR TË GRUPIT TË CILIT I PËRKET KËRKUESI**

Unë i nëshkruari, konfirmoj se filialet e IKR-së në vijim:

(emri dhe selia e filialit/filialeve të IKR-së), aplikojnë vlerësime të njëjta krediti, metodologji, procedura dhe praktika për përcaktimin e rejtingjeve kreditore, për secilin nga segmentet e përcaktuara të tregut (të plotësohet nëse është e nevojshme):

Vendi dhe data:

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar / autorizuesi i kërkesit:

Nënshkrim i personit të autorizuar / autorizuesi i kërkesës:

Aneksi nr. 5

PAKETË E ZAKONSHME-INFORMACIONE

I. INFORMACIONE THEMELORE

1. Lloji i rejtingut të kredisë që lëshohet: i kërkuar dhe/ose i pakërkuar, me përshkrim të shkurtër të arsyes për shkak të cilës është vendosur të lëshohet ai lloj rejtingu kreditor.

2. Vendet në të cilën kërkuesi është aktiv (lëshon rejtingje kreditore).

3. Pasqyrë e pronësisë dhe strukturës organizative të IKR-së dhe grupit të cilit i përket: pronësia, filialet më të mëdha, ndihmëse dhe shërbime tjera që i ofron kërkuesi dhe të ngjashme. Informacionet për pronësinë duhet të përfshijnë listë të akionerëve/bashkëpunëtorëve që posedojnë më tepër se 10% të aksioneve/pjesëve të IKR-së.

4. Gjithsej numri i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt të punës.

5. Numri më i madh i klientëve dhe/ose abonentë dhe përqindja e pjesëmarrjes së tyre në të hyrat e IKR-së (shembull: klientë dhe abonentë që marrin pjesë me më shumë se 5% në të hyrat totale të IKR-së).

6. Informacione për gjendjen financiare të IKR-së: Raporti financiar për tre vitet e mëparshme dhe parashikimi për 3 vitet e fundit (nëse nuk janë të disponueshme, atëherë deklaratë për mbështetje financiare të lëshuar nga personi amë i grupit të cilës i përket kërkuesi).

7. Deklaratë për përmbajtje në kodin e sjelljes që i përmban standardet e pranuar nga tregu dhe rregullat e sjelljes të njohura ndërkombëtarisht.

II. INFORMACIONE QË E KONFIRMOJNË PLOTËSIMIN E KRITEREVE PËR NJOHJE³

1. OBJEKTIVITETI I METODOLOGJISE

1.1. Përshkrim i plotë i metodologjisë dhe të procesit për përpunim, të zbatuar dhe ndryshimi i metodologjisë. Përshkrimi duhet të përfshijë përshkrim të procesit që zbatohet për ofrimin e plotë dhe të vetëm të zbatuar në metodologjinë për të gjitha segmentet e tregut, me vlerësim të veçantë të rolit të Bordeve për rangimin dhe procedurat që i përdorin, vëllimin e informacioneve të fituara nga personat të cilëve iu përcaktohet rejtingu kreditor, qasja dhe përdorimi informacioneve që nuk kanë karakter publik etj.

1.2. Përshkrim i detajuar i faktorëve sasiore: treguesit kryesorë, burimet e të dhënave, supozimet dhe teknikat sasiore që janë

³ Kërkuesi nuk duhet t'i përsërisë përgjigjet, por për çdo kriter pa mëdyshje t'i shënojë diferencat ndërmjet segmenteve të tregut të cilës i referohet kërkesa për njohje.

përdorin, përfshirjen e informacioneve personat rejtingu kreditor i të cilit përcaktohet dhe ngjashëm (për të gjitha segmenetet e tregut ku zbatohet metodologjia bazë).

1.3. Përshkrimi i detajuar i faktorëve sasiore, dhe veçanërisht i vëllimit të përdorimit të vlerësimeve sasiore dhe subjektive në raport të cilësisë së strategjisë, plani afarist i personave rejtingu kreditor i të cilit përcaktohet dhe ngjashëm (për të gjitha segmentet ku zbatohet metodologjia bazë).

1.4. Pasqyra e diferencave bazë në metodologjinë që zbatohet në rajone gjeografike të veçanta (nëse ekzistojnë diferenca të tilla).

1.5. Përshkrimi i metodologjisë që zbatohet që zbatohet për konfirmimin e saktësisë, koherenca dhe gjithpërfshirja e sistemit të rejtingut kreditor dhe të aftësisë për parashikim, me analizë të detajuar të rezultateve dhe përfundimeve të fituara nga analiza e zbatuar.

2. PAVARËSIA E METODOLOGJISE

2.1. Përshkrimi i detajuar i procedurave për ofrimin e rejtingjeve kreditore reale dhe objektive, gjegjësisht përshkrimi i mekanizmat për njohje, parandalim, udhëheqje ose largim të rasteve të deritanishme ose të mundshme në konflikt të interesave.

2.2. Përshkrimi i detajuar i mekanizmave për mbrojtjen e procedurës për përcaktimin e rejtingjeve kreditore kur ndahen rejtingjet e aksionerëve/bashkëpunëtorëve të IKR-së ose persona tjerë që janë të lidhur me IKR.

2.3. Dëshmi dhe deklaratë për ekzistimin e një funksioni të pavarur të auditimit të brendshëm ose intrumente tjera për ofrimin e zbatimit efikas të procedurave të brendshme për ndarje, kontrollit dhe tërheqjes së rejtingut kreditor.

2.4. Dëshmi dhe deklaratë se anëtarët e ekipeve dhe bordeve për rangim i kanë përvojat e nevojshme dhe ekspertizë në përcaktimin e rejtingjeve kreditore, si dhe dëshmi për përmirësimin e vazhdueshëm të ekspertizës së tyre përmes trajnimeve përkatëse.

2.5. Përshkrimi i karakteristikave themelore të kodit të vendosur për sjellje të IKR-së.

2.6. Dëshmi dhe deklaratë se politika për shpërblim të personave të cilët kryejnë përcaktimin e rejtingut kreditor nuk ndikon në përpunimin e vlerësimit të pavarur dhe objektiv të kredisë (p.sh.: dëshmi se shpërblimi i analistëve nuk varet nga vendimmarrja për ndarjen e rejtingut kreditor, provizionet e ngarkuara dhe të hyrat tjera nga investitorët ose abonentët).

2.7. Informacione për tarifën e vetme për kompensime të IKR-së.

2.8. Dëshmi/deklaratë se personat e punësuar të përfshirë në procesin e përcaktimit të rejtingut kreditor nuk janë në marrëdhënie afariste me personat rejtingu kreditor i të cilit përcaktohet, dhe që mund ta parandalojë dhënien e vlerësimit të pavarur dhe cilësor të kredisë.

3. MONITORIM DHE RISHIKIM TË VAZHUESHËM TË REJTINGJEVE KREDITORE

3.1. Informacione themelore për monitorimin e vazhdueshëm të rejtingjeve kreditore të përcaktuara, si p.sh.: procedurat e vendosura për monitorim dhe karakteristikat e tyre themelore, përfshirja, periudha dhe personat e punësuar/ekipet të përfshira në monitorimin, fazat themelore të procesit të monitorimit, përditësimi i të dhënave, përfshirja e informacioneve nga personat rejtingu i të cilit përcaktohet, sistemi për paralajmërim, mekanizmat që mundësojnë gabime sistemike të ndodhura gjatë përcaktimit të rejtingjeve të përdoren gjatë ndryshimeve të mundshme të metodologjisë për përcaktimin e rejtingut kreditore etj.

3.2. Vështrim përmbledhës i rezultateve nga rishikimi i kryer.

3.3. Dëshmi se kryhet konfirmimi i rejtingjeve kreditore në bazë të përvojës historike, së paku njëherë në vit.

3.4. Vëllimi i bashkëpunimit me organet e udhëheqjes së klientëve rejtingu kreditor i të cilit përcaktohet.

4. TRANSPARENCA E METODOLOGJISE

4.1. Dëshmi se publikohen parimet themelore të metodologjisë për ndarje të rejtingjeve kreditore.

4.2. Përshkrimi i mënyrës në të cilën publikohen informacionet, si dhe të kushteve në të cilat të gjithë përdoruesit e interesuar mund të kenë qasje në rejtingjet kreditore të ndara nga kërkuesi.

4.3. Përshkrimi i politikës për transparencë të rejtingjeve kreditore, në varësi nga lloji i rejtingjeve kreditore: i kërkuar ose i pakërkuar.

5. BESUESHMËRIA E REJTINGJEVE KREDITORE

5.1. Dëshmi për pranimin e rejtingjeve kreditore të kërkuarit nga tregu, si p.sh.: pjesëmarrje në treg, numri i klientëve rejtingu i të cilëve ka qenë i përcaktuar, informacion për periudhën e aktivitetit të IKR-së së tregut, të hyra totale të realizuara në bazë të përcaktimit të rejtingut kreditor.

6. TRANSPARENCA E REJTINGUT KREDITOR

6.1. Përshkrimi i detajuar i procedurave për publikim publik të rejtingjeve kreditore.

III. INFORMACIONE TË NEVOJSHME PËR SHPËRNDARJEN E REJTINGJEVE KREDITORE

1. INFORMACIONE PËR SHPËRNDARJEN E REJTINGJEVE KREDITORE AFATGJATA

1.1. Definimi i normës së mospagesës.

1.2. Norma kumulative trevjeçare e mospagesës për çdo rejting kreditor (të dorëzohet në Bankën Popullore në bazë vjetore, në rast IKR-së të jetë

e njohur) dhe së paku dy normat kumulative trevjeçare të fundit të mospagesës.

1.3. Mesatarja dhjetëvjeçare e normave kumulative trevjeçare të mospagesës. Nëse IKR nuk disponon me këto norma, atëherë i dorëzon normat e vlerësuara, gjegjësisht normat e pritshme të mospagesës së detyrimeve.

1.4. Nëse përdoret një probabilitet i përcaktuar paraprakisht (i synuar) i mospagesës, atëherë dorëzohet informacion për të përcaktuarën probabilitet të mospagesës për çdo kategori të rejtingut kreditor.

1.5. Përshkrimi i metodologjisë për llogaritjen e normave të përgjithshme trevjeçare të mospagesës: zgjedhje të portfolios (portfolio statike ose dinamike), definimi i mospagesës, llogaritja e numrit të mospagimit (mënyra e ponderimit).

1.6. Rëndësia statistikore e normës së mospagesës.

1.7. Karakteristika dinamike të metodologjisë për përcaktimin e rejtingut kreditor ("statike", gjegjësisht në moment të caktuar ose "dinamike", gjegjësisht metodologjia e rangimit që e merr parasysh ciklin afarist).

1.8. Definimi (rëndësia) e kategorive të rejtingut kreditor.

1.9. Diferenca e rejtingjeve të kredisë që i ndan IKR.

1.10. Periudha në të cilën përcaktohet rejtingu kreditor.

1.11. Matrica e tranzicionit.

1.12. Mbulimi gjeografik.

2. INFORMACIONE SHITESË PËR PËRCAKTIMIN E REJTINGUT KREDITOR TË FONDEVE TË INVESTIMIT

2.1. . Shfaqje e rejtingjeve kreditore të pjesëve në fondet e investimit që fillojnë nga vlerësimi i cilësisë së kredisë të aktivitetit të fondit (investimet e fondit).

2.2. Përshkrimi i faktorëve dhe të ndikimit të tyre në rejtingun kreditor.

2.3. Definimi (rëndësia) e kategorive të rejtingut kreditor.

2.4. Diferenca e rejtingjeve të kredisë që i ndan IKR.

2.5. Periudha në të cilën përcaktohet rejtingu kreditor.

2.6. Matrica e tranzicionit.

2.7. Mbulimi gjeografik.

2.8. Lidhja e rejtingut të kredisë të fondit të investimit dhe rejtingjet kreditore afatgjata të IKR-së.

3. INFORMACIONE PËR SHPËRNDARJEN E REJTINGJEVE KREDITORE AFATSHKURTRA

3.1. Lidhja ndërmjet rejtingjeve kreditore afatshkurtra dhe afatgjata të IKR.

Aneksi nr. 6

SHPËRNDARJA E REJTINGJEVE KREDITORE TË KËRKUARA TË „FITÇ REJTINGS” (FITCHRATINGS, UK), “MUDIS” (MOODY’S INVESTORS SERVICES LTD, UK) DHE “STANDARD I PURS” (STANDARD&POOR’S RATINGS SERVICES) NË SHKALLËT PËRKATËSE TË CILËSISË SË KREDISË

Shpërndarja e rejtingjeve kreditore afatgjata në shkallët përkatëse të cilësisë së kredisë

Shkalla e cilësisë së kredisë	Qeveritë qendrore dhe Bankat qendrore.	Vetëqeverisja lokale, qeveria rajonale, institucionet publike, bankat multilaterale të zhvillimit dhe organizatat	Banka		Shoqëritë tjera tregtare	“Fitç”	“Mudis”	“Standard dhe Purs”
			Afati i mbetur deri më 3 muaj	Afati i mbetur mbi 3 muaj				
1	0%	20%	20%	20%	20%	AAA deri AA-	AAA deri Aa3-	AAA deri AA-
2	20%	50%	20%	50%	50%	A+ deri A-	A1 deri A3	A+ deri A-
3	50%	50%	20%	50%	100%	BBB+ deri BBB-	Baa1 deri Baa3	BBB+ deri BBB-
4	100%	100%	50%	100%	100%	BB+ deri BB-	Ba1 deri Ba3	BB+ deri BB-
5	100%	100%	50%	100%	150%	B+ deri B-	B1 deri B3	B+ deri B-
6	150%	150%	150%	150%	150%	CCC+ dhe nën CCC+	Caa1 dhe nën	CCC+ dhe nën CCC+

Shpërndarja e rejtingjeve kreditore afatshkurtra për bankat dhe shoqëritë tjera tregtare

Shkalla e cilësisë së kredisë	Ponder	"Fitç"	"Mudis"	"Standard dhe Purs"
1	20%	F-1+, F-1	P-1	A-1+, A-1
2	50%	F-2	P-2	A-2
3	100%	F-3	P-3	A-3
4 deri më	150%	Nën F-3	e pazbatueshme	B-1, B-2, B-3, C

Shpërndarja e rejtingjeve kreditore afatgjata për pjesët në fondet e investimit

Shkalla e cilësisë së kredisë	Ponder	"Fitç"	"Mudis"	"Standard dhe Purs"
1	20%	AAA deri AA-	AAA deri Aa3-	AAA deri AA-
2	50%	A+ deri A-	A1 deri A3	A+ deri A-
3	100%	BBB+ deri BBB-	Baa1 deri Baa3	BBB+ deri BBB-
4	100%	BB+ deri BB-	Ba1 deri Ba3	BB+ deri BB-
5	150%	B+ deri B-	B1 deri B3	B+ deri B-
6	150%	CCC+ dhe nën CCC+	Caa1 dhe nën	CCC+ dhe nën CCC+